

NË KËTË NUMËR FESTIV TË GAZETËS "EPOKA E RE" MUND TË LEXONI SHKRIME
TË LLOJLLOJSHME NGA POLITIKA, EKONOMIA, KULTURA, SPORTI DHE KOLUMNË

EPOKA

E RE

E përditshme e pavarur

Viti XXV, nr. 8214

31 dhjetor 2025 dhe

1, 2 e 3 janar 2026

Veteranët e UÇK-së një çerek shekulli pas luftës që krijoi shtetin e Kosovës

Prof. dr. Kudusi LAMA,
gjeneral në pension



NË PRITJE TË STRATEGJËVE TË LIRISË



Në numrin festiv gazeta "Epoka e re" vjen me një përmbledhje analitike të ngjarjeve kryesore që shënuan Kosovën dhe botën. Me shkrime mbi zhvillimet ekonomike, sfidat dhe trendët që karakterizuan vitin, si dhe një shkrim të veçantë

të kushtuar veteranëve të UÇK-së dhe çlirimtarëve në Hagë. Pjesë qendrore e këtij numri festiv është kolumna e gjeneralit Kudusi Lama, e cila hedh dritë mbi veteranët dhe krerët e UÇK-së që po mbahen padrejtësisht në Hagë. Po në

këtë numër festiv trajtohet edhe ngecja e dialogut Kosovë - Serbi, me analiza mbi pasojat politike dhe diplomatike, si dhe shkrime nga fusha e kulturës dhe sportit, duke plotësuar mozaikun e një viti të ngarkuar me ngjarje.



PROF. DR. IBRAHIM GASHI:
Roli i kulturës politike
në frenimin e procesit të
konstituimit të institucioneve
në Kosovë gjatë vitit 2025



BEHXHET SHALA - BAJGORA:
TRINGA IBRAHIMI,
RRUGËTIMI DREJT YJEVE!



VALON MURTEZAJ:
Politika e jashtme
globale në një botë
me shumë kriza



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

SIOMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de



Ngjarjet kryesore që shënuan Kosovën në 2025-n

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Viti 2025 ishte i ngarkuar për Kosovën, i shënuar nga zhvillime politike, diplomatike dhe shoqërore që ndikuan drejtpërdrejt në rrjedhat e brendshme dhe në pozitën ndërkombëtare të vendit. I gjithë viti që po lëmë pas u karakterizua nga bllokada institucionale, politike dhe ekonomike. Madje mund të thuhet se ishte kryesisht vit zgjedhor gjatë të cilit u mbajtën katër palë zgjedhje: zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit, zgjedhjet lokale të 12 tetorit, balotazhi i 9 nëntorit si dhe, së fundmi, zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit.

Vetëvendosja fiton zgjedhjet e 28 dhjetorit

Lëvizja Vetëvendosje ka fituar zgjedhjet parlamentare të 28 dhjetorit, duke fituar 49.30 për qind, pasuar nga PDK-ja me 21.01 për qind, LDK-ja me 13.59 për qind dhe AAK-ja me 5.68 për

qind. Ndërkaq Lista Serbe, e afërt me Beogradin, fitoi 4.74 për qind të votave.

BE-ja i heq masat Kosovës

Bashkimi Evropian (BE) ka vendosur t'i heqë të gjitha masat ndëshkuese ndaj Kosovës, duke ia mundësuar vendit të përfitojë miliona euro ndihmë financiare qysh në fillim të vitit 2026. Ishte presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ajo që njoftoi e para se BE-ja vendosi t'i heqë të gjitha masat deri në fund të janarit. Vendimi vjen pasi u bë kalimi i pushtetit lokal në mënyrë paqësore në veriun e banuar me shumicë serbe, pasi ishin pikërisht tensionet në këtë pjesë të Kosovës që shtynë bllokun të vendoste masa ndëshkuese ndaj saj verën e vitit 2023.

Kelmendi lirohet nga pozita e ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Këshilli Prokurorial i Kosovës e ka liruar Besim Kelmendin nga



Hamza zgjidhet kryetar i PDK-së

Bedri Hamza u zgjodh kryetar i ri i Partisë Demokratike të Kosovës gjatë Konventës së mbajtur të kësaj partie

pasditen e 17 nëntorit. Hamza u zgjodh përmes votimit të hapur dhe për të nuk votoi askush kundër. Ai nuk kishte

kundërkandidat dhe zgjedhja e tij u bë pasi Memli Krasniqi dha dorëheqje nga kreu i partisë.

pozita e ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit pas kërkesës së tij me shkrim një javë pasi gjykata e lartë e anuloi

shkarkimin e tij që kishte nxitur polemika dhe kritika. Në një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit Prokurorial, kërkesa e

Kelmendit për t'u liruar nga detyra u miratua me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Atë do ta pasojë



Trumpi nënshkruan Aktin e Autorizimit të Mbrojtjes Kombëtare ku përfshihet edhe Kosova

Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka nënshkruar Aktin e Autorizimit të Mbrojtjes Kombëtare (National Defense Authorization Act), i cili autorizon më shumë se 901 miliardë dollarë për

programet e mbrojtjes dhe përfshin edhe Kosovën. Ky ligj pasqyron rëndësinë që Shtëpia e Bardhë dhe Kongresi i Shteteve të Bashkuara i kushtojnë sigurisë së Kosovës dhe stabilitetit të Ballkanit Perëndimor.

Akti i Autorizimit të Mbrojtjes Kombëtare përmban disa mesazhe si paqja, stabiliteti dhe se e ardhmja demokratike e Kosovës janë interesa strategjike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Agron Qalaj, i cili u ricaktua ushtrues detyre i Kryeprokurorit.

Shpend Ahmetit i ngrihet aktakuzë për deklarim të pasaktë të pasurisë

Prokuroria Speciale ka njoftuar se ka ngritur aktakuzë ndaj ish-kryetarit të komunës së Prishtinës, Shpend Ahmetit, për mosraportim apo raportim të rremë të pasurisë. Sipas aktakuzës, Ahmeti, i cili shërbeu kryetar i Prishtinës për dy mandate, nga viti 2013 deri më 2021, kishte paraqitur “me dashje” deklarata të pasakta të pasurisë, pasi thuhet se nuk kishte deklaruar deponimet në para të gatshme nga 2018 deri në vitin 2022. Sipas aktakuzës, shuma e përgjithshme e mjeteve të padeklaruara arrin vlerën prej 172 600.00 eurosh.

Betohen kryetarët e rinj serbë të komunave në veri të Kosovës

Më 5 dhjetor në katër komunat e banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës, kryetarët e rinj nga Lista Serbe e rimorën pushtetin. Lista Serbe ka paralajmëruar se do t'i anulojë vendimet e kryetarëve shqiptarë dhe do të kërkojë

qasje në dokumentet e komunave. BE-ja mirëpriti dorëzimin e qeverisjes komunale në katër komunat në veri.

Komunat në veri votojnë për t'u tërhequr nga Asociacioni i Komunave të Kosovës

Komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku, kanë votuar më 18 dhjetor për t'u tërhequr nga Asociacioni i Komunave të Kosovës të enjten, pasi duan të jenë pjesë e një asociacioni të veçuar të komunave me shumicë serbe në vend. Ky vendim vjen pasi Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve të Kosovës që mbështetet nga Serbia - e riktheu pushtetin në këto katër komuna pas zgjedhjeve lokale të tetorit.

Shqipëria pajiset me sistemin amerikan Javelin

Shqipëria ka pranuar dërgesën e parë në dhjetor me sistemin kundëtanke Javelin nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bëri me dije Ministria e Mbrojtjes. Sipas ministrit shqiptar të Mbrojtjes, Pirro Vengu, pajisja e Forcave të Armatosura të

Shqipërisë me këtë sistem përbën një hap të rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve

mbrojtëse dhe përmbushjen e synimit për modernizimin e ushtrisë.



Kosova nënshkruan ujdë për blerjen e sistemeve të artilerisë HUMVEE Hawkeye nga prodhuesi amerikan

Kosova ka nënshkruar marrëveshje me prodhuesin amerikan të industrisë ushtarake, AM General, për blerjen e sistemeve moderne të artilerisë së lëvizshme, HUMVEE Hawkeye 105mm, njoftoi të mërkurën ministri i

Mbrojtjes, Ejup Maqedonci. Në një shkrim në Facebook, Maqedonci theksoi se “me këtë blerje ushtria jonë po kalon në një fazë tjetër zhvillimi, atë të rritjes së fuqisë së zjarrit direkt për qitje në distanca të largëta”. Ai

Osmani takon në Vatikan Papa Leonin XVI, ia kërkon njohjen

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se gjatë takimit me Papa Leonin XVI në Vatikan kanë diskutuar për thellimin e bashkëpunimit, me shpresën që Selia e Shenjtë “do të marrë së shpejti vendimin e shumëpritur për njohjen formale të Republikës së Kosovës”. “Kosova mbetet e përkushtuar t'i forcojë marrëdhëniet me Selinë e Shenjtë dhe ta avancojë miqësinë tonë historike, duke u udhëhequr nga vlerat që na bashkojnë”, tha Osmani, e cila ka ftuar Atin e Shenjtë për vizitë në Kosovë.

Gjykata Speciale e liron me kusht Isni Kilajn

Ish-kryetari i Malishevës, Isni Kilaj, është liruar nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, pasi gjykatësi vendosi se mbajtja e tij në paraburgim nën akuzat për pengim të drejtësisë nuk ishte “as e arsyeshme, as proporcionale”. Gjykata Speciale njoftoi më 10 dhjetor se gjykatësi erdhi në përfundim se e drejta themelore e Kilajt për lirim peshon më shumë sesa rreziku që ai të ketë ndikim në procesin e drejtësisë në gjyqin ndaj ish-kryerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili është buzë përfundimit.

Lahuta futet në listën e UNESCO-s për mbrojtje urgjente

Lahuta, një vegël e njohur muzikore shqiptare, është futur edhe zyrtarisht në Listën e



Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë, UNESCO, njoftoi kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. “Lahuta është shpallur zyrtarisht pasuri e trashëgimisë kulturore jomateriale në listën e UNESCO-s, për mbrojtje urgjente”, pati njoftuar Rama në ‘Facebook’.

Konjufca dështon ta bëjë qeverinë, hapet rruga për zgjedhje

Nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, nuk i siguroi votat e nevojshme për ta formuar Qeverinë e re të Kosovës. Konjufca ishte figura e dytë e LV-së, pas liderit të partisë, Albin Kurtit, që nuk i siguroi votat e nevojshme. Në ekspozenë e tij, Konjufca tha se ekzekutivi i tij, nëse zgjidhet, do t’i trajtojë çështjet kryesore: “buxhetin e shtetit, miratimin e Planit të Rritjes, disa marrëveshje ndërkombëtare financiare, ekzekutimin e pagave dhe miratimin e buxhetit për Prishtinë, Gjilan dhe Zubin Potok”.

Kushtetuesja në Shqipëri rikthen Veliajn në krye të Tiranës

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka rrëzuar një dekret të presidentit Bajram Begaj dhe një vendim të qeverisë shqiptare, duke rikthyer në krye të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliajn, dhe duke anuluar mbajtjen e zgjedhjeve në këtë komunë. Në dekretin e rrëzuar të Begajt, 9 nëntori ishte shpallur datë për mbajtjen e zgjedhjeve të pjesshme lokale në Bashkinë e Tiranës. Ndërkaq, Kushtetuesja rrëzoi vendimin e qeverisë shqiptare për shkarkimin e Veliajt.



Vdes ish-kryeministri i Shqipërisë, Fatos Nano

Ish-kryeministri i Shqipërisë, Fatos Nano, ka vdekur më 31 tetor në moshën 73-vjeçare. Ai kishte qenë i shtruar prej

disa ditësh në një spital privat në Tiranë, ku po trajtohej për probleme shëndetësore. Ai prej kohësh kishte probleme me

mushkëritë, ndërkaq gjendja e tij shëndetësore u përkeqësua ditët e fundit, raporton transmetuesi publik i Shqipërisë.

Kosova mbajti edhe zgjedhjet lokale

Republika e Kosovës në vitin 2025 ka mbajtur edhe zgjedhjet lokale. Në zgjedhjet e mbajtura më 12 tetor dhe 9 nëntor (balotazhi), Lëvizja Vetëvendosje dhe LDK-ja kanë fituar nga shtatë komuna, PDK-ja gjashtë, AAK-ja pesë dhe Nisma një komunë. Lëvizja Vetëvendosje ka fituar në:

Podujevë, Gjilan, Mitrovicë e Jugut, Shtime, Obiliq, Fushë-Kosovë, Kamenicë. LDK-ja ka fituar në: Prishtinë, Lipjan, Podujevë, Dragash, Junik, Viti dhe Istog. PDK-ja ka fituar në: Prizren, Ferizaj, Skenderaj, Vushtrri, Kaçanik dhe Hani i Elezit. AAK-ja ka fituar në: Gjakovë, Deçan, Rahovec, Suharekë dhe Klinë. Nisma ka fituar në Malishevë, ndërsa Ramiz Lladrovci, kandidat i pavarur, ka fituar në Drenas.

Kurti nuk i siguron votat për qeveri të re

Propozimi i mandatarit Albin Kurti për një mandat të ri katërvjeçar nuk mori përkrahjen e nevojshme prej 61 votash në Kuvendin e Kosovës. Kështu, me 56 vota për, 52 kundër dhe 4 absentime, Kuvendi nuk e zgjodhi qeverinë e re të Republikës së Kosovës. Kryetari

Vdiq aktori Enver Petrovci

Më 22 shtator, në moshën 71-vjeçare, ndërroi jetë aktori Enver Petrovci. Enver Petrovci lindi më 28 shkurt 1954 në Prishtinë. Ishte aktor dhe regjisor. Studioi në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë në Degën e Aktrimit, pastaj mbaroi studimet për aktor edhe në Fakultetin e Arteve Dramatike në Universitetin e Beogradit.



Hapet ura e re për këmbësorë mbi lumin Ibër

Është hapur për qarkullim të këmbësorëve ura e re mbi lumin Ibër, që lidh Mitrovicën e Jugut, të banuar me shumicë shqiptare, dhe atë të Veriut, të banuar me shumicë serbe.

Ura e re u përrua më 17 dhjetor nga kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ushtruesi i detyrës së ministrit të Infrastrukturës, Hysen Durmishi, dhe kreu i Mitrovicës së Jugut, Faton Peci.



Justina Shiroka Pula bëhet gruaja e parë në krye të ASHAK-ut

Akademikja Justina Shiroka Pula është zgjedhur kryetare e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ajo është gruaja e parë që udhëheq këtë institucion të themeluar më 1975 dhe pason në këtë detyrë akademik Mehmet Krajën. Gjatë

mbledhjes më 19 dhjetor, ASHAK-u zgjodhi edhe kryesinë e saj, ku Fejzullah Krasniqi u zgjodh nënkryetar, ndërkaq Bardh Rugova sekretar shkencor. Mandati i kryetarit të ASHAK-ut është katërvjeçar me mundësi rizgjedhje.



ShBA-ja pezullon dialogun e planifikuar strategjik me Kosovën shkaku i veprimeve të qeverisë

Më 12 shtator ShBA-ja ka pezulluar dialogun strategjik me Kosovën për shkak të veprimeve të qeverisë në detyrë, duke cituar rritje të tensioneve dhe paqëndrueshmërisë. Dialogu ishte planifikuar për t'i forcurar lidhjet ekonomike dhe diplomatike, por veprimet e kryeministrit Albin Kurti janë parë si sfida për përparim. Vendimi amerikan erdhi në kohën kur autoritetet e Kosovës po kritikojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

Kushtetuesja vendos masë të përkohshme që ndalon çdo veprim për formimin e qeverisë së re

Më 5 shtator Gjykata Kushtetuese e Kosovës njëzëri ka vendosur masë të përkohshme përmes së cilës ua ndalon deputetëve të ndërmarrin veprime si dhe ndalon zhvillimin e ndonjë procedure për formimin e Qeverisë së re të Kosovës. Kjo masë, e cila ishte në fuqi nga 5 deri më 30 shtator, u kritikua nga fituesja e zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje, e cila ka bërë thirrje të ecet përpara me formimin e qeverisë së re. Gjykata e vendosi këtë masë në mënyrë ex officio dhe në bazë të kërkesës së deputetëve të Listës Serbe.

Basha distancohet nga artikulli kundër UÇK-së

Kryetari i porsazgjedhur i Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, e ka distancuar sërish veten më 28 gusht nga një artikull që flet për ish-Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Në punimin ku ai është bashkautor, thuhet se “sipas rasteve të hetuara, fondet për UÇK-në erdhën nga shqiptarë të zakonshëm në diasporë, por edhe nga trafikantët e drogës që operonin në gjithë Evropën Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara”. Basha tha se “distancohem nga të gjithë ata që kanë shkruar kundër kësaj vlere”.

Liburn Aliu jep dorëheqje nga pozita e ministrit pas zgjedhjes së Bashës kryeparlamentar

Liburn Aliu ka dhënë dorëheqje si ministër i Infrastrukturës për shkak, siç tha, zgjedhjes së Dimal Bashës në pozitën e kryetarit të Kuvendit të Kosovës. “Dua t’ju njoftoj që sapo e dorëzova te kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, letrën e dorëheqjes sime nga detyra e ministrit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës”, shkroi Aliu në



Në Hagë kërkohet drejtësi për ish-krerët e UÇK-së

Në Hagë të Holandës më 14 shtator mijëra shqiptarë nga diaspora, por edhe nga Kosova, protestuan duke kërkuar drejtësi për ish-krerët e

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Protesta e 14 shtatorit u thirr nga mërgata shqiptare dhe u mbështet nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së

(OVL-UÇK). Protesta në kryeqytetin holandez u mbajt vitit 2025 bllokada

“Facebook” më 27 gusht. Ai shpjegoi se dorëheqja e tij vjen pasi bashkëpartiake i tij, Dimal Basha, u zgjodh kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Dimal Basha zgjidhet kryetar i Kuvendit të Kosovës

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Dimal Basha, më 26 gusht 2025 është zgjedhur kryetar i Kuvendit të Kosovës, duke marrë 73 vota. Kuvendi zgjodhi edhe tre nënkryetarë nga partitë shqiptare: Albulena Haxhiun, Vlora Çitakun dhe Kujtim Shalën. Emilija Rexhepi u zgjodh nënkryetare nga pakicat joserbe, ndërsa konstituimi ngeci te votimi i kandidatit për nënkryetar nga pakica serbe.

FSK-ja furnizohet me autoblanda nga ShBA-ja

Forca e Sigurisë së Kosovës është furnizuar me autoblanda që janë blerë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, njoftuan autoritetet. Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka njoftuar më 15 gusht se ky furnizim është dëshmia e radhës e partneritetit “të palëkundur me ShBA-në”, por edhe hap i rëndësishëm për fuqizimin e kapaciteteve mbrojtëse të vendit.

Institucionet e pavarura mbeten peng i Kuvendit

Dhjetëra institucione dhe agjenci të pavarura të Kosovës, organet kolegjiale dhe individuale të cilave emërohen nga Kuvendi i Kosovës, janë jofunksionale ose funksionojnë me mungesa për shkak të mosveprimit të legjislativit. Për shkak të mospajtimeve politike të subjekteve parlamentare,

deputetët e legjislaturës së nëntë, e cila doli nga zgjedhjet e mbajtura më 9 shkurt, nuk kanë arritur ta konstituojnë Kuvendin që nga 15 prilli e deri më tash.

Vetëvendosja fiton zgjedhjet e 9 shkurtit, por jo mjaftueshëm për t'i bërë institucionet

Lëvizja Vetëvendosje doli partia e parë në zgjedhjet e rregullta parlamentare të mbajtura më 9 shkurt. Ajo fitoi 42.30 për qind të votave, pasuar nga PDK-ja 20.95 për qind, LDK-ja 18.27 për qind dhe AAK-Nisma 7.06 për qind. Pavarësisht këtij rezultati që mori LV-ja, nuk i mjaftoi për t'i formuar vetë

institucionet e Kosovës dhe vazhdoi pothuajse gjatë gjithë vitit 2025 bllokada

Sheshi ‘Xhorxh Bush’: Punimet ndalen, përplasjet vazhdojnë mes institucioneve komunë - qeveri

Punimet që parashiheshin ta transformonin sheshin “Xhorxh Bush”, në kryeqytetin e Kosovës, gjatë vitit 2025 janë përcjellë me më shumë polemika sesa punime. Problemi qëndron te mosmarrëveshjet në mes të komunës së Prishtinës dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për atë se çka rrezikon asetet e trashëgimisë kulturore e çka jo.



Mes tensioneve, votohet programi dhe përbërja e Qeverisë së re të Shqipërisë

Mes tensioneve në Kuvendin e Shqipërisë, deputetët kanë votuar për programin politik për periudhën 2025-2029 dhe përbërjen e qeverisë së re, e udhëhequr nga Edi Rama. Ky është mandati i katërt i Ramës

në krye të ekzekutivit shqiptar, pasi subjekti i tij, Partia Socialiste, fitoi zgjedhjet e 11 majit 2025. Kryeministri shqiptar, Edi Rama, doli në foltore për ta paraqitur programin, por tensionet u

Policia e Kosovës në krizë gradimesh

Policia e Kosovës po funksionon me strukturë të çrregullt për shkak të bllokimit të gradimeve. Pozita kyçe vazhdojnë të mbulohen nga zyrtarë pa gradën e duhur. Zyrtarë brenda policisë thonë se në shumë pozita kërkohen gradime. Ata theksojnë se politizimi i proceseve dhe dështimet administrative po minojnë seriozitetin dhe efikasitetin e institucionit.

Sorenseni konfirmohet përfundimisht emisar për dialogun Kosovë - Serbi

Peter Sorensen ka marrë pëlqimin përfundimtar nga ministrat e jashtëm të Bashkimit Evropian për pozitën e përfaqësuesit të posaçëm të bllokut për dialogun për normalizim të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Paraprakisht, më 24 janar ambasadorët e BE-së kishin konfirmuar Sorensenin në këtë pozitë.

Ngrihet aktakuzë për vrasjen e Liridona Ademajt

Më 15 janar Prokuroria Themelore në Prishtinë ka njoftuar se ka ngritur aktakuzë ndaj katër personave për vrasjen e 30-vjeçares Liridona Ademajt në nëntor të vitit 2023, pas përfundimit të hetimeve. Fillimisht, rasti ishte raportuar si “grabitje me pasoja të vrasjes”, por dy ditë më vonë Policia e Kosovës njoftoi se lidhur me rastin ka arrestuar dy persona. Në mesin e tyre ishte edhe bashkëshorti i Liridonës, Naim Murseli. Ky proces gjyqësor po vazhdon.



VETERANËT E UÇK-së NJË ÇEREK SHEKULLI PAS LUFTËS QË KRIJOI SHTETIN E KOSOVËS

Prof. dr. Kudusi LAMA, *gjeneral në pension*

Veteranët e UÇK-së një çerek shekulli pas luftës që krijoi shtetin e Kosovës nuk e kanë marrë të drejtën të jenë siç u takon margaritari i kurorës së shtetit të Kosovës e të kombit shqiptar. Dhe kjo është e domosdoshme jo për interesat personale të veteranëve, siç tentojnë ta arsyetojnë disa politikanoanalistologë, por për interesat e lavdisë dhe të madhësisë së portretit të kombit, atdheut e shtetit. Sepse përvoja e historisë së botës e të shteteve këtë ka treguar. Por po duket se ne kemi elementë të fuqishëm në kombin tonë, që ende nuk kanë dalë nga hallkat e të qenit i pushtuar ose skllav a i dashuruar me pushtuesin. E të tillët po duket se edhe aktualisht po bëhen palë me armiqtë e keqdashësit e shqiptarëve, për ta mjegulluar historinë tonë të vjetër e të re.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku mendoj se vlerat kombëtare nderohen më qartë se në çdo vend tjetër, për veteranët e luftës në vijimësi shprehet vetëm mirënjohje. Dhe çdo vit vetë presidenti i ShBA-së përulet me nderim përpara veprës së veteranëve të luftës e figurës së tyre madhështore në emër të të gjithë kombit amerikan.

Janë pikërisht veteranët e luftës që me devotshmëri e çliruan atdheun dhe janë forca më e gatshme që me bindje ta mbrojnë kombin tonë, duke dhënë gjithçka nga vetja si dje edhe sot e nesër për të qenë të palëkundur në ballë të veprave për sigurinë e atdheut dhe të shtetit.

Nëpër botë është traditë që kryetari i shtetit në një ditë të caktuar për veteranët të vendosë një kurorë në Varrin e Ushtarit të Panjohur. Po ne në Kosovë ku e kemi varrin e ushtarit të panjohur, që është përfaqësues i të gjithë luftëtarëve të cilët luftuan e çliruan atdheun? Nuk e kemi këtë varr. Dhe kanë kaluar 27 vjet prej kur është përfunduar lufta e çliruar Kosova. A ka vërtetë ndonjë vend tjetër që të jetë kaq mosmirënjohës për çlirimtarët? Nuk besoj. I vetmi vend në botë që politikisht po përpiqet të zhvlerësojë luftën e bërë për çlirim dhe luftëtarët që e bartën këtë luftë është Kosova. Cila është arsyeja?

Duket sikur politikisht nuk kuptohet se pa luftën e atyre luftëtarëve që kanë fituar emërtimin: Veteran të Luftës së UÇK-së, nuk mund të ishte sot ky shtet i pranishëm në familjen e shteteve të botës. Duket se politikisht nuk po kuptohet se në menaxhimin e shtetit secili bën



aq sa mundet, sa di e sa ka dëshirë, kur qytetarët e vendit me të drejtë apo aksidentalisht me votat e tyre e venë në pushtet për një afat të caktuar. Duket se politikisht megjithëse pa asnjë përvojë profesionale, shtetarët shkojnë me mendimin se i bën karrigia ku ulen të mençur për të bërë gjithçka pa pasur nevojë për këshillën e profesionistit që ka njohuri dhe përvojë. Duket se politikisht shtetarët mendojnë se çdo gjë fillon atë ditë që qytetarët u japin pushtetin dhe gjithçka e mëparshme duhet djegur e zhdukur. Arrihet deri atje, sa edhe policinë e shtetit, sa janë në opozitë politikanët e quajnë "polici e kriminit", ndërsa të nesërmen e marrjes së pushtetit ajo quhet polici e shtetit, të cilët megjithëse janë të njëjtit njerëz, të duket sikur këta politikanët e ardhur në pushtet tashmë i kanë vaksinuar brenda natës, duke i bërë të jenë tjetër polici. E megjithëse të gjitha këto për mua janë qesharake, ja që janë prezentë dhe po na prishin shumë punë. Po na mohojnë vlerat kombëtare e shtetërore. E këtë mohim po e pësojnë edhe veteranët, të cilët për fat të keq nuk kanë luftuar nën flamurin e

asnjë partie politike, po nën flamurin e kombit, për ta bërë shtetin.

Në ShBA-të dhe në shtetet e tjera të zhvilluara e të qytetëruara, në Ditën e Veteranëve të luftës mbahen ceremoni të ndryshme festive e përkujtimore në gjithë hapësirat e vendit. Ndërsa ne në Kosovë akoma nuk e kemi një ditë të caktuar as për dëshmorët, por për fat të keq as ditën e çlirimit të atdheut nuk e kemi të caktuar. Edhe ditës së çlirimit i kemi vënë disa emërtesa e nuk e kemi ligjëruar për ta nderuar, por secili feston e përkujton sipas asaj që vlerëson, ama një ligj për këtë ditë nuk ka. Kështu që ndoshta unë pretendoj shumë kur kërkoj një ditë shtetërore për veteranët. Ama që është e detyrueshme është. Sepse shtetet serioze këtë ditë e kanë kthyer edhe në ditë pushimi zyrtar e me programe shtetërore të përkujtimit e festimit.

Britania Ditën e Veteranëve e quan Dita e Kujtimit, të cilën e nderon me një minutë heshtje në orën 11.00 të ditës, sipas orës lokale, në të gjithë hapësirat e shtetit. Po ashtu edhe në ShBA-të, ku përkujtohen veteranët dhe të rënë prej krijimit të ShBA-ve e

deri në ditët e sotme.

Ndërsa ne në Kosovë akoma përkujtojmë betejat e operacionet e Luftës Çlirimtare të Kosovës, sipas mundësive që kanë të interesuarit, të cilët mund të jenë luftëtarë veteranë ose familje të të rënëve. Por kjo nuk është normale. Lufta dhe luftëtarët nuk nderohen me mundësi individuale e me financime të privatëve. Këto ditë të lavdisë, të lirisë dhe të sigurisë së Kosovës duhet të nderohen e realizohen me programe shtetërore.

A nuk shihet se edhe vlerat e luftës së UÇK-së po luhaten duke shkuar andej nga janë pjesëmarrësit ose pasardhësit që kanë mundësi financiare? Kjo nuk është normale dhe as nuk duhet të jetë e pranueshme.

Të shkohet deri atje sa të flitet e veprohet për një veteran a të rënë, që mund të kenë veprimtari episodike në luftë, me gjithë respektin edhe për këta, sepse unë kam thënë që edhe ai i cili e ka marrë pushkën me 9 qershor 1999, për mua është njëlloj si të ishte luftëtarë i orëve të para. Por nuk mundet në pikëpamje të ndërtimit të historisë, të ngrihet episodika mbi thelbësoren, mbi

kryesoren vetëm pse episodika ka mundësi të financojë para ose të mbështesë një parti të caktuar politike. Sepse kështu nuk mund të kemi të vërtetë historike. E në qoftë se do të kishim një program shtetëror për vlerësimin e gjithë veprimtarisë luftarake të UÇK-së dhe të luftëtarëve të asaj lufte e të rënëve në atë luftë, kuptohet që specialistët nuk mund të lejonin të ndodhnin kapërcime të tilla që e shtrembërojnë luftën, për interesat e politikave të klaneve partiake e që interesave të qeverisjes së përkohshme.

Prandaj apeloj të ndryshohet ky mentalitet feudal. Apeloj të ngrihet shkalla e ndërgjegjes kombëtare të politikanëve e shtetarëve, të cilët realisht i paragjykoj. Më vjen keq, sepse dua vërtetë shtetarët dhe politikanët e vendit tim, që marrin në dorë fatet e qeverisjes së këtij populli të lavdishëm t'i dua pafundësisht, por nuk mund të dua askënd që nuk e donë e nderon atdheun e kombin megjithëse flet në emër të tyre dhe merr vendime në emër të tyre, por duke u vetëlavdëruar e duke u vetëvlerësuar, pa menduar se duhet të jetë i vlerësuar prej popullit që e ka vënë të menaxhojë jetën e tij.

E për të qenë më të qartë, duhet ditur se historia e kombit është historia e luftërave të tij për liri e shtetformim. Jo aksidentalisht shqiptarët në Kosovë u rreshtuan të gjithë në një mënyrë ose tjetër në radhët e UÇK-së. Prandaj edhe kërkoj që të kthejmë vështrimin nga veteranët e Luftës së UÇK-së, luftëtarët më besnikë e të përkushtuar si në të kaluarën edhe në të ardhmen. Të cilët është me vend të nderohen për sakrificat e tyre, për guximin e tyre, për dashurinë e tyre ndaj atdheut e kombit, për krenarinë që na kanë falur me veprën e tyre luftarake, për kontributin e tyre që na bën të kemi detyrim moral të respektojmë kujtimin, jetën dhe vlerat e veprës së tyre heroike. Sepse lufta e tyre është vijimësi e kontributit për mbajtjen gjallë të vlerave dhe virtytet e larta të atdhedashurisë. Gjithë veteranët tanë të Luftës së UÇK-së janë legjendarë, sepse në atë kohë të vështirë, guxuan. Ata u rreshtuan në atë organizatë madhore që u quajt UÇK e që mori mbi vete përgjegjësinë për të çliruar Kosovën. Ishte disiplina e tyre e çeliktë, ishte trimëria e tyre e pashoqe, ishte humanizmi i tyre i ndritur, ishte dashuria njerëzore që i përshkoi në trup e shpirt gjatë gjithë betejave të asaj lufte legjendare, ishte përkushtimi për ta bërë detyrën me devocion, ishte bindja se



LEGJISLATURA E NËNTË: 63 SEANCA, 12 ORË E GJYSMË PUNË

Deputetët e dalë nga zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit u takuan 63 herë në sallën e Kuvendit të Kosovës. Në rreth 750 minutat punë, ata nuk arritën të zgjedhin një qeveri të re apo ta miratojnë buxhetin. Madje iu deshën 60 seanca për ta konstituuar Kuvendin

PRISHTINË, DHJETOR / JANAR - E enjta e 5 dhjetorit 2024 solli seancën e fundit të legjislaturës së tetë të Kuvendit të Kosovës. Para zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit të këtij viti, kjo legjislaturë u shpërnda dhe 18 ligjet e miratuara të asaj dite mbeten të fundit edhe tani kur po mbyllet viti 2025, pasi që deputetët e dalë nga zgjedhjet e shkurtit nuk arritën as ta konstituojnë Kuvendin deri në gjysmë të tetorit. Përveç 60 takimeve në sallën e Kuvendit të Kosovës për konstituim, këta deputetë u mbledhën vetëm edhe tri herë. Dy herë - më 26 tetor dhe 19 nëntor - për t'i votuar propozimet e mandatarëve për kryeministër, një herë më 19 nëntor për një seancë të jashtëzakonshme për buxhet. Dhe kështu, për një vit, asnjë ligj nuk u miratua, ashtu siç edhe do të pritej nga një qeveri në detyrë dhe një kuvend jofunksional. Por, rrethanat e 2025-s nuk ishin "normale", thotë Naim Jakaj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD). "Do të duhej të trajtoheshin me urgjencë disa çështje jetike për funksionimin e shtetit", thotë Jakaj për Radion Evropa e Lirë, duke përmendur marrëveshjet ndërkombëtare, ndarjet buxhetore për vitin 2026, buxhetin për Radiotelevizionin e

Kosovës si dhe buxhetin për katër komunat në veri të vendit. Si një ndër "dështimet më serioze", ai e cilëson moszbatimin e një aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese për pagat në sektorin publik, që ua mundësonte punonjësve, të cilëve u ishte ulur paga nga ligji i ri, të vazhdojnë të marrin shtesa transitore derisa pagat e reja të barazohen me të vjetrat. "Kjo tregon se problem nuk ka qenë vetëm mungesa e institucioneve funksionale, por edhe mungesa e vullnetit për të respektuar rendin kushtetues dhe detyrimet ligjore", thotë Jakaj. Gjatë vitit 2025 qeveria në detyrë, e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti, mbajti gjithsej 39 mbledhje. Në mesin e tyre bëjnë pjesë: Projektligji për Akademinë e Drejtësisë, Projektligji për Rekrutimin, Vlerësimin e Performancës, Kontrollin e Integritetit dhe Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. "Mosshqyrtimi i këtyre nismave e ka bllokuar një hap të rëndësishëm drejt reformës së thellë në sistemin e drejtësisë", thotë Jakaj, duke shtuar se një pjesë e madhe e përgjegjësisë bie mbi Lëvizjen Vetëvendosje, pasi

që si parti në pushtet ka pasur kohë të zhvillojë "dialog politik transparent dhe substancial". Por, jo vetëm fusha e drejtësisë ka pësuar nga kjo paralizë institucionale. Gjatë gjithë vitit në temat e ndryshme që ka trajtuar Radio Evropa e Lirë përgjigjet nga shoqëria civile, madje edhe institucionet shtetërore, kanë përmendur se situata politike ka pamundësuar adresimin e shumë nevojave. Për shembull, fondet e Planit të Rritjes të Bashkimit Evropian për Kosovën, buxheti i Radio Televizionit të Kosovës, bordet gjysmake të shumë agjencive, Ligji për Parandalimin e Vetëvrasjeve, amendamenti i Kodit Penal ashtu që të përfshihet dhuna digjitale... Marigona Shabiu, drejtoreshë ekzekutive e Iniciativës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - YIHR Kosova, thotë se viti 2025 ka shfaqur "mungesë totale të hapësirës për diskutim parlamentar mbi çështje thelbësore të të drejtave të njeriut, drejtësisë tranzicionale dhe sundimit të ligjit". "Në mënyrë konkrete nuk ka pasur as vullnet dhe as mundësi për t'u takuar me përfaqësues të Kuvendit për t'i diskutuar rekomandimet e dala nga raporti i shoqërisë civile për vitin 2024, i cili adreson mangësi serioze në fushën e të drejtave të njeriut", thotë Shabiu për Radion Evropa e Lirë. Ajo thekson se në këtë situatë kërkesat e shoqërisë civile kanë mbetur jashtë agjendës publike dhe legjislative. Një prej më të rëndësishmeve, sipas saj, është trajtimi i draftit të Kodit Civil. "Mungesa e debatit parlamentar

dhe e konsultimeve publike kuptimplota e ka lënë këtë proces të pezulluar, duke humbur një vit të tërë pa përparim ligjor", thotë Shabiu. Më tutje, ajo thotë se jo vetëm që kërkesat e shoqërisë civile nuk janë adresuar, por se ajo dhe gazetarët janë përballur edhe me përpjekje të diskreditimit dhe delegjitimitit, "përfshirë përmes gjuhës denigruese dhe sulmeve publike, pa pasur reagim adekuat institucional apo mekanizma mbrojtës funksionalë". Disa herë në vitet e fundit Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës e ka kritikuar partinë në pushtet, Lëvizjen Vetëvendosje, dhe anëtarë të saj për gjuhën e përdorur ndaj medie. Së voni një ankesë të tillë kanë bërë edhe Bashkimi Evropian dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë. Jakaj shton se 2025-ta është edhe një vit tjetër në të cilin Kosova ka mbetur pa bërë hapa të mëdhenj në diplomaci të jashtme si, për shembull, anëtarësim në Këshillin e Evropës. "Këto janë pasojat që e tejkalojnë një vit kalendarik dhe rrezikojnë të shndërrohen në probleme strukturore", thotë ai. Sipas tij, pasojat janë të dyanshme: politike dhe financiare. Për më tepër, as kompensimi për to, thotë Jakaj, nuk mund të jetë i shpejtë apo i lehtë. "Realisht, do të duhen të paktën dy deri në tre vjet që të rikuperohet humbja e prodhuar nga mungesa e institucioneve funksionale gjatë vitit 2025. Disa procese mund të rifillojnë, por me kosto më të lartë politike, financiare dhe institucionale", sqaron ai. "Rreziku kryesor është që një pjesë e reformave të humbasin

momentumin dhe besueshmërinë, si brenda vendit, po ashtu edhe në raport me partnerët ndërkombëtarë", shton Jakaj. Ai, po ashtu, thekson se viti i ardhshëm do të jetë vendimtar për ta përshpejtuar agjendën e reformave. Kosova është fare pranë edhe një palë zgjedhjeve për këtë vit. Më 28 dhjetor do të mbahen zgjedhjet e parakohshme parlamentare nga të cilat pritet të dalë legjislatura e dhjetë. Por, Shabiu nga YIHR Kosova nuk është e bindur se, pas formimit të institucioneve të reja nga zgjedhjet e ardhshme, kërkesat e shoqërisë civile do të adresohen. "Aktualisht, vullneti politik mbetet i paqartë", përfundon ajo.

Çfarë bëri Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2025?

Nga 9 janari e deri më 19 dhjetor të këtij viti Qeveria në detyrë e Kosovës i mbajti 39 mbledhje. Në to u morën vendime për emërimë në pozita të larta, shpronësime për projekte infrastrukturore, ndarje të mjeteve për bursat studentore, subvencione për familje në nevojë, mbështetje për projekte kulturore dhe sportive, si dhe masa të ndryshme buxhetore dhe financiare për institucione shtetërore.



KATËR NJOHJE TË REJA NË 2025-n

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Katër njohje brenda një viti. Kosovën e njohën shtet: Kenia, Sudani, Siria dhe Bahamas. Aktualisht Kosova është njohur nga 121 shtete të botës. Këto njohje të reja fuqizuan subjektivitetin ndërkombëtar të vendit tonë. Edhe më të rëndësishme këto njohje i bënë fakti se ato erdhën pas një kohe kur më shumë flitej për rrezikun nga të ashtuquajtura çnjohje sesa për mundësitë e njohjeve të reja. Në vitet e undit, procesi i njohjeve kishte shënuar rënie të ndjeshme, ndërsa shteti i fundit që e kishte njohur Kosovën para

këtij viti ishte Izraeli, në vitin 2021. Pas asaj kohe, përpjekjet diplomatike ishin përqendruar kryesisht në ruajtjen e njohjeve ekzistuese dhe kundërshtimin e fushatave për çnjohje. Këto zhvillime e vendosin vitin 2025 si një moment kthese në diplomacinë e Kosovës, duke dëshmuar se procesi i njohjeve nuk është mbyllur dhe se hapësira për avancim ndërkombëtar vazhdon të ekzistojë. Katër njohjet e reja brenda një viti përbëjnë një sukses të rëndësishëm diplomatik, sidomos në një klimë globale të ndërlikuar dhe

në rrethana ku dialogu politik dhe raportet ndërkombëtare janë gjithnjë e më sfiduese. Njohjet nga shtete të kontinenteve të ndryshme dëshmojnë për shtirjen gjeografike të mbështetjes për Kosovën dhe rrisin peshën e saj në arenën ndërkombëtare. Ato jo vetëm që e konsolidojnë pozitën e Kosovës si shtet sovran, por krijojnë hapësirë për thellimin e bashkëpunimit diplomatik, ekonomik dhe politik me vende të reja, duke hapur perspektiva për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe forume

globale. Në këtë kontekst, këto njohje shërbejnë edhe si përgjigje ndaj narrativave që për vite me radhë e kanë paraqitur Kosovën si shtet me subjektivitet të brishtë ndërkombëtar. Përkundrazi, viti 2025 dëshmon se me angazhim diplomatik dhe koordinim institucional, Kosova mund ta rikthejë vrullin në një proces që për një kohë të gjatë ishte në stagnim. Megjithatë, sfidat mbeten të pranishme. Mungesa e njohjes nga disa shtete fqinje si Bosnjë-Hercegovina dhe Serbia, si dhe nga pesë vende të Bashkimit Evropian (Greqia, Spanja,

Rumania, Sllovakia dhe Qiproja) vazhdon të jetë një pengesë serioze për integrimin e plotë euroatlantik. Kjo e bën edhe më të domosdoshëm forcimin e diplomacisë aktive dhe ndërtimin e partneriteteve strategjike, me synimin që njohjet e vitit 2025 të shërbejnë si bazë për hapa të tjerë përpara. Në këtë prizëm katër njohjet e reja nuk janë vetëm shifra, por sinjale politik ese Kosova mbetet realitet i pakthyeshëm shtetëror në skenën ndërkombëtare dhe se rruga drejt konsolidimit të plotë të subjektivitetit të saj vazhdon.





UÇK-ja DHE HAGA, KOSOVA HYN NË 2026-N DUKE PRITUR VENDIMIN ME PESHË HISTORIKE

Viti 2025 ka qenë i mbushur me ngjarje të shumta për dhe rreth Gjykatës Speciale. Ajo çfarë e ka karakterizuar vitin që po e lëmë pas në raport me Specialen, kanë qenë dëshmitë e dëshmitarëve të mbrojtjes së liderëve të UÇK-së dhe protestat në Prishtinë, Hagë, Strasburg, Tiranë dhe Shkup në të cilat kanë marrë pjesë numër i madh i qytetarëve. Gjatë dëshmimeve të tyre, sidomos të treshes amerikane, Wesley Clark, James Rubin dhe Christopher Hill, të cilit kanë qenë protagonistë gjatë luftës në Kosovë, janë çmontuar argumentet e ZPS-së për UÇK-në. Tashmë kur ZPS-ja dhe mbrojtja kanë përfunduar me paraqitjen e provave, në gjysmën e parë të vitit 2026 pritet të shpallet aktgjykimi për Thačin, Veselin, Selimin dhe Krasniqin. Ky vendim pritet të ketë peshë historike për luftën e UÇK-së, Kosovën dhe shqiptarët

EPOKA
ERE

Lirim GECI

HAGË, DHJETOR/JANAR - Gjykimi maratonik në rastin e liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, tashmë ka hyrë në fazën finale, pasi Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe mbrojtja kanë përfunduar paraqitjen e dëshmitarëve. Bazuar në vendimin e trupit gjyqës, Gjykata Speciale ka vendosur që dosjet përfundimtare të dorëzohen deri më 19 janar të vitit 2026, kurse fjalët finale pritet të paraqiten prej 9, 13, 16 dhe 18 shkurt. Pas fjalëve përfundimtare, gjyqtarët kanë kohë të paktën tre muaj për dhënien e vendimit final. Pra,

vendimi në shkallën e parë për katërshen e UÇK-së mund të jepet në muajin maj, më së largu deri në fillim të qershorit. Ky vendim pritet të ketë peshë historike për luftën e UÇK-së, Kosovën, shqiptarët dhe për rajonin.

Para se të paraqiten këto afate kohore, viti 2025 ka qenë i mbushur me ngjarje të shumta për dhe rreth Gjykatës Speciale. Ajo çfarë e ka karakterizuar vitin 2025 në raport me Specialen, kanë qenë dëshmitë e dëshmitarëve të mbrojtjes së liderëve të UÇK-së dhe protestat në Prishtinë, Hagë, Strasburg, Tiranë dhe Shkup në të cilat kanë marrë pjesë numër i madh i protestuesve. Po gjatë vitit 2025 liderët janë vizituar nga personalitete të ndryshme

politike, përfshirë edhe kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama.

**Dëshmitarët e mbrojtjes
së Thaçit çmontuan
narrativen e prokurorisë
për UÇK-në**

Fillimisht te ndalemi te dëshmitarët që, pas përfundimit të dëshmimeve të dëshmitarëve të prokurorisë, radhën e kanë pasur dëshmitarët e mbrojtjes, veçanërisht ata që ishin ftuar të dëshmonin në favor të Hashim Thaçit dhe të tjerëve në këtë proces gjyqësor. Mbrojtja e Thaçit ka nisur paraqitjen e provave më 15 shtator të vitit 2025. Dëshmitarët e mbrojtjes,

kryesisht zyrtarë të lartë perëndimorë me njohuri të drejtpërdrejtë të ngjarjeve, kanë filluar me James Rubinin, ish-ndihmëssekretar i Shtetit amerikan. Strategji e mbrojtjes ishte të argumentonte se UÇK-ja nuk kishte një strukturë të qartë komanduese dhe se Thaçi, shpesh jashtë Kosovës dhe në rol politik, nuk ushtronte autoritet mbi operacionet. Rubini ka dëshmuar për tri ditë radhazi, ndërsa në sallë ishin të pranishëm si vëzhgues edhe zyrtarë aktualë të Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH). Rubini ka dëshmuar se Thaçi “kishte eprorë nga të cilët duhej të merrte miratim” dhe se ai ishte “më shumë një fytyrë publike

për t'u prezantuar në Perëndim”. “Hashim Thaçi duhej t'u drejtohej këtyre komandantëve të (UÇK-së) për informacion, njohuri, vendime... Kështu që, unë e kam parë duke treguar respekt ndaj tyre për çështjet përmbajtësore të UÇK-së”, ka thënë Rubini.

Dëshmia e tij është mbështetur nga një sërë personalitetesh që e kanë pasuar atë në bankën e dëshmitarëve, nga Paul Williams, ish-këshilltar ligjor i Kosovës, deri te Wesley Clark, gjenerali që kishte udhëhequr fushatën ajrore të NATO-s kundër caqeve të atëhershme jugosllave në vitin 1999. “Më kujtohet që e kam parë Thaçin, sepse ka qenë zëdhënës. Ishte i pastër, i veshur mirë, dukej më



perëndimor se të tjerët. Nuk dukej se kishte qenë në mal, duke luftuar për një ose dy vjet rresht. Ishte e qartë se ai nuk ishte përgjegjës, kishte thënë Clarku.

Clark ishte dëshmitari i fundit i mbrojtjes, duke e përmbyllur dëshminë e tij më 18 nëntor të vitit 2025. Paraqitja e ish-ndihmës sekretarit amerikan të Shtetit, James Rubin, para dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, për të dëshmuar për Hashim Thaçin, ka marrë vëmendje të madhe ndërkombëtare.

Për dëshmitë në Hagë, konkretisht për atë të James Rubinit, ka folur ish-gjyqtari amerikan i EULEX-it, Dean Pineles, i cili ka thënë se Rubinu i njeh shumë mirë zhvillimet e asaj periudhe dhe se dëshmia e tij mund të rezultojë shumë e rëndësishme. “Mendoj se kjo mund të rezultojë të jetë shumë e rëndësishme. Së pari, James Rubini është një diplomat, ish-përfaqësues shumë i respektuar dhe me përvojë të madhe. Ai ka qenë në terren në Kosovë gjatë periudhës së luftës. Ai krijoi një marrëdhënie me Hashim Thaçin në konferencën e paqes në Rambuje të Francës. Rubini, gjithashtu, ka bashkëpunuar me të gjatë demilitarizimit të UÇK-së dhe ka krijuar disa opinione shumë të rëndësishme rreth hierarkisë së UÇK-së dhe rolit të Thaçit brenda asaj hierarkie. Ai ka

arritur në përfundimin se z. Thaçi ishte në thelb fytyra e UÇK-së, por pa autoritet vendimmarrës dhe se ai nuk ishte në majën e hierarkisë që merrte të gjitha vendimet e rëndësishme në terren. Pra, mendoj se kjo dëshmi mund të jetë shumë domethënëse sepse nëse pranohet, ajo minon teorinë e prokurorisë në këtë rast, që ishte se ekzistonte një hierarki shumë e rreptë dhe se z. Thaçi dhe bashkëpërgjegjësit e tjerë ishin në krye të saj dhe kishin autoritet vendimmarrës, duke i bërë ata përgjegjës si pjesë e një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët për të gjitha krimet dhe mizoritë që ndodhën gjatë asaj periudhe të luftës dhe menjëherë pas saj. Pra, mendoj se gjykata duhet ta shikojë shumë nga afër këtë dëshmi”, ka thënë Pineles.



Clarku: Thaçi nuk mban përgjegjësi për aktet e dhunës apo hakmarrjes që kanë ndodhur në Kosovë

Gjenerali amerikan në pension me katër yje, Wesley Clark, i cili ka udhëhequr fushatën ajrore të NATO-s kundër caqeve

ushtarake serbe më 1999, në dëshminë e tij, më 17 tetor, e ka përshkruar UÇK-në si grup i pavarur, i motivuar për të luftuar, por pa zinxhir komandues. “Unë nuk kisha asnjë dyshim se ushtria serbe frikësohej prej tyre, por komandë dhe kontroll (të UÇK-së) apo një forcë të koordinuar nuk kam parë”, ka thënë Clarku.

Clarku ka thënë se Thaçi nuk ishte komandant ushtarak i UÇK-së. I pyetur nëse ka qenë e mundur që UÇK-ja të ketë pasur zinxhir komandues funksional me hierarki të plotë e NATO-ja dhe Shtetet e Bashkuara të mos e kenë ditur, Clarku ka thënë shkurtimisht: “Jo”. “Më kujtohet që e kam parë Thaçin, sepse ishte zëdhënës. Ishte i pastër, i veshur mirë, dukej më perëndimor se të tjerët. Nuk dukej se kishte qenë në mal duke luftuar për një-dy vjet rresht. Ishte e qartë se nuk ishte përgjegjës aty, nuk komandonte aty”, ka thënë ai më 17 nëntor.

Clarku ka thënë se nuk besonte që Thaçi komandonte personat që kryen akte të dhunës pas çlirimit të Kosovës. Clarku është shprehur se nuk kishte dëgjuar për Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së dhe as nuk kishte informacione nëse Thaçi kishte luftuar ose jo. “Unë nuk kam prova e as dëshmi që UÇK-ja ishte prapa kësaj, por kam indikacione që dëshmojnë të kundërtën”, ka thënë Clarku,

teksta u referohej pretendimeve të asaj kohe për dëbimin e rreth 170 mijë serbëve. Në fund të dëshmisë së tij, ai i kërkoi trupit gjykues që ta lejonte të jepte një vlerësim për rastin gjyqësor ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Ai ka përsëritur bindjen që Thaçi nuk mban përgjegjësi për aktet e dhunës apo hakmarrjes që kanë ndodhur në Kosovë. “E kam ndjekur këtë gjykim dhe i qëndroj bindjes së mëparshme që Hashim Thaçi nuk është përgjegjës për atë çfarë ka ndodhur në Kosovë. Ai nuk mban përgjegjësi për aktet individuale të dhunës ose të hakmarrjes”, ka thënë Clarku, duke shtuar se UÇK-ja nuk ishte terroriste pasi pjesëtarët e saj luftuan për lirinë e tyre.



Rubin: Roli i Thaçit ishte më shumë politik

Ish-ndihmëssekretari amerikan i Shtetit, James Rubin, gjatë dëshmisë së tij më 16 shtator, ka thënë se UÇK-ja ishte pa “kontroll dhe komandë efektive”. “Nuk u thoshte Hashimi komandantëve se çfarë të bënin, por komandantët i thoshin atij”, ka thënë Rubinu. Sipas dëshmisë

së tij, në qershorin e vitit 1999 në Kosovë nuk kishte një qeveri të përkohshme funksionale, dhe as një Shtab të Përgjithshëm të organizuar të UÇK-së. “Shpesh ata e ekzagjeronin, për ta krijuar përshtypjen se ishin më të organizuar sesa ishin në të vërtetë, dhe për të treguar se përfaqonin parimet demokratike”, ka thënë Rubin. Ai e ka përshkruar rolin e Thaçit në UÇK si politik, duke theksuar se nuk kishte autoritet të plotë mbi komandantët. Rubini ka thënë se marrëdhëniet e Thaçit me Shtetet e Bashkuara ishin të veçanta dhe të një rëndësie të jashtëzakonshme për të. Ai ka theksuar se që nga takimi i parë, kishte krijuar përshtypjen se Thaçi e shihte Amerikën si simbol të fuqisë dhe si pasqyrim të asaj që ai e konsideronte si shtet i fortë dhe i besueshëm.



Hill: UÇK-ja, organizatë pa strukturë vertikale dhe pa organizim hierarkik

I dërguari i posaçëm i ShBA-së gjatë luftës në Kosovë, Christopher Hill, në dëshminë e tij, më 10 tetor, e ka



Gjyqi ndaj UÇK-së, Prishtina, Haga, Tirana, Strasburgu dhe Shkupi dhe Strasburgu për drejtësi

Gjatë vitit 2025 janë organizuar disa protesta në mbështetje të liderëve të UÇK-së të cilët janë duke u gjykuar në Hagë. Protesta e parë është mbajtur në muajin gusht në Prishtinë ku kishin marrë pjesë një numër i madh anekënd Kosovës, por edhe viset e tjera

ku ka shqiptarë. Organizatorët e kësaj proteste, por edhe qytetarët, kanë vlerësuar se Gjykata Speciale është duke e deformuar historinë e Kosovës. Protestuesit e kanë cilësuar Specialen si kundër UÇK-së dhe kundër Kosovës. Motoja e protestës ishte

“Kundër padrejtësisë! Në mbrojtje të UÇK-së dhe së vërtetës”. Të njëjtat thirrje janë dëgjuar edhe në Hagë, Tiranë, Strasburg dhe Shkup. Këto protesta, sidomos ajo në Tiranë, ishte masive sa i përket numrit të pjesëmarrësve.



përshkruar UÇK-në organizatë pa strukturë vertikale dhe pa organizim hierarkik. Hilli ka thënë se UÇK-ja tentonte ta bindte ShBA-në se ishte organizatë dhe ushtri e strukturuar mirë, por kjo nuk kishte bazë në terren. Ai ka thënë se përshtypja e tij ishte që Thaçi nuk ishte një figurë vendimmarrëse brenda UÇK-së, pasi ka kujtuar se gjatë negociatave në Rambuje atij i duhej të konsultohet paraprakisht me të tjerët brenda UÇK-së dhe nuk mund të merrte vendime krye më vete. Diplomati amerikan në pension ka thënë se nuk kishte informacione se Thaçi ishte përshtirë në ndonjë aktivitet të paligjshëm të shkëljes të të drejtave të njeriut.



Durkee: UÇK-ja nuk kishte strukturë e organizuar mirë

Michael Durkee, ish-këshilltar i Wesley Clarkut, gjatë dëshmisë së tij në Hagë, ka thënë se UÇK-ja nuk kishte strukturë të organizuar mirë dhe se komandantët e zonave kishin autonomi të madhe. “Pra, nuk kishte një zinxhir të konsoliduar komande në kuptimin e

koordinimit të autoritetit të drejtpërdrejtë të komandës, siç e kuptojnë në ushtritë perëndimore”, ka thënë ai. I pyetur nëse Hashim Thaçi mund ta ndalonte dhunën në atë kohë, ai e ka mohuar një gjë të tillë. “Nuk kishte kompetencë, nuk kishte autoritet Hashim Thaçi për ta bërë këtë gjë atëkohë. Ne kishim këtë përshtypje që nuk kishte një strukturë solide ose të konsoliduar komanduese që dikush të ishte në nivel të lartë në Prishtinë dhe të jepte urdhra të cilat më pas do të çonin në veprime ose në operacione të caktuara në terren nëpër zona operative. Komandantët e zonave operative kishin autonomi të konsiderueshme dhe ekzistonte vullneti i tyre për të vepruar me kokën e tyre kur ata e mendonin të përshtatshme”, ka thënë Durkee.



Duncan: UÇK-ja pa hierarki formale, Thaçi s'jepte urdhra

Ish-diplomati britanik John Stewart Duncan, këshilltar politik i ish-komandantit të NATO-s, Wesley Clark, gjatë viteve 1998-2001 ka dëshmuar

në Hagë se UÇK-ja nuk kishte një hierarki ushtarake të formalizuar, por një organizim të shpërndarë ku pushteti real qëndronte te komandantët rajonalë, që e kishte detyruar NATO-n të bisedonte drejtpërdrejt me ta për çmilitarizimin. “Si rregull, NATO-ja do t'i ftonte komandantët e lartë dhe do të bëhej një marrëveshje në mes të gjeneralit Clark dhe cilitdo që do të ishte nga pala tjetër. Nuk do të shkonim kurrë në nivel rajonal. Kjo shërben për ta kuptuar strukturën hierarkike. Pra, si funksiononte atje”, ka thënë ai. Sipas tij, Thaçi nuk kishte legjitimitet të plotë demokratik në atë kohë dhe shumë vendime kërkonin pëlqimin e komandantëve të zonave. Ai ka deklaruar se “nuk e ka parë” Thaçinin të jepte urdhra apo direktiva.



Williamsi në Hagë: Thaçi kishte presion nga komandantët

Ish-këshilltari i ekipit të Kosovës në Rambuje, Paul Williams, ka thënë se Hashim Thaçi kishte presion nga komandantët lokalë. Ai ka theksuar se edhe Adem

Demaçi po pengonte progresin e bisedimeve e që, si rezultat, Thaçi kishte shkuar ta takonte në Slloveni. “Kishte trysni nga jashtë, nga komandantët lokalë. Kishte presion ideologjik, kulturor, prej Adem Demaçit, i cili po pengonte progresin e negociatave. Po them me të ngjarë, po cenonte lëvizjen për realizimin e marrëveshjes. Prandaj, duhej trajtuar ky aspekt (pavarësia)”, ka thënë Williams. **Njeriu më i afërt i Bernard Kouchnerit: UNMIK-u nuk**



e ka trajtuar Thaçinin si komandant

Jock Covey, ish-zëvendës në UNMIK i Bernard Kouchnerit, gjatë dëshmisë në Hagë, ka thënë se raporti i Hashim Thaçit me komandantët e UÇK-së kishte qenë i ndërlikuar. Madje ai ka thënë se komandantët kishin shfaqur mungesë respekti ndaj Thaçit. “Kur Jackosni pati nevojë t'i sillte komandantët e UÇK-së, t'i rivendoste aty, t'i bindte ata që t'i pranonin kushtet e zbatimit të marrëveshjes për krijimin e

TMK-së, si organizatë civile e paarmatosur, KFOR-i ishte afër afatit kohor që ishte dhënë, dhe duhej ndihmë për t'i bindur komandantët që të jepnin përgjigje pozitive. Clarku bëri prezantim shumë të fuqishëm, të zgjatur për rëndësinë e legjendës së Cincinatit, bile hoqi edhe xhakatën e tij që ishte i paarmatosur, dhe iu nënshtrua kontrollit civil. Në fund të paraqitjes së Clarkut, Jackosni bëri pushim, njerëzit morën pije. Të gjithë ishin aty, përveç Thaçit, i cili qëndroi aty ku ishte. Komandantët e tjerë po bisedonin me gjeneralin Clark. Unë me qëllim nuk pata shkëmbime me Thaçinin, as nuk kam shikuar në drejtim të tij. Si vëzhgues m'u duk se sjellja e tyre ishte përcmuese ndaj tij. Kishte shumë pak gjasa të kërkonin udhëzime, apo urdhra, apo t'i raportonin aktivitetet tek ai”, ka thënë Covey, duke shtuar se Agim Çeku ishte individ i me më së shumti ndikim në UÇK. Ai ka thënë se UNMIK-u nuk e ka trajtuar Thaçinin si komandant i UÇK-së. “Unë flas në emër të UNMIK-ut. UNMIK-u nuk e ka trajtuar atë (Thaçinin) si komandant”, ka thënë Covey.

Liderët e UÇK-së do të mund të flasin nga 20 minuta gjatë paraqitjes së fjalëve finale

Sipas agjendës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi e Jakup Krasniqi do të mund të flasin nga 20 minuta nëse duan në seancat e fundit. Prokuroria do ta ketë kohën e saj prej 5 orësh e 30 minuta ditën e hënë, më 9 shkurt. Të martën, më 10 shkurt, Prokuroria do të vazhdojë edhe prej 2 orë e gjysmë, pra 8 orë në total. Të martën, gjithashtu, do ta thotë fjalën përfundimtare avokati i viktimave që ka kërkuar dy orë kohë. Të mërkurën fjalën finale e thotë mbrojtja e Thaçit prej 4 orë e gjysmë. Të mërkurën pasdite, dhe të enjten, mbrojtja e Veselit, më pas e Krasniqit dhe e Selimit. Të hënë e 16 shkurtit trupi gjyqës do të adresojë pyetje nëse ka. Të mërkurën, më 18 shkurt, do ta ketë kohën për përgjigje Prokuroria prej 2 orë e gjysmë, e më pas komente nga secili avokat mbrojtës, kurse krejt në fund janë fjalët finale nga krerët e UÇK-së, ku secili ka nga 20 minuta.





Ekonomia e Kosovës më 2025: INFLACION I LARTË, liberalizim i tregut të energjisë dhe rritje e kamatave

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, DHJETOR / JANAR - Viti 2025 u karakterizua nga sfida të mëdha ekonomike për Kosovën. Inflacioni i lartë vazhdoi ta rëndojë fuqinë blerëse të qytetarëve, ndërsa liberalizimi i tregut të energjisë solli pasiguri dhe kosto shtesë për familjet dhe bizneset. Në të njëjtën kohë, rritja e kamatave për kredi e bëri më të vështirë qasjen në financim, duke ndikuar drejtpërdrejt në konsumin dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Dhjetori i gëzueshëm me nga 100 euro për fëmijët dhe pensionistët

Qeveria në detyrë e drejtuar

nga Albin Kurti edhe në këtë dhjetor të 2025-s ka bërë transferimin e shtesës prej 100 eurove për fëmijët 0-16 vjeç, si dhe për përfituesit e pensioneve bazike, kontributeve, kategoritë e luftës, aftësive të kufizuara, dhe skemave të tjera sipas kritereve të përcaktuara në vendim.

300 milionë euro nga investimet për vitin 2025

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) ka njoftuar se deri më 24 dhjetor 2025 ka realizuar një kthim bruto nga investimet prej 312 milionë eurosh, duke e bërë vitin 2025 një nga më të suksesshmit në historinë e institucionit. Sipas

njoftimit, meqë për vitin 2024 kthimi bruto nga investimet ishte rreth 244 milionë euro, rezultojnë se vetëm në dy vitet e fundit FKPK-ja ka akumuluar kthim bruto nga investimet prej rreth 556 milionë euro.

Dogana gjatë vitit 2025 ka mbledhur 1 miliard e 968 milionë euro

Dogana e Kosovës gjatë vitit 2025 ka mbledhur 1 miliard e 968 milionë euro, ka njoftuar drejtori i këtij institucioni, Agron Llugaliu. Ai në një konferencë për medie në fundvit tha se kjo shumë është 135 milionë euro më shumë sesa në vitin 2024 dhe 75 milionë euro më shumë sesa në projeksionin e bërë në fillim të vitit 2025.

ATK-ja: Mbi 1 miliard euro të hyra të mbledhura nga tatimet

Gjatë këtij viti Administrata Tatimore e Kosovës ka arritur të mbledhë mbi 1 miliard euro të hyra nga tatimet, duke thyer të gjitha rekordet e mëparshme dhe duke shënuar një moment historik për financat publike të Republikës së Kosovës. Ky rezultat pasqyron rritjen e përmbushjes vullnetare tatimore, forcimin e administrimit tatimor dhe efektet pozitive të reformave institucionale.

Punëtorët e KEK-ut kërkojnë rritje pagash

Sindikata e Re e Korporatës Energetike të Kosovës (SRKEK)

ka mbajtur një protestë në dhjetor në sheshin "Nënë Terezë" për rritje pagash, ku punëtorët kërkuar trajtim më të drejtë dhe përmirësim të kushteve ekonomike në përputhje me përgjegjësitë dhe rrezikun e punës së tyre. Ata kërkuar që paga mesatare t'u rritet në 1 100.00 euro.

Qeveria Kurti rrit pagat në sektorin publik

Qeveria e Kosovës, nën udhëheqjen e kryeministrit Albin Kurti, ka rritur pagat në sektorin publik me dy etapa gjatë vitit 2025: 55 euro më shumë nga janari 2025 dhe 55 euro shtesë nga korriku 2025, duke sjellë gjithsej 110 euro rritje për punonjësit publikë. Rritja realizohet duke shtuar



koeficientet, jo vlerën e koeficientit, një masë që do t'i kushtojë rreth 120 milionë euro buxhetit të shtetit.

BE-ja mbi 180 milionë euro fonde shtesë nga IPA për Kosovën

Bashkimi Evropian ka liruar në muajin dhjetor 181 milionë euro fonde shtesë në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) për Kosovën, duke riafirmuar rolin e tij si partneri më i fuqishëm dhe ofruesi më i madh i asistencës financiare për vendin. Po ashtu, sipas Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, Kosovës i janë dedikuar gjithsej 882 milionë euro fonde që synojnë nxitjen e zhvillimit ekonomik,

reformave dhe afrimit me standardet evropiane.

Rritet paga minimale

Qeveria në detyrë e Kosovës ka miratuar rritjen e pagës minimale, e cila do të arrijë në 500 euro deri në korrik të vitit 2026. Paga minimale, e cila është 350 euro, do të rritet në dy faza, fillimisht në 425 euro në janar, ndërsa në korrik do të bëhet 500 euro në muaj për të gjithë punëtorët me orar të plotë.

Kosova pranohet në Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian

Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian (EESC) është bërë institucioni i parë i Bashkimit

Evropian që ka vendosur të pranojë anëtarë nga Kosova. “Me këtë nismë shpresojmë të fuqizojmë projektet që nxisin dialogun civil dhe social, duke forcuar angazhimin dhe bashkëpunimin brenda komuniteteve kosovare”, thuhet në thirrjen e publikuar në uebfaqen e këtij komuniteti.

Kosova merr në kontroll objekte në Graçanicë dhe Shtërpçë

Posta e Kosovës ka marrë kontrollin e objekteve në Graçanicë dhe Shtërpçë ku ndodhej Posta e Serbisë. Posta e Kosovës njoftoi mbrëmjen e 11 shtatorit se pas finalizimit të procedurave ligjore, këto prona, që tha se ishin shfrytëzuar nga një operator ilegal, tani janë

regjistruar si pronë e ligjshme e Postës së Kosovës. “Posta e Kosovës mbetet e përkushtuar në ofrimin e shërbimeve postare e financiare cilësore, të sigurta dhe transparente në gjithë territorin e vendit”.

Kompanitë mund të largohen nga Kosova për shkak të rrymës

Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka paralajmëruar se kompani vendëse, por edhe investitorë të huaj, janë duke e shqyrtuar mundësinë që të largohen nga Kosova për në vendet e rajonit për shkak të liberalizimit të tregut të energjisë. Kompanitë që nuk kishin lidhur kontratë për furnizim të energjisë elektrike u shkëputën nga rrjeti elektrik.

Kreu i AKB-së, Agim Shahini, e cilësoi si “goditje të rëndë dhe të padrejtë” ndaj ekonomisë së vendit. Sipas tij, mbi 200 kompani me mbi 10 000 punëtorë u shkëputën nga rrjeti elektrik, duke shtuar se dëmi është milionësh.

Investimet jashtë Kosovës rriten për 55 %

Investimet direkte të bizneseve të Kosovës jashtë vendit po rriten ndjeshëm, duke arritur në 166.6 milionë euro në gjysmën e parë të këtij viti. Kompanitë po e braktisin tregun e Kosovës për shkak të burokracisë, mungesës së digjitalizimit, kostos së lartë të energjisë dhe kushteve më të favorshme në vende të rajonit. Ekspertët thonë se largimi i bizneseve dëmton rëndë





ekonominë e Kosovës, duke ulur të hyrat publike dhe duke rritur varësinë nga importet.

Përplasjet politike lënë Prishtinën pa transport publik

Banorët e kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës, gjatë fundit të muajit nëntor dhe fillimit të dhjetorit janë detyruar të bëjnë zgjidhje alternative në mungesë të transportit publik. Qeveria në detyrë dhe zyrtarët komunalë kanë vazhduar të mos i kursejnë akuzat ndaj njëri-tjetrit për situatën e komplikuar me financat në komunë dhe shkaktimin e këtij kaosi. Por, një gjë dihet: Komuna e Prishtinës e ka miratuar me vonesë buxhetin për vitin 2025, rrjedhimisht Ministria e Financave e ka hartuar një version të buxhetit për të.

Liberalizimi i energjisë rriti çmimet, uli kapacitetet

Rritja mbi 100 % e çmimit të rrymës, pas liberalizimit të tregut të energjisë, ka detyruar shumë biznese t'i pezullojnë punësimet dhe ta ndalojnë zgjerimin e linjave prodhuese. Nga 27 kompani të licencuara për tregtim e kanë bërë konkurrencën minimale dhe

çmimet e furnizimit pothuajse të pandryshueshme. Bizneset po kërkojnë zgjidhje tek energjia diellore për ta ulur varësinë nga tregu i hapur dhe për t'i mbrojtur të ardhurat dhe vendet e punës.

Rriten kamatat për kredi

Normat e interesit në bankat komerciale në Kosovë kanë shënuar rritje të ndjeshme nga muaji gusht i vitit që po lëmë pas, duke rënduar buxhetet familjare dhe planet investuese të bizneseve. Dallimi ishte i dukshëm: disa banka ofruan kredi me norma interesi mbi 7 %, njëra 8 % - nga rreth 6 % sa ishin më parë - ndërsa për bizneset normat ngjiteshin mbi 10 %. “Kamatat janë rritur shumë”, por askush nuk dha një shpjegim të qartë pse. Ekspertët sugjerojnë se konkurrenca më e madhe në treg, përkatësisht licencimi i bankave të reja, mund t'i ulë kamatat.

Familjet e Kosovës u përballen nën presionin e inflacionit

Familjet në Kosovë po përballen me rritje të lartë të çmimeve, duke shpenzuar më shumë, por duke blerë më pak. Anketa e IRI-së zbulon se 45 % e qytetarëve e konsiderojnë koston e jetesës si

problemin kryesor, një rritje nga 28 % vitin e kaluar. Agjencia e Statistikave e Kosovës ka njoftuar se për muajin nëntor 2025 ka pasur një rritje vjetore të çmimeve prej 5.3 % dhe një rritje mujore prej 0.4 %. Rritja është shënuar në pemë, energji elektrike, mish, qumësht, djathë dhe vezë.

Mediana e pagave: Kosovën e lënë prapa vendet e tjera evropiane

Mediana e pagave e ndan të gjithë fuqinë punëtore të një vendi në dy gjysma: gjysma e punëtorëve fitojnë më pak se kjo shumë e gjysma tjetër më shumë. Meqë nuk ndikohet nga pagat shumë të larta apo shumë të ulëta, siç ndodh me pagën mesatare, ajo vlerësohet se e tregon më mirë standardin e jetës në një vend. Në Kosovë, mediana e pagave është më e ulët sesa e të gjitha shteteve të Bashkimit Evropian, dhe të paktën disa shtete të rajonit, si Shqipëria e Serbia.

Bizneset bllokojnë Prishtinën

Kompani të shumta në Kosovë protestuan në Prishtinë më 29 maj kundër liberalizimit të tregut të energjisë i cili hyri në fuqi më 1 qershor 2025. Për dy

orë përfaqësuesit e tyre bllokuan hyrjet kryesore të kryeqytetit, duke paralajmëruar se do të përballen me rritje drastike të çmimeve dhe mungesë të ofertave reale. Derisa Zyra e Rregullatorit për Energji refuzon ta shtyjë afatin, qeveria në detyrë e kritikoi Odën Ekonomike të vendit duke thënë se ajo “nuk ka bërë asgjë” për t'i përgatitur bizneset për procesin.

ZRRE rrit për 16 % çmimin e rrymës, qytetarët protestojnë

Rritja e çmimit të energjisë për rreth 16 për qind u kundërshtua përmes protestave në Prishtinë më 11 prill. Qindra qytetarë kërkuan anulimin e vendimit të miratuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Të prekur nga shtrenjtimi, ata e shohin këtë masë si një barrë të padurueshme për jetesën e tyre.

Dinari serb - i ndaluar në rregullore, i pranuar në treg

Tash e një vit Kosova e nxori jashtë ligjit dinarin serb, por në veri të vendit paraja e gjen rrugën. Ndërsa bankat e refuzojnë, dyqanet dhe shitësit ende e pranojnë - disa më hapur, të tjerët më në hije. Për

shumë qytetarë ndalesa nuk i ka ndaluar transaksionet, thjesht i ka bërë më të komplikuar.

Kosova shpenzoi gati 900 milionë euro për mall kinez

Kosova shpenzon mbi dy milionë euro brenda një dite për mallra të importuara nga Kina - nga lodrat dhe pajisjet elektroshtëpiake deri te produktet ushqimore dhe ato bujqësore. Të dhënat flasin për një prani gjithnjë e më të madhe të këtyre mallrave në tregun e Kosovës. Sipas statistikave të Doganës së Kosovës, vlera e importit nga Kina është rritur nga 452 milionë euro në vitin 2021 në 841 milionë euro në 11 muajt e parë të vitit 2025.

Bankat rritin tarifat e disa shërbimeve për 100 %

Një pjesë e bankave komerciale në Kosovë këtë vit kanë shtrenjtuar disa prej shërbimeve për klientët e tyre. Ngritje kanë pasur edhe tarifat për tërheqje të parave në degë, mirëmbajtje të kartelës e aplikacionit e-banking. Ngritja e tarifave po ndodh disa muaj pasi bankat realizuan fitime rekorde në Kosovë.





ROLI I KULTURËS POLITIKE NË FRENIMIN E PROCESIT TË KONSTITUIMIT TË INSTITUCIONEVE NË KOSOVË GJATË VITIT 2025



Shkruan: Prof. dr. Ibrahim GASHI

Viti 2025 përfaqëson një nga periudhat më kritike për funksionimin institucional dhe stabilitetin demokratik të Republikës së Kosovës që nga shpallja e pavarësisë. Procesi i konstituimit të institucioneve pas zgjedhjeve parlamentare - Kuvendit, Qeverisë dhe organeve të tjera kushtetuese – është shndërruar në një krizë të thellë politike, duke nxjerrë në pah jo vetëm dobësi strukturore të sistemit politik, por edhe probleme të rrënjësura në kulturën politike të elitave dhe aktorëve institucionalë. Ky studim argumenton se kultura politike ka luajtur një rol kyç në frenimin dhe bllokimin e procesit të konstituimit institucional gjatë vitit 2025.

Në literaturën e shkencave politike, kultura politike kuptohet si tërësia e vlerave, normave, qëndrimeve dhe modeleve të sjelljes që strukturojnë marrëdhënien e aktorëve politikë me pushtetin dhe institucionet. Një kulturë politike konsensuale dhe bashkëpunuese është parakusht për funksionimin e demokracive parlamentare, veçanërisht në sisteme të fragmentuara dhe pluraliste. Në rastin e Kosovës, kultura politike

mbetet e brishtë dhe e karakterizuar nga elemente konfliktuale, çka ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e sistemit për të prodhuar stabilitet institucional. Në përgjithësi, niveli dhe struktura e kulturës politike të një shoqërie lidhen ngushtë me ekzistencën dhe jetëgjatësinë e shtetit dhe të institucioneve të tij. Në rastin e Kosovës, mungesa historike e shtetësisë dhe përvoja e gjatë e sundimit të jashtëm kanë prodhuar një kulturë politike fragmentare dhe shpesh kontradiktore. Shteti aktual i Kosovës karakterizohet nga bashkëjetesa e tre shtresave kryesore kulturore: idealeve të demokracisë liberale, traditës së fuqishme të organizimit fisnor dhe legacisë së sistemit socialist. Këto elemente vazhdojnë të ndikojnë mënyrën se si qytetarët e perceptojnë shtetin dhe marrëdhënien e tyre me institucionet publike. Periudha e pasluftës, e përkufizuar shpesh si fazë tranzicioni, ka ekspozuar tensionet ndërmjet këtyre shtresave, duke i bërë ato të dukshme në sjelljen politike dhe sociale.

Një nga manifestimet më të qarta të kësaj kulture politike

problematiche gjatë vitit 2025 ishte pamundësia e subjekteve politike për të ndërtuar shumicë funksionale parlamentare. Fragmentarizimi i skenës politike, mungesa e koalicioneve parazgjedhore dhe refuzimi i kompromisit pas zgjedhjeve dëshmojnë dominimin e një logjike përjashtuese, ku kundërshtari politik shihet si pengesë dhe jo si partner potencial në qeverisje. Në këtë kontekst, zgjedhjet nuk prodhuan stabilitet demokratik, por thelluan bllokadën institucionale dhe pasigurinë politike.

Një tjetër dimension i rëndësishëm i rolit të kulturës politike në krizën e vitit 2025 lidhet me instrumentalizimin e institucioneve dhe interpretimin selektiv të normave kushtetuese. Partia fituese e zgjedhjeve, madje me një fitore bindëse (48 deputet), por në ndonjë rast edhe aktorët tjerë politikë, i trajtuan institucionet jo si mekanizma të interesit publik, por si mjete për avancimin e agjendave partiake. Kjo qasje u reflektua në zvarritjen e procedurave, bllokimin e seancave konstituive dhe përdorimin e

procedurave ligjore si armë politike, por shpesh edhe duke shkelur kushtetutën me pretendime se po “mbrojnë” rregulloret dhe ligjin. Një sjellje e tillë jo vetëm që pengoi konstituimin institucional, por minoi edhe besimin e qytetarëve në rendin kushtetues dhe demokracinë përfaqësuese.

Pasojat institucionale dhe ndërkombëtare

Kriza e konstituimit institucional në vitin 2025 nuk mbeti e kufizuar vetëm brenda sferës politike të brendshme, por prodhoi pasoja të thella dhe shumëdimensionale në funksionimin e shtetit dhe në pozicionimin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. Mungesa e institucioneve legjitime dhe funksionale dobësoi ndjeshëm kapacitetin shtetëror për të ndërmarrë reforma ekonomike dhe sociale, për të garantuar qeverisje efektive dhe për të menaxhuar çështjet e sigurisë kombëtare. Paraliza institucionale ndikoi drejtpërdrejt edhe në proceset vendimmarrëse, duke krijuar një vakum politik që u reflektua në pasiguri të brendshme dhe

paqartësi strategjike. Në planin ndërkombëtar, dështimi për të konstituuar institucionet shtetërore kontribuo i në vazhdimin dhe thellimin e masave ndëshkuese të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës, të cilat u justifikuan me mungesën e stabilitetit institucional, paaftësinë për të garantuar zbatim të marrëveshjeve dhe deficitin e përgjegjësisë politike. Këto masa jo vetëm që ndikuan negativisht në procesin e integritetit evropian, por prodhuan edhe pasoja të drejtpërdrejta ekonomike dhe zhvillimore, duke kufizuar qasjen në fonde, projekte dhe mekanizma mbështetës të BE-së. Në këtë mënyrë, kriza e brendshme institucionale u shndërrua në pengesë strukturore për avancimin ndërkombëtar të Kosovës.

Një pasojë edhe më e ndjeshme ishte krisja e marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila u manifestua përmes ndërprerjes apo pezullimit të elementeve të partneritetit strategjik. Për herë të parë pas pavarësisë, Kosova u perceptua nga aleati i saj kryesor si një shtet me deficit serioz funksional dhe mungesë



POLITIKA E JASHTME GLOBALE NË NJË BOTË ME SHUMË KRIZA



Shkruan: Valon MURTEZAJ, *profesor universitar në Paris*

Viti 2026 është shumë i shkurtër për të sjellë një rend të ri botëror. Por, në kohët që po jetojmë, edhe një vit i vetëm është i mjaftueshëm për të thelluar më tej mungesën e këtij rendi. Kjo sepse sistemi ndërkombëtar po bëhet gjithnjë e më i fragmentuar, më i paqëndrueshëm dhe, rrjedhimisht, më i paparashikueshëm. Politika e jashtme bashkëkohore po tregohet se e ka të vështirë t'i zgjidhë konfliktet përfundimisht, duke bërë që ato të kthehen në procese të zgjatura, me fillim dhe fund të paqartë. Shtetet e Bashkuara mbeten aktori kryesor global, por veprojnë në një botë të mbingarkuar me

kriza. Fuqia ushtarake, pesha në sistemin ndërkombëtar dhe diplomacia po plotësojnë njëra-tjetrën, ndërsa kufijtë e ndërhyrjes tradicionale në një sistem ndërkombëtar të fragmentuar nuk janë më plotësisht të qartë. Evropa, nga ana tjetër, në një mënyrë po zgjohet nga një iluzion i gatë post-historik. Lufta në Ukrainë e ka detyruar Bashkimin Evropian të mendojë më shumë në terma sigurie dhe force. Investimet në mbrojtje, pavarësia energjetike dhe mbrojtja e infrastrukturës kritike po shndërrohen në prioritet strategjike afatgjata. Lufta e shkaktuar nga invazioni rus në Ukrainë mbetet një burim

tensioni global. Edhe nëse intensiteti i luftimeve bie apo arrihet një marrëveshje, për të cilën po punohet intensivisht, pasojat e këtij konflikti do të vazhdojnë të ndikojnë rendin ndërkombëtar. Rusia po sfidon Perëndimin. Lindja e Mesme mbetet një rajon konfliktesh jo vetëm të ngrira, por edhe të përsëritura, duke prodhuar vazhdimisht kriza që rezonojnë shumë përtej kufijve të saj dhe ndikojnë drejtpërdrejt stabilitetin global. Kina, ndërkohë, po investon në ndikim afatgjatë përmes tregtisë, teknologjisë dhe diplomacisë, duke shfaqur njëkohësisht fuqinë e saj ushtarake, por pa kërkuar përplasje të

drejtpërdrejta. Strategjia kineze, siç duket, synon zgjerimin gradual të ndikimit pa rrezikuar konflikte të hapura. Ndërkohë, pjesa tjetër e botës nuk është krejtësisht spektatore. Rajone dhe shtete të ndryshme në kontinente të ndryshme po veprojnë si aktorë aktivë dhe, në shumë raste, po shfrytëzojnë rivalitetin mes fuqive të mëdha për të rritur autonominë dhe peshën e tyre në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Këtu mund të përmendim vende si India, si dhe zhvillimet në Amerikën Latine. Siç duket, në vitin 2026, politika e jashtme globale do të formësohet nga një botë që po mëson, ose ende nuk po mëson,

të funksionojë pa një rend botëror të qartë. Në këtë kontekst, Kosova duhet të mësojë të veprojë pa tronditje të mëdha, siç ishte viti 2025. Kjo, në terma më të thjeshtë, nënkupton nevojën për institucione qeverisëse të plota dhe funksionale, si dhe angazhim të qartë në forcimin e aleancave euro-atlantike. Vetëm përmes kësaj rruge, Kosova mund të sigurojë fuqizimin e saj në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të perceptohet e të pranohet si një aktor i përgjegjshëm dhe serioz, gjë kjo e cila, për një shtet të ri si Republika e Kosovës, është më shumë se e rëndësishme. Gëzuar 2026!

vullneti politik për të respektuar standardet demokratike dhe institucionale. Kjo situatë sinjalizoi një moment kritik në raportet Kosovë-ShBA, duke dëshmuar se mbështetja ndërkombëtare nuk është e pakushtëzuar, por e ndërlidhur ngushtë me funksionimin e brendshëm demokratik dhe institucional. Për më tepër, paraliza institucionale e vitit 2025 ndikoi edhe në rreshtimet e Kosovës në politikën e jashtme, duke e dobësuar koherencën dhe qartësinë strategjike të saj. Mungesa e një qeverie funksionale dhe e një Kuvendi të konsoliduar e kufizoi aftësinë

e Kosovës për të vepruar si aktor i besueshëm ndërkombëtar, duke krijuar hapësirë për rreshtime ad-hoc, të paqëndrueshme dhe shpesh kontradiktore me interesat afatgjata shtetërore. Në këtë kontekst, Kosova u perceptua më shumë si objekt i politikës ndërkombëtare sesa si subjekt aktiv i saj. Roli i faktorëve ndërkombëtarë, megjithëse i rëndësishëm, mbeti i kufizuar përballë mungesës së vullnetit politik vendor dhe deficitit të kulturës politike konsensuale. Thirrjet e vazhdueshme për përgjegjësi, kompromis dhe respektim të rendit kushtetues nuk

prodhuan efekt të qëndrueshëm, duke dëshmuar se pa transformim të thellë të kulturës politike të brendshme, mbështetja apo presioni ndërkombëtar mbetet i pamjaftueshëm për të garantuar funksionim institucional. Kjo situatë e bëri të qartë se stabiliteti ndërkombëtar i Kosovës është i kushtëzuar drejtpërdrejt nga kapaciteti i saj për të ndërtuar institucione funksionale dhe për të kultivuar përgjegjësi politike të brendshme. Nga perspektiva analitike, viti 2025 mund të interpretohet si një pikë kthese për zhvillimin institucional të Kosovës. Ai

shton dilemë të qartë: ose vazhdimin e modeleve ekzistuese të sjelljes politike, të karakterizuara nga konfrontimi dhe mungesa e kompromisit, ose fillimin e një reflektimi të thellë mbi nevojën për transformim të kulturës politike. Vendosija e interesit shtetëror mbi kalkulimet afatshkurtra partiake, forcimi i dialogut politik dhe respektimi i rregullave demokratike përbëjnë elemente thelbësore për tejkalimin e krizave të ngjashme në të ardhmen. Në përfundim, frenimi i procesit të konstituimit të institucioneve në Kosovë gjatë vitit 2025 nuk mund të kuptohet vetëm si

rezultat i rrethanave politike momentale apo i aritmetikës parlamentare. Ai është, në thelb, pasqyrim i një kulture politike ende të pazhvilluar, ku mungojnë kompromisi, besimi institucional dhe përgjegjësia shtetërore. Sfida e vitit 2025 nuk është e papërtejkaleshme në kuptimin strukturor, por ajo bëhet e tillë nëse vazhdohet me të njëjtat modele sjelljeje politike. E ardhmja demokratike dhe institucionale e Kosovës varet nga aftësia e elitave politike për të ndërtuar një kulturë të re politike, të bazuar në bashkëpunim, respekt institucional dhe vizion afatgjatë për shtetin.



ROLI I KULTURËS POLITIKE NË FRENIMIN E PROCESIT TË KONSTITUIMIT TË INSTITUCIONEVE NË KOSOVË GJATË VITIT 2025



Shkruan: Prof. dr. Ibrahim GASHI

Viti 2025 përfaqëson një nga periudhat më kritike për funksionimin institucional dhe stabilitetin demokratik të Republikës së Kosovës që nga shpallja e pavarësisë. Procesi i konstituimit të institucioneve pas zgjedhjeve parlamentare - Kuvendit, Qeverisë dhe organeve të tjera kushtetuese – është shndërruar në një krizë të thellë politike, duke nxjerrë në pah jo vetëm dobësi strukturore të sistemit politik, por edhe probleme të rrënjësura në kulturën politike të elitave dhe aktorëve institucionalë. Ky studim argumenton se kultura politike ka luajtur një rol kyç në frenimin dhe bllokimin e procesit të konstituimit institucional gjatë vitit 2025.

Në literaturën e shkencave politike, kultura politike kuptohet si tërësia e vlerave, normave, qëndrimeve dhe modeleve të sjelljes që strukturojnë marrëdhënien e aktorëve politikë me pushtetin dhe institucionet. Një kulturë politike konsensuale dhe bashkëpunuese është parakusht për funksionimin e demokracive parlamentare, veçanërisht në sisteme të fragmentuara dhe pluraliste. Në rastin e Kosovës, kultura politike

mbetet e brishtë dhe e karakterizuar nga elemente konfliktuale, çka ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e sistemit për të prodhuar stabilitet institucional. Në përgjithësi, niveli dhe struktura e kulturës politike të një shoqërie lidhen ngushtë me ekzistencën dhe jetëgjatësinë e shtetit dhe të institucioneve të tij. Në rastin e Kosovës, mungesa historike e shtetësisë dhe përvoja e gjatë e sundimit të jashtëm kanë prodhuar një kulturë politike fragmentare dhe shpesh kontradiktore. Shteti aktual i Kosovës karakterizohet nga bashkëjetesa e tre shtresave kryesore kulturore: idealeve të demokracisë liberale, traditës së fuqishme të organizimit fisnor dhe legacisë së sistemit socialist. Këto elemente vazhdojnë të ndikojnë mënyrën se si qytetarët e perceptojnë shtetin dhe marrëdhënien e tyre me institucionet publike. Periudha e pasluftës, e përkufizuar shpesh si fazë tranzicioni, ka ekspozuar tensionet ndërmjet këtyre shtresave, duke i bërë ato të dukshme në sjelljen politike dhe sociale.

Një nga manifestimet më të qarta të kësaj kulture politike

problematiche gjatë vitit 2025 ishte pamundësia e subjekteve politike për të ndërtuar shumicë funksionale parlamentare. Fragmentarizimi i skenës politike, mungesa e koalicioneve parazgjedhore dhe refuzimi i kompromisit pas zgjedhjeve dëshmojnë dominimin e një logjike përjashtuese, ku kundërshtari politik shihet si pengesë dhe jo si partner potencial në qeverisje. Në këtë kontekst, zgjedhjet nuk prodhuan stabilitet demokratik, por thelluan bllokadën institucionale dhe pasigurinë politike.

Një tjetër dimension i rëndësishëm i rolit të kulturës politike në krizën e vitit 2025 lidhet me instrumentalizimin e institucioneve dhe interpretimin selektiv të normave kushtetuese. Partia fituese e zgjedhjeve, madje me një fitore bindëse (48 deputet), por në ndonjë rast edhe aktorët tjerë politikë, i trajtuan institucionet jo si mekanizma të interesit publik, por si mjete për avancimin e agjendave partiake. Kjo qasje u reflektua në zvarritjen e procedurave, bllokimin e seancave konstituive dhe përdorimin e

procedurave ligjore si armë politike, por shpesh edhe duke shkelur kushtetutën me pretendime se po “mbrojnë” rregulloret dhe ligjin. Një sjellje e tillë jo vetëm që pengoi konstituimin institucional, por minoi edhe besimin e qytetarëve në rendin kushtetues dhe demokracinë përfaqësuese.

Pasojat institucionale dhe ndërkombëtare

Kriza e konstituimit institucional në vitin 2025 nuk mbeti e kufizuar vetëm brenda sferës politike të brendshme, por prodhoi pasoja të thella dhe shumëdimensionale në funksionimin e shtetit dhe në pozicionimin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. Mungesa e institucioneve legjitime dhe funksionale dobësoi ndjeshëm kapacitetin shtetëror për të ndërmarrë reforma ekonomike dhe sociale, për të garantuar qeverisje efektive dhe për të menaxhuar çështjet e sigurisë kombëtare. Paraliza institucionale ndikoi drejtpërdrejt edhe në proceset vendimmarrëse, duke krijuar një vakum politik që u reflektua në pasiguri të brendshme dhe

paqartësi strategjike. Në planin ndërkombëtar, dështimi për të konstituuar institucionet shtetërore kontribuo i në vazhdimin dhe thellimin e masave ndëshkuese të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës, të cilat u justifikuan me mungesën e stabilitetit institucional, paaftësinë për të garantuar zbatim të marrëveshjeve dhe deficitin e përgjegjësisë politike. Këto masa jo vetëm që ndikuan negativisht në procesin e integritimit evropian, por prodhuan edhe pasoja të drejtpërdrejta ekonomike dhe zhvillimore, duke kufizuar qasjen në fonde, projekte dhe mekanizma mbështetës të BE-së. Në këtë mënyrë, kriza e brendshme institucionale u shndërrua në pengesë strukturore për avancimin ndërkombëtar të Kosovës.

Një pasojë edhe më e ndjeshme ishte krisja e marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila u manifestua përmes ndërprerjes apo pezullimit të elementeve të partneritetit strategjik. Për herë të parë pas pavarësisë, Kosova u perceptua nga aleati i saj kryesor si një shtet me deficit serioz funksional dhe mungesë



POLITIKA E JASHTME GLOBALE NË NJË BOTË ME SHUMË KRIZA



Shkruan: Valon MURTEZAJ, *profesor universitar në Paris*

Viti 2026 është shumë i shkurtër për të sjellë një rend të ri botëror. Por, në kohët që po jetojmë, edhe një vit i vetëm është i mjaftueshëm për të thelluar më tej mungesën e këtij rendi. Kjo sepse sistemi ndërkombëtar po bëhet gjithnjë e më i fragmentuar, më i paqëndrueshëm dhe, rrjedhimisht, më i paparashikueshëm. Politika e jashtme bashkëkohore po tregohet se e ka të vështirë t'i zgjidhë konfliktet përfundimisht, duke bërë që ato të kthehen në procese të zgjatura, me fillim dhe fund të paqartë. Shtetet e Bashkuara mbeten aktori kryesor global, por veprojnë në një botë të mbingarkuar me

kriza. Fuqia ushtarake, pesha në sistemin ndërkombëtar dhe diplomacia po plotësojnë njëra-tjetrën, ndërsa kufijtë e ndërhyrjes tradicionale në një sistem ndërkombëtar të fragmentuar nuk janë më plotësisht të qartë. Evropa, nga ana tjetër, në një mënyrë po zgjohet nga një iluzion i gatë post-historik. Lufta në Ukrainë e ka detyruar Bashkimin Evropian të mendojë më shumë në terma sigurie dhe force. Investimet në mbrojtje, pavarësia energjetike dhe mbrojtja e infrastrukturës kritike po shndërrohen në prioritet strategjike afatgjata. Lufta e shkaktuar nga invazioni rus në Ukrainë mbetet një burim

tensioni global. Edhe nëse intensiteti i luftimeve bie apo arrihet një marrëveshje, për të cilën po punohet intensivisht, pasojat e këtij konflikti do të vazhdojnë të ndikojnë rendin ndërkombëtar. Rusia po sfidon Perëndimin. Lindja e Mesme mbetet një rajon konfliktesh jo vetëm të ngrira, por edhe të përsëritura, duke prodhuar vazhdimisht kriza që rezonojnë shumë përtej kufijve të saj dhe ndikojnë drejtpërdrejt stabilitetin global. Kina, ndërkohë, po investon në ndikim afatgjatë përmes tregtisë, teknologjisë dhe diplomacisë, duke shfaqur njëkohësisht fuqinë e saj ushtarake, por pa kërkuar përplasje të

drejtpërdrejta. Strategjia kineze, siç duket, synon zgjerimin gradual të ndikimit pa rrezikuar konflikte të hapura. Ndërkohë, pjesa tjetër e botës nuk është krejtësisht spektatore. Rajone dhe shtete të ndryshme në kontinente të ndryshme po veprojnë si aktorë aktivë dhe, në shumë raste, po shfrytëzojnë rivalitetin mes fuqive të mëdha për të rritur autonominë dhe peshën e tyre në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Këtu mund të përmendim vende si India, si dhe zhvillimet në Amerikën Latine. Siç duket, në vitin 2026, politika e jashtme globale do të formësohet nga një botë që po mëson, ose ende nuk po mëson,

të funksionojë pa një rend botëror të qartë. Në këtë kontekst, Kosova duhet të mësojë të veprojë pa tronditje të mëdha, siç ishte viti 2025. Kjo, në terma më të thjeshtë, nënkupton nevojën për institucione qeverisëse të plota dhe funksionale, si dhe angazhim të qartë në forcimin e aleancave euro-atlantike. Vetëm përmes kësaj rruge, Kosova mund të sigurojë fuqizimin e saj në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të perceptohet e të pranohet si një aktor i përgjegjshëm dhe serioz, gjë kjo e cila, për një shtet të ri si Republika e Kosovës, është më shumë se e rëndësishme. Gëzuar 2026!

vullneti politik për të respektuar standardet demokratike dhe institucionale. Kjo situatë sinjalizoi një moment kritik në raportet Kosovë-ShBA, duke dëshmuar se mbështetja ndërkombëtare nuk është e pakushtëzuar, por e ndërlidhur ngushtë me funksionimin e brendshëm demokratik dhe institucional. Për më tepër, paraliza institucionale e vitit 2025 ndikoi edhe në rreshtimet e Kosovës në politikën e jashtme, duke e dobësuar koherencën dhe qartësinë strategjike të saj. Mungesa e një qeverie funksionale dhe e një Kuvendi të konsoliduar e kufizoi aftësinë

e Kosovës për të vepruar si aktor i besueshëm ndërkombëtar, duke krijuar hapësirë për rreshtime ad-hoc, të paqëndrueshme dhe shpesh kontradiktore me interesat afatgjata shtetërore. Në këtë kontekst, Kosova u perceptua më shumë si objekt i politikës ndërkombëtare sesa si subjekt aktiv i saj. Roli i faktorëve ndërkombëtarë, megjithëse i rëndësishëm, mbeti i kufizuar përballë mungesës së vullnetit politik vendor dhe deficitit të kulturës politike konsensuale. Thirrjet e vazhdueshme për përgjegjësi, kompromis dhe respektim të rendit kushtetues nuk

prodhuan efekt të qëndrueshëm, duke dëshmuar se pa transformim të thellë të kulturës politike të brendshme, mbështetja apo presioni ndërkombëtar mbetet i pamjaftueshëm për të garantuar funksionim institucional. Kjo situatë e bëri të qartë se stabiliteti ndërkombëtar i Kosovës është i kushtëzuar drejtpërdrejt nga kapaciteti i saj për të ndërtuar institucione funksionale dhe për të kultivuar përgjegjësi politike të brendshme. Nga perspektiva analitike, viti 2025 mund të interpretohet si një pikë kthese për zhvillimin institucional të Kosovës. Ai

shton dilemë të qartë: ose vazhdimin e modeleve ekzistuese të sjelljes politike, të karakterizuara nga konfrontimi dhe mungesa e kompromisit, ose fillimin e një reflektimi të thellë mbi nevojën për transformim të kulturës politike. Vendosja e interesit shtetëror mbi kalkulimet afatshkurtra partiake, forcimi i dialogut politik dhe respektimi i rregullave demokratike përbëjnë elemente thelbësore për tejkalimin e krizave të ngjashme në të ardhmen. Në përfundim, frenimi i procesit të konstituimit të institucioneve në Kosovë gjatë vitit 2025 nuk mund të kuptohet vetëm si

rezultat i rrethanave politike momentale apo i aritmetikës parlamentare. Ai është, në thelb, pasqyrim i një kulture politike ende të pazhvilluar, ku mungojnë kompromisi, besimi institucional dhe përgjegjësia shtetërore. Sfida e vitit 2025 nuk është e papërtejkaleshme në kuptimin strukturor, por ajo bëhet e tillë nëse vazhdohet me të njëjtat modele sjelljeje politike. E ardhmja demokratike dhe institucionale e Kosovës varet nga aftësia e elitave politike për të ndërtuar një kulturë të re politike, të bazuar në bashkëpunim, respekt institucional dhe vizion afatgjatë për shtetin.



TRINGA IBRAHIMI, RRUGËTIMI DREJT YJEVE!



Behxhet SHALA - BAJGORA

Sfidimi i së padukshmes dhe të pamundurës: Ish të burgosurit politikë kanë vuajtur shumë në llogoret e ish-Jugosllavisë. Kanë vuajtur shumë edhe familjet, edhe nga varfëria si dhe nga dhuna e pushtetit. Kanë vuajtur shumë nënat tona gjithmonë me sy të përbotur nga malli për djemtë dhe vajzat që mbaheshin në burgje ku humbej rinia. Edhe gratë e atyre që ishin të martuar kishin vuajtje si dhe të fejuarat por se stoikisht prisnin kthimin e të dashurve të tyre, pa ditur nëse do të ktheheshin të gjallë. Malli i të burgosurve ishte shkollimi i fëmijëve e që përballeshin me shumë pengesa sepse ishin fëmijë “të armiqve të popullit”. Kur dolën nga burgu e sidomos pas përfundimit të luftës u krijuan rrethana dhe mundësi tjera për shkollimin e fëmijëve. Nuk kishte më pengesa të natyrës politike. Mësoheshin gjuhë të huaja,

teknologjia zhvillohej me shpejtësi të dritës duke ndihmuar në ngritjen e cilësisë, si në mësimdhënie ashtu edhe në mësimnxënie. Përkundër sakrificave të mëdha, të burgosurit politikë mbetën një komunitet i marginalizuar dhe i cenueshëm. Prandaj investonin në shkollimin e fëmijëve sepse një i shkolluar dhe i ditur vlen sa një mijë ushtarë. Kur dielli shpërndanë rreze, i dituri shpërndanë dritë. Ne të burgosurit politikë fort gëzohemi kur fëmijët e shokëve i kapin majat e shkollimit, sikur për fëmijët tanë. Edhe kur nuk i takojmë, i njohim nga shokët përmes interesimit të vazhdueshëm. Tringa Ibrahimimi është njëra prej tyre. Shpresa dhe krenaria e prindërve është krenari edhe për ne. Është vajzë e zonjës Verije Ibrahimimi dhe e Basri Ibrahimit, ish i dënuar politik nga regjimi i

Milloshëviqit që vuajti dënimin e gjatë në Burgun famëkeq të Goli Otokut dhe Llogorin e Stara Gradishkës, bashkë me Bacën Adem Demaçi abetaren dhe kuptimin e luftës për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar. Babai i Tringës, Basriu u përdoq edhe në Kosovën e lirë nga regjimi i Kurtit duke e larguar nga puna për shkaqe politike. Tringa që nga klasa e shtatë u përkushtua ndaj teknologjisë informative me pasion dhe vullnet të habitshëm për një fëmijë të kësaj moshe. Një kompjuter, vullnet dhe punë u bënë udhërrëfimi drejt majave të dijes dhe valëzimit të kësaj dije në mesin e të rinjve përmes ndërtimit dhe programimit të platformave që paraqisnin sfidë edhe për moshën shumë më të mëdha. Shkollimin e vazhdoi në gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë tashmë si profesioniste në fushën e

teknologjisë informative duke organizuar kurse dhe trajnime për vajza në mënyrë që t’i zhvillojnë shkathtësitë e tyre në këtë fushë. Në rrugën e gjatë të synimit për arritjen e majave profesionale pas një gare ndërkombëtare, në Bruksel, Tringa Ibrahimimi është shpallur si tinxherja më motivuese në Evropë duke u nderuar me çmimin prestigjioz “Aspirin Teen Award”. Rëndësia e këtij çmimi ndërkombëtar është se vlerëson të rinjtë për arritje të veçanta në fushën e edukimit, lidershit, angazhimit shoqëror dhe ndikimit pozitiv në komunitet. Për një 19-vjeçare nga një vend i vogël si Kosova përveç vlerësimit ndërkombëtar paraqet shembullin dhe udhëzuesin më të mirë për të rinjtë, jo vetëm nga Kosova se promovimi i vlerave të punës, guximi dhe përkushtimi janë qenësore drejt qëllimit të lartë shoqëror. Tringa Ibrahimimi sukseset deri

më tani ua përkushton prindërve që e mbështetën çdo përpjekje të saj, vendit të saj Kosovës ku ka filluar ëndrrën nga u shkëput, shpresoj vetëm përkohësisht, drejt Yllësisë së Madhe në fushën e teknologjisë informative duke filluar studimet në vitin 2025 në “GEORGIA INSTITUT OF TECHNOLOGY” në Shtetet e Bashkuara të Amerikës drejtimi: Inxhinier i Biomjekësisë. Urime Tringa Viti i Ri 2026 duke të dëshiruar shumë suksese në profesionin e përzgjedhur dhe misionin e shenjtë të përfaqësimit shembullor të familjes, popullit që i takon dhe vendit nga je nisur në këtë rrugëtim aspak të lehtë. U bëfsh si motra jote nga toka dhe gjaku, Mira Murati. Rreth flamurit të përbashkuar, me një dëshirë me një qëllim.....drejt suksesit që pashmangshëm do ta arrish. Qofsh e bekuar!



NGECJE TOTALE E DIALOGUT KOSOVË - SERBI GJATË VITIT 2025

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, DHJETOR / JANAR - Viti 2025 nuk solli zhvillime të rëndësishme në procesin e normalizimit në mes të Kosovës dhe Serbisë, përveç emërimit të Peter Sorensenit si përfaqësues i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi të lehtësuar po nga BE-ja. Gjatë këtij viti nuk pati asnjë takim të nivelit të lartë, kur po bëhen dy vjet që nga takimi i fundit në mes të Kurtit dhe Vuçiqit. Dialogu ka vazhduar gjatë vitit që po lëmë pas, me disa takime mes kryenegociatorit Besnik Bislimi dhe Petar Petkoviç, por asgjë konkrete në këtë proces. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë ka vendnumëruar për dy arsye: e para gjendja e jashtëzakonshme dhe protestat në Serbi kanë pamundësuar që të kemi dialog dypalësh të suksesshëm, në të njëjtën kohë mungesa e legjitimitetit të institucioneve të Kosovës ka pamundësuar që përparimi të jetë dhe të shkohet në tavolinën e bisedimeve. Edhe mungesa e aktorëve ndërkombëtarë, ShBA-së dhe Unionit Evropian, meqenëse ata kanë qenë shumë të zënë me zgjidhjen e luftës në Ukrainë. Natyrisht, edhe problemet e tjera që kanë ndodhur në Izrael dhe Gaza kanë bërë që mos të ketë vullnet politik të bashkësisë ndërkombëtare në këtë drejtim. Procesi i normalizimit mund të zgjasë shumë, ndërsa një ndërhyrje diplomatike e ShBA-së mund të ofrojë një shans për përshpejtim të dialogut. Takimi i fundit ndërmjet Besnik Bislimit dhe Petar Petkoviçit u mbajt më 11

shtator në Bruksel nën ndërmjetësimin e emisarit të BE-së, Peter Sorensen. Edhe ky takim kishte përfunduar pa ndonjë përparim. Kosova ka insistuar në zbatimin në tërësi të Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve, ndërkaq Serbia ka kërkuar që fillimisht të zbatohet pjesa që ka të bëjë me komisionet për të pagjeturit. “Ideja sot ishte të kemi fillimisht progres në themelimin e komisionit të përbashkët për personat e zhdukur me forcë dhe pastaj në pjesën tjetër të kemi një takim, ku palët - Kosova dhe Serbia - japin propozime konkrete, sipas të cilave pastaj, versioni i dhjetë i planit të sekuencimit do të mund të bëhej një plan i pranueshëm për palët”, pati deklaruar Bislimi për gazetarët në Bruksel. Por, Bislimi tha se nuk u arrit që të themelohet një komision për të pagjeturit për shkak se Serbia me gjasë “është tërhequr nga marrëveshja për termat e referencës të cilën e kemi përfunduar në fund të dhjetorit të vitit të kaluar, duke thënë se ata duan që edhe një herë të ndërhyjnë në dokument, gjë që nuk është pranuar nga Brukseli dhe as nga pala jonë”. Komisioni për të pagjeturit është pjesë e Deklaratës së përbashkët për personat e zhdukur, të cilën Kosova dhe



Serbia e kanë arritur në vitin 2023 në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Më 17 dhjetor 2024 Kosova dhe Serbia u pajtuan që ta zbatojnë këtë deklaratë. Bislimi tha se për pikën tjetër të diskutimeve, Kosova ka ofruar tri propozime, por Serbia ka kërkuar që Asociacioni të themelohet fillimisht. “Ato kishin të bëjnë me sigurimin që nenet 1 deri 4 të jenë të përfshira të marrëveshjes bazike, pasi kështu garantohet plotësimi i një neni të aneksit që thotë palët dakordohen apo përkushtohen për zbatimin e plotë të marrëveshjes bazike. Kemi kërkuar që obligimi i Serbisë për të mos e bllokuar anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare të zhvendoset nga fundi i planit në krye të planit. Kemi kërkuar që përmes gjuhës më precize të eliminohet çfarëdo mundësie për ambiguitet apo dykuptimësi. Ndërkohë që Serbia ka refuzuar të japë propozime konkrete. Por, pozicioni i Serbisë mund të përkethehet si shumë thjeshtë, së pari Asociacioni parakusht e pastaj vijat e kuqe të Serbisë,

që nënkupton se në fakt Serbia është tërhequr nga marrëveshja bazike ose refuzon të diskutojë marrëveshjen bazike”, u shpreh Bislimi. Kosova dhe Serbia arritën Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit, e njohur si Marrëveshja e Ohrit, në vitin 2023. Edhe pse marrëveshja nuk është nënshkruar, Bashkimi Evropian këmbëngul se ajo është obliguese për të dyja palët. Marrëveshja prej 11 nenesh, ndër të tjera, parasheh një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, që Serbia të mos bllokojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, dhe kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t’i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut. Raundi i ri i dialogut në nivel të kryenegociatorëve u zhvillua pasi ndërmjetësi evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Peter Sorensen, qëndroi në Kosovë dhe Serbi në muajin gusht të 2025-s. Në Kosovë ai bisedoi me udhëheqësit shtetërorë për, siç deklaroi, zbatimin e

Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve, e njohur edhe si Marrëveshja e Ohrit. Ndërkaq, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, deklaroi pas takimit me Sorensenin në Beograd, se është thelbësore që dialogu me Kosovën të “kthehet tek obligimi” për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe si dhe të mbrojtja e të drejtave të serbëve. Për themelimin e këtij asociacioni palët janë pajtuar përmes dy marrëveshjeve në kuadër të dialogut, më 2013 dhe 2015. Një draft-statut i hartuar për këtë asociacion nga BE-ja nuk është dërguar ende në Gjykatën Kushtetuese për interpretim nga Qeveria në detyrë e Kosovës. Një veprim i tillë do ta shënonte hapin e parë drejt krijimit të Asociacionit. Ndryshe, ndonëse takime të nivelit të kryenegociatorëve janë mbajtur, në Bruksel nuk është zhvilluar asnjë takim i nivelit të lartë që nga shtatori i vitit 2023. Ai takim ishte zhvilluar disa ditë para se një grup i serbëve të armatosur ta sulmonte Policinë e Kosovës në Banjskë të Zveçanit, duke vrarë një rreshter. Më 10 qershor, pas një takimi mes kryenegociatorëve, Sorenseni pati paralajmëruar se po bëheshin përgatitje për një takim të ri të nivelit të lartë, por që nuk ndodhi në këtë vit. Kosova dhe Serbia zhvillojnë dialog nën ndërmjetësimin e Brukselit që nga viti 2011. Procesi fillimisht nisi në nivel teknik dhe më pas palët u angazhuan edhe në dialog në nivelin politik. Gjatë procesit palët kanë arritur një sërë marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar.

Në vitin e dytë të liberalizimit të vizave, bien kërkesat për azil në BE

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Viti 2024 solli liberalizimin e shumëpritur të vizave për kosovarët drejt vendeve të zonës Schengen. Me numrin më të madh të turistëve, vendet e Bashkimit Evropian vërejtën edhe një numër më të madh të azilkërkuesve nga Kosova. Megjithatë, në vitin e dytë të udhëtimit pa viza drejt zonës Schengen, numri i azilkërkuesve nga Kosova ra dukshëm. Pa viza drejt 29 vendeve anëtare të zonës Schengen, kryesisht shtete anëtare të BE-së... Ky lajm kishte ardhur me paralajmërimin se liberalizimi i vizave mund ta përkeqësojë trendin e migrimit nga Kosova. Dhe, gjatë vitit të parë, më 2024, kishte ndodhur pikërisht


kjo, sipas të dhënave të Zyrës së Statistikave të BE-së, Eurostat. Trendi, megjithatë, ndryshoi në vitin e dytë të mundësisë së udhëtimit pa viza. Edhe pse janari i këtij viti shënoi numrin më të lartë të kërkesave për azil nga qytetarët e Kosovës në vendet e Bashkimit Evropian për një fillimvit, trendi ra dukshëm në muajt pasues. Në disa muaj ky numër ishte më i ulët se në vitet para liberalizimit të vizave. Në parim, liberalizimi i vizave mundëson udhëtime pa viza vetëm deri në 90 ditë - brenda gjashtë muajsh - në cilindo nga 29 shtetet anëtare të zonës Schengen. Udhëtimet pa viza duhet të shërbejnë kryesisht për vizita

turistike, çeshtje familjare ose të ngjashme, dhe assesi për punë apo përfitime të tjera. Në Kosovë kishte shqetësime se shumë të rinj mund ta shfrytëzojnë këtë mundësi për të tentuar të gjejnë punë apo për të kërkuar azil. Edhe pse në të kaluarën kishte një numër dukshëm më të madh të burrave që kërkuan azil në BE, ky dallim pothuajse u zhduk në dy vjetët e fundit. Këtë vit, përpos rënies së përgjithshme të numrit të azilkërkuesve, vërehet një rënie drastike edhe e numrit të azilkërkuesve nën 14 vjeç. Ky është një lajm i mirë për kosovarët, pasi që trendi i aplikimeve më të mëdha për azil rrezikon edhe marrëveshjen për liberalizimin e vizave.



Bashkimi Evropian ka në dorë të ashtuquajturin Mekanizëm të pezullimit të vizave. Me këtë mekanizëm, një vendi joanëtar të BE-së, si Kosova, mund t’i pezullohet përkohësisht përjashtimi nga vizat, nëse bën keqpërdorime, apo ka rritje të konsiderueshme të migrimit

të parregullt. Për më tepër, këtë muaj Këshilli i Bashkimit Evropian e përfshiu Kosovën në listën e vende të sigurta të origjinës, në përpjekje për ta përshpejtuar kthimin e migrantëve, duke e bërë më të vështirë për qytetarët nga këto vende të kërkojnë azil në BE.



NGJARJET MË TË RËNDËSISHME QË SHËNUAN VITIN 2025

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Një vit i mbushur me përmbyesje, përplasje dhe zhvillime me ndikim global pasqyrohet në bilancin për vitin 2025. Nga rikthimi i bujshëm i Donald Trumpit në Shtëpinë e Bardhë dhe ekuilibrat e brishtë në Lindjen e Mesme dhe Ukrainë, te kryengritjet sociale të brezit Z, investimet kolosale në inteligjencën artificiale dhe fenomenet ekstreme klimatike që kanë thyer rekorde, janë disa nga ngjarjet që kanë përcaktuar

vitin dhe kanë formësuar skenën ndërkombëtare, duke nxjerrë në pah një epokë pasigurie të thellë dhe transformimesh të mëdha.

Donald Trumpi rikthehet në Shtëpinë e Bardhë

Pas rikthimit në Shtëpinë e Bardhë në janar për një mandat të dytë, republikani Donald Trump ka marrë një sërë masash në kuadër të doktrinës

së tij "Amerika e para", duke përdorur gjerësisht urdhra ekzekutivë, edhe pse drejtësia ka bllokuar disa prej vendimeve të tij. Sipas kundërshtarëve të tij, duke shpërfillur të drejtat themelore dhe ndarjen e pushteteve, Trumpi ka shënjestruar rivalët politikë, ka dërguar njësi të Gardës Kombëtare në qytete të mëdha të drejtuara nga demokratët, është përpjekur të frikësonte mediet dhe ka luftuar programet e diversitetit dhe

përfshirjes. Ai ka zhvilluar gjithashtu një aktivitet të dendur diplomatik, me sukses të ndryshueshëm. Megjithatë, sondazhet tregojnë rritje të pakënaqësisë së amerikanëve për çështjet ekonomike, veçanërisht për koston e jetesës. Humbje të ndjeshme në zgjedhjet lokale e kanë vendosur partinë e tij në një pozitë të brishtë përpara zgjedhjeve të mesit të mandatit presidencial, në vjeshtën e vitit 2026.

Armëpushimi i brishtë në Gaza

Presioni amerikan ka çuar në një armëpushim në mes të Izraelit dhe Hamasit, dy vjet pas fillimit të luftës shkatërruese në Rripin e Gazës, e cila ka shpërthyer pas sulmit të paprecedentë të Hamasit më 7 tetor 2023 në territorin izraelit. Armëpushimi ka lejuar një tërheqje të pjesshme të trupave izraelite nga Gaza, shkëmbimin





e pengjeve të fundit të mbajtura gjallë në Gaza me palestinezë të burgosur në Izrael dhe rritjen e hyrjes së ndihmës humanitare, e cila megjithatë mbetet shumë më e ulët se nevojat, sipas OKB-së dhe organizatave joqeveritare. Izraeli pret kthimin e trupit të fundit të një pengu përpara nisjes së negociatave për fazën e dytë të armëpushimit, e cila, sipas planit amerikan të miratuar nga OKB-ja, duhet të çojë në çmilitarizimin e Gazës. Kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, ka deklaruar se shpreson që kjo fazë të nisë “shumë shpejt”, por dhuna vazhdon, me palët që akuzojnë njëra-tjetrën për shkelje të marrëveshjes. Tensionet rajonale vijnë me sulmet izraelite ndaj bastioneve të Hezbollahut në Liban. Irani u godit gjithashtu nga sulme izraelite dhe amerikane ndaj objekteve të tij bërthamore

gjatë një lufte 12-ditore në qershor. Në shtator, Izraeli shënjestroi drejtues të Hamasit me një sulm të paprecedentë në Katar.

Përpyjekjet e vështira për paqe në Ukrainë

Rikthimi i Donald Trump në pushtet ka shënuar përpjekjet e para serioze për t'i dhënë fund pushtimit rus të Ukrainës, që ka nisur në shkurt të vitit 2022. Deklaratat e presidentit amerikan luhatën mes lavdërimeve dhe kritikave ndaj Vladimir Putinit dhe Volodymyr Zelenskyt. Në shkurt, Trump e kishte sulmuar publikisht presidentin ukrainas në Zyrën Ovale, duke e akuzuar për mungesë mirënjohjeje ndaj ShBA-së. Bisedimet e drejtpërdrejta në mes të rusëve dhe ukrainasve në Stamboll, si dhe më pas një samit Trump-

Putin në Alaskë, nuk kanë sjell përparim konkret drejt paqes. Në tetor, Uashingtoni ka shpallur sanksione ndaj sektorit rus të naftës. Megjithatë, në fund të nëntorit janë zhvilluar negociata ndërkombëtare mbi bazën e një drafti amerikan, i konsideruar fillimisht nga Kievi dhe aleatët evropianë si tepër i favorshëm për Moskën. Pas një raundi të ri bisedimesh në dhjetor, Ukraina ka deklaruar se kishte “përparime”, ndonëse çështja e territoreve të pushtuara nga Rusia mbetet në ngërç. Në terren, ushtria ruse ka vazhduar avancimin e ngadaltë në lindje, pasi në mars kishte zmbrazur plotësisht forcat ukrainase nga rajoni kufitar rus i Kurskut. Moska ka intensifikuar sulmet ndaj infrastrukturës energjetike dhe hekurudhore të Ukrainës, ndërsa Kievi ka shënjestruar objekte naftë në Rusi.

Lufta tregtare globale

Duke argumentuar se marrëdhëniet tregtare ishin të pafavorshme për ShBA-në, Donald Trump ka shpallur valë pas vale tarifa shtesë për produktet e importuara, të ndryshme sipas vendeve ose zonave të origjinës. Ai ka vendosur gjithashtu tarifa specifike për sektorë strategjikë si çeliku, alumini dhe bakri. Teksa vendet e prekura shqyrtonin ose zbatonin masa hakmarrëse, nisën negociatat të ashpra që çuan në disa marrëveshje, përfshirë me Bashkimin Evropian dhe, në fund të tetorit, me Kinën, duke shënuar fillimin e një armëpushimi në një konflikt që tronditi ekonominë globale. Negociatat dypalëshe me Kanadanë u pezulluan pas një reklame kundër proteksionizmit që presidenti amerikan e konsideroi fyese.

I detyruar të ulë koston e jetesës për amerikanët, Trumpi ka pranuar në mes të nëntorit të anulonte tarifën doganore për disa produkte ushqimore, si kafeja dhe mishi i viçit i importuar.

Një Papë i ri: Leoni XIV

Më 8 maj, në moshën 69-vjeçare, Robert Francis Prevost është bërë Papa i parë amerikan, pas vdekjes së paraardhësit të tij Françesku, këshilltar i të cilit kishte qenë. Tym i bardhë ishte ngritur mbi Kapelën Sistine pas një konklave të shkurtër, që kishte zgjatur më pak se 24 orë. I buzëqeshur dhe diskret, i lindur në Çikago dhe i konsideruar kardinal i moderuar, Prevost ka marrë emrin Leoni XIV. Ish-misionar për gati 20 vjet në Peru, shtetësinë e të cilit e ka marrë, ai vijon linjën e





paraardhësit të tij me theks te mbështetja për të varfrit, emigrantët dhe mbrojtjen e mjedisit. Njëkohësisht, ai u dha garanci edhe qarqeve konservatore, duke lejuar rikthimin e meshës tradicionale në Vatikan pas tre vitesh kufizimesh, ndërsa përjashtoi në afat të shkurtër shugurimin e grave dhe njohjen e martesave mes personave të të njëjtit seks.

Kryengritjet e brezit Z

Në Azi, Afrikë dhe Amerikën Latine, të rinjtë e brezit Z (nën 30 vjeç) kanë shtuar protestat për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe kundër kufizimeve në rrjetet sociale apo korrupsionit të elitave. Ata protestuan në Peru kundër pasigurisë në rritje dhe klasës politike, si dhe në Marok, ku autoritetet nisën reforma sociale, por edhe ndjekje penale

ndaj mbi 2 000 personave. Në vende të tjera, protestat e shtypura me dhunë janë shndërruar në sfida të hapura ndaj pushtetit: pas trazirave në Nepal, kryeministri maoist, K. P. Sharma Oli është detyruar të japë dorëheqjen. Në Madagaskar, protestat kanë çuar në rrëzimin e presidentit Andry Rajoelina nga ushtria. Në Tanzani, të rinjtë kanë marrë pjesë masivisht në protesta paszgjedhore që janë shtypur me gjak. Flamuri pirat i mangas “One Piece” është shndërruar në simbol global të luftës kundër shtypjes.

BE-ja mes sigurisë, ekonomisë dhe sfidave gjeopolitike

Viti 2025 është shënuar si një periudhë konsolidimi dhe orientimi strategjik për Bashkimin Evropian (BE), në një

kontekst të dominuar nga pasiguria gjeopolitike, presionet ekonomike dhe nevoja për forcimin e rolit ndërkombëtar të unionit. Një nga zhvillimet kryesore ishte thellimi i angazhimit të BE-së në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, veçanërisht përmes mbështetjes së vazhdueshme për Ukrainën dhe rritjes së investimeve në industrinë evropiane të mbrojtjes. Institucionet evropiane kanë theksuar nevojën për autonomi strategjike dhe bashkëpunim më të ngushtë mes shteteve anëtare përballë kërcënimeve të jashtme. Në planin energjetik, viti 2025 ka shënuar hapa të rëndësishëm drejt reduktimit të varësisë nga gazi rus, duke përshpejtuar tranzicionin drejt burimeve alternative dhe politikave për siguri afatgjatë të furnizimit. Kjo qasje është shoqëruar me zgjatjen e sanksioneve ndaj

Rusisë dhe mbajtjen e një linje të ashpër politike lidhur me luftën në Ukrainë. Nga ana ekonomike, BE-ja është përpjekur të ruajë stabilitetin në një klimë rritjeje të moderuar. Buxheti i vitit 2025 dhe politikat e BE-së janë orientuar drejt forcimit të konkurrenshmërisë, inovacionit dhe mbështetjes për arsimin, kërkimin shkencor dhe tranzicionin digjital. Programet si Erasmus+ dhe Horizon Europe kanë mbetur shtylla të rëndësishme të investimit afatgjatë. Në plan diplomatik, BE-ja ka intensifikuar marrëdhëniet me partnerë jashtë bllokut, përfshirë vendet e Azisë Qendrore dhe shtetet pjesëmarrëse në Komunitetin Politik Evropian, duke synuar zgjerimin e ndikimit politik dhe ekonomik të unionit përtej kufijve të tij tradicionalë. Ndërkohë, çështjet mjedisore dhe menaxhimi i emergjencave mbetën në fokus, sidomos për

shkak të zjarreve dhe fatkeqësive natyrore që kërkuan koordinim të shtuar mes vendeve anëtare për mbrojtjen civile. Në tërësi, 2025-a është karakterizuar si një vit tranzicioni për Bashkimin Evropian, ku përpjekjet për stabilitet të brendshëm u ndërthurën me ambicien për të vepruar si një aktor më i bashkuar dhe më i fortë në skenën ndërkombëtare.

Diplomacia dhe samitet globale nën tendenca të sigurisë së rritur

Viti 2025 është karakterizuar nga një diplomaci ndërkombëtare e zhvilluar nën hijen e pasigurive globale dhe tensioneve gjeopolitike. Samitet më të rëndësishme botërore, përfshirë ato të NATO-s, G20-s dhe forume të tjera shumëpalëshe, janë dominuar





nga çështjet e sigurisë, mbrojtjes dhe stabilitetit ndërkombëtar, duke reflektuar një rend global gjithnjë e më të fragmentuar. Luftërat e vazhdueshme, rivalitetet mes fuqive të mëdha dhe kërcënimet hibride, nga sulmet kibernetike te dezinformimi, kanë shtyrë diplomacinë ndërkombëtare drejt një qasjeje më të kujdesshme dhe më të militarizuar. Vendet perëndimore kanë theksuar nevojën për rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes dhe forcimin e aleancave, ndërsa shtetet në zhvillim kanë kërkuar më shumë mbështetje ekonomike dhe siguri ushqimore. Samitet globale janë shndërruar gjithnjë e më shumë në platforma për menaxhimin e krizave, ku dialogu politik ndërthurej me interesat strategjike. Në këtë kuadër, siguria energjetike, stabiliteti rajonal dhe mbrojtja e infrastrukturave kritike janë renditur ndër prioritetet kryesore të agjendave diplomatike. Ndërkohë, përpjekjet për bashkëpunim shumëpalësh kanë vazhduar të përballen me sfida, pasi dallimet mes blloqeve politike dhe ekonomike u

thelluan. Megjithatë, samitet e vitit 2025 kanë dëshmuar se diplomacia mbetet një mjet kyç për parandalimin e përshkallëzimit të konflikteve dhe për ruajtjen e një ekuilibri të brishtë global në një periudhë të pasigurt ndërkombëtare.

Investimet kolosale në inteligjencën artificiale

Gjigantët e teknologjisë dhe startup-et e specializuara kanë shpenzuar shuma gjithnjë e më marramendëse për zhvillimin e inteligjencës artificiale (AI). Sipas Gartner, shpenzimet globale për IA në vitin 2025 kanë arritur rreth 1.5 trilion dollarë, ndërsa vitin e ardhshëm pritet ta kalojnë 2 trilionëshin. Vlerësimet astronomike në bursë, me Nvidia që në një moment ka kaluar 5 trilionë dollarë kapitalizim, kanë ngritur frikën e një fluske spekulative. Shqetësimet janë shtuar nga raste dezinformimi, akuza për shkelje të të drejtave të autorit dhe shkurtime masive vendesh pune, veçanërisht në “Amazon”. Në Kaliforni, prindërit e një adoleshenti që ka kryer vetëvrasje kanë akuzuar

ChatGPT se e kishte inkurajuar atë, çka ka çuar në forcimin e kontroleve prindërore dhe miratimin e një ligji për rregullimin e chatbot-ëve.

Grabitja spektakolare në Luvër

Më 19 tetor, hajdutë të veshur si punëtorë hynë në mes të ditës në Muzeun e Luvrit duke përdorur një ashensor për zhvendosje dhe duke thyer një xham. Ata kanë grabitur bizhuteri të kurorës me vlerë rreth 88 milionë euro brenda vetëm tetë minutash. Gjatë arratisjes me skuter ka rënë kurora e perandoreshës Eugjeni, e cila është gjetur e dëmtuar. Ngjarja ka tronditur botën dhe ka nxjerr në pah mangësi serioze në sigurinë e muzeut më të famshëm në planet. Katër persona janë akuzuar, por plaçka ende nuk është gjetur.

Goditja amerikane në Karaibe dhe Paqësor

Që nga gushti, Uashingtoni ka vendosur një forcë të madhe ushtarake pranë Venezuelës, zyrtarisht për të luftuar trafikun

e drogës drejt ShBA-së. Sulme të shumta në Karaibe dhe Paqësor ndaj anijeve të dyshuara për trafik droge kanë shkaktuar rreth 100 viktima, duke ngritur pikëpyetje mbi ligshmërinë e operacioneve. Karakasi i sheh këto veprime si pretekst për rrëzimin e presidentit Nicolas Maduro dhe grabitjen e rezervave të naftës. ShBA-ja ka shpallur “bllokadë të plotë” ndaj cisternave të sanksionuara dhe ofroi shpërblim 50 milionë dollarë për arrestimin e Madurës.

Rekordet e fenomeneve ekstreme klimatike

Përmbytje vdekjeprurëse, stuhi të fuqishme. Fenomenet ekstreme u shtuan në frekuencë dhe intensitet për shkak të ndryshimeve klimatike, sipas shkencëtarëve. Cikloni Melissa shkatërroi rajone të tëra të Xhamajkës dhe përmbysi Haitin e Kubën. Filipinet u goditën nga disa tajfune radhazi, ndërsa Vietnam, Sri Lanka dhe Indonezia pësuan dëme të rënda dhe humbje jetësh. Në Evropë, zjarret pyjore arritën

nivele rekord gjatë verës. Në ShBA, zjarre të shkaktuara nga rrufetë çuan në mbylljen e pjesës veriore të Kanionit të Madh në Arizona për pjesën e mbetur të sezonit turistik.

Tajlanda dhe Kamboxhia nënshkruajnë armëpushim për t'i ndalur përleshjet kufitare

Tajlanda dhe Kamboxhia kanë arritur një marrëveshje të re për armëpushim, duke i dhënë fund përleshjeve të ashpra përgjatë kufirit të përbashkët në jug-lindje të Azisë. Dokumenti është nënshkruar më 27 dhjetor nga ministrat e mbrojtjes së të dy vendeve gjatë një takimi në një pikë kufitare në provincën Chanthaburi të Tajlandës dhe ka hyrë në fuqi menjëherë. Përleshjet e fundit filluan disa javë më parë si pasojë e mosmarrëveshjeve të vjetra territoriale, duke shkaktuar dhjetëra të vdekur dhe më shumë se gjysmë milioni njerëz të zhvendosur nga zonat kufitare.





GEORGE ORWELL

BANESAT E PËRBASHKËTA TË STREHIMIT

Banesat e përbashkëta të strehimit, nga të cilat ka disa qindra në Londër, janë strehimore nate të autorizuar posaçërisht nga LSKP.¹ Ato janë për njerëzit që nuk mund të përballojnë strehim të rregullt. Në fakt, janë hotele jashtëzakonisht të lira. Është e vështirë të vlerësohet popullsia e shtëpive të strehimit, e cila ndryshon vazhdimisht, por ajo shkon gjithmonë në dhjetëra mijëra, dhe në muajt e dimrit ndoshta i afrohet shifrës pesëdhjetë mijë. Duke pasur parasysh që strehojnë kaq shumë njerëz dhe se shumica e tyre janë në një gjendje jashtëzakonisht të keqe, shtëpitë e përbashkëta të strehimit nuk marrin vëmendjen që meritojnë.

Për ta gjykuar vlerën e legjislacionit për këtë temë, duhet kuptuar se si është jeta në një banesë të përbashkët. Banesa mesatare e banimit (dikur quhej "fjetore"), përbëhet nga disa konvikte dhe një kuzhinë, gjithmonë e nëndheshme, e cila shërben edhe si dhomë ndenjeje. Kushtet në këto vende, veçanërisht në lagjet jugore si *Southwark* ose *Bermondsey*, janë të neveritshme.

Konviktet janë strofuj të qelbur, të mbushur me çdo gjë dhe me deri në njëqind burra, me krevate shumë më të ulëta se ato

në një burg të zakonshëm në Londër. Normalisht, këta shtretër nuk janë shumë të gjatë dhe të gjerë, kanë dyshekë të fortë dhe jastëkë cilindrikë si bllok druri; ndonjëherë, në banesat më të lira, nuk ka fare jastëk. Mbulesat e krevatit përbëhen nga dy çarçafë ngjyrë purpur, që duhet të ndërrohen një herë në javë por, në fakt, në shumë raste, s'ndërrohen as një herë në muaj, dhe një kuvertë pambuku; në dimër mund të ketë batanije, por asnjëherë nuk janë të mjaftueshme.

Shtretërit janë me parazitë, dhe kuzhinat plot me buburreca ose brumbuj të zinj. Nuk ka banja, natyrisht, dhe nuk ka hapësirë ku të kesh privatësi. Këto janë kushtet normale dhe të pranuar në të gjitha banesat e përbashkëta. Tarifat e paguara për këtë lloj strehimi ndryshojnë nga koha e qëndrimit e llogaritur me ditë dhe net. Duhet shtuar se, sado e ulët të duken tarifat, këto banesa sjellin afërsisht 40 paund fitim neto në javë për pronarin e saj.

Përveç banesave të pista të strehimit, janë edhe disa si *Banesat Rowton* dhe *Bujtinat e Ushtrisë*, që janë të pastra dhe rregullta. Për fat të keq, të gjitha këto vende i krijojnë këto përparësi me anë të një disipline kaq të reptë dhe të lodhshme sa

të qëndrosh te to të duket sikur je në burg. Në Londër (çuditërisht është më mirë në disa qytete të tjera) këto banesa janë vende ku ke liri, por jo një shtrat të mirë. Gjëja më e çuditshme e në lidhje me mjerimin dhe parehatinë e banesave të përbashkëta të strehimit është se ato janë në vende që i nënshtrohen inspektimit të vazhdueshëm nga organet përgjegjëse.

Kur dikush sheh për herë të parë shpellën e errët, të prapambetur të një kuzhine në këto banesa, ajo duket sikur i përket fillimit të shekullit të nëntëmbëdhjetë që në njëfarë mënyre nuk u ka rënë në sy reformatoreve; është befasuese të zbulosh se ato sundohen nga një sërë rregullash (qëllimisht) jashtëzakonisht tiranike. Sipas rregullores së Aktit të Strehimit, praktikisht çdo gjë është kundër ligjit në një banesë të përbashkët strehimi. Bixhozi, dehja, apo edhe futja e pijeve, sharjet, pësh-tymja në dysheme, mbajtja e kafshëve të zbutura, grindjet - me pak fjalë, e gjithë jeta shoqërore e këtyre vendeve është e ndaluar. Natyrisht, ligji rëndom shkelet, por disa nga rregullat janë të zbatueshme dhe ato ilustrjnë padobishmërinë e tmerrshme të këtij lloj legjislacioni.

Për të marrë një shembull: disa

kohë më parë organi mbikëqyrës u shqetësua për afërsinë e shtretërve dhe vendosi që duhet të jenë të paktën një metër larg njëri-tjetrit. Ky është lloji i ligjit që është i zbatueshëm dhe shtretërit janë zhvendosur siç duhet. Tani, për një banor në një konvikt tashmë të mbipopulluar s'ka rëndësi sa larg njëri-tjetrit janë shtretërit; kjo ka rëndësi për pronarin, të ardhurat e të cilit varen nga hapësira e dyshemesë. Rezultati i vetëm real i këtij ligji, pra, ishte një rritje e përgjithshme e çmimit të shtretërve. Vini re se megjithëse hapësira midis shtretërve është e rregulluar me ligj, asgjë nuk ka të bëjë me vetë shtretërit - asgjë, për shembull, me gjendjen e tyre. Kujdestarët e shtëpisë mund të të bëjnë të paguash për një shtrat më pak të mirë se një grumbull kashte dhe s'ka ligj që i ndalon.

Një shembull tjetër i rregulloreve të strehimit. Nga gati të gjitha banesat e strehimit, gratë janë repretësisht të përjashtuara; ka disa banesa posaçërisht për gratë, një numër shumë i vogël për të ndikuar në gjendjen e përgjithshme - të cilën si burrat edhe gratë e pranojnë. Si pasojë e kësaj çdo burrë i pastrehë që jeton rregullisht në një banesë

strehimi është krejtësisht i shpëputur nga shoqëria femërore - në të vërtetë, ka raste kur burri dhe gruaja ndahen për shkak të pamundësisë për të gjetur strehim në të njëjtën banesë. Sidoqoftë, disa nga banesat më të lira zakonisht bastisen nga çiftet e rugëve të cilët pushtojnë kuzhinën të paftuar dhe mbajnë shërbesa të gjata fetare. Banorët nuk i pëlqejnë këto festa dobësuese, por s'kanë fuqi t'i nxjerrin jashtë. A mund të imagjinohet që gjëra të tilla të tolerohen në një hotel? E, megjithatë, një banesë të përbashkët strehimi është thjesht një hotel ku paguhet më pak. Kjo lloj tiranie e vogël, në fakt, mund të mbrohet vetëm me teorinë se një njeri shumë i varfër për të jetuar në një banesë të përbashkët, humb disa nga të drejtat e tij si qytetar.

S'mund të mos kesh ndjesinë se kjo teori qëndron pas këtyre rregullave. Të gjitha janë në natyrën e legjislacionit ndërhyrës - pra ndërhyjnë, por jo për të mirën e banorëve. Theksi i tyre është te higjiena dhe morali, dhe çështja e rehatisë i lihet pronarit të banesës, i cili, natyrisht, ose e shmang ose e zgjidh në frymën e bamirësisë së organizuar. Vlen të theksohen



Lulëzim ETEMAJ

“ë”, romani që ngre një lapidar letrar

Romani “ë” i Jehona Kicajt është një rrëfim i fuqishëm i një vajze të re shqiptare, familja e së cilës është detyruar të largohet nga Kosova dhe të vendoset në Gjermani para shpërthimit të luftës. Rrëfimi fillon në një mënyrë fare të zakonshme, me një vizitë tek dentisti, ku protagonistja diagnostikohet me Bruxismus, që karakterizohet nga ngërçi dhe tensioni i nofullave që e shoqërojnë vazhdimisht. Ky detaj duket të jetë i vogël, por në fakt ai i shërben autores si metaforë krejt e veçantë dhe origjinale për të ndërtuar tërë rrëfimin. Kërkimi i përgjigjes për stresin, tensionin dhe dhimbjen fizike ndërthuret me kërkimin e përgjigjeve për traumën, identitetin kulturor e etnik si dhe kujtesën.

I shkruar në vetën e parë, libri trajton jetën në mërgim, përballjen me paragjykimet e shumta në një hapësirë dhe botë të huaj, të cilat e shoqërojnë procesin e integritetit, si dhe përjetimet e protagonistes gjatë vizitave në Kosovë para dhe pas luftës. Titulli “ë”, një shkronjë karakteristike kjo e shqipes, shndërrohet në simbol të gjuhës, të përkatësisë dhe të

zërit të ndruajtur apo dhe të ndrydhur, që rrezikojnë të humben, prandaj protagonistja lufton për t’i mbrojtur e ruajtur ato përmes kujtesës dhe rrëfimit. Në këtë mënyrë, dhimbja e trupit (ngërçi i nofullave) dhe dhimbja e kujtesës ndërthuren në mënyrë poetike dhe të ndjeshme. Një nga shtyllat më të rëndësishme të romanit është mënyra se si lufta e Kosovës rikthehet, jo si kujtim i drejtpërdrejtë i përjetimit të tregimtares, por si një traumë e trashëguar familjare dhe e përgjithshme. Jashtëzakonisht i fuqishëm, njëkohësisht dhe përplotësues i mozaikut të pasur artistik të romanit, është rrëfimi i forenzistës që ka marrë pjesë në identifikimin e viktimave shqiptare të krimeve gjenocidare serbe. Duke qenë pjesëmarrëse në identifikimin e viktimave edhe në Ruandë, ajo vëren se, për dallim prej andej, autorët e krimeve në Kosovë e dinin se eshtrat mund të flasin. Prandaj u përpoqën t’i zhduknin me çdo kusht.

Sa shumë art, të mbështjellë me dhimbje, ka në skenën kur ajo kujton intervistën me një gazetare shqiptare që, para kamerës, mbante një bluzë të



kuqe fëmije dhe rrëfente për një djalë të zhdukur në luftë, trupin e të cilit e gjetën vite më vonë në një varr masiv në Serbi. Nën logon e Nike-s, bluza mbante mbishkrimin tronditës: **Run for your life.**

Përmes këtij rrëfimi, romani ngrihet në nivelin e një lapidari letrar për shqiptarët që u helmuan, u përzunë nga Serbia prej vendeve të punës, që u zhdukën, mes të cilëve edhe gjyshja i autores, u dhunuan, u vranë e u masakruan nga forcat serbe. Ai bëhet një lapidar lëvizës që përfaqëson zërin e këtyre viktimave, të cilat ende


kërkojnë drejtësi, kërkojnë të mos harrohen dhe kërkojnë njëkohësisht dhe pandërprerë një gjykim të qartë të gjenocidit serb të kryer nga Serbia ndaj shqiptarëve gjatë luftës në Kosovë. Ky dimension i jep romanit një peshë të fuqishme etike përtej vlerave të tij artistike.

Pikërisht për këtë arsye, “ë” është një libër i rëndësishëm për t’u lexuar, si nga shqiptarët, ashtu edhe nga të huajt. Për shqiptarët, ai ofron një pasqyrë intime të traumave individuale dhe kolektive të luftës dhe të përpjekjes për të ruajtur identitetin dhe rindërtuar vendin e tyre, Kosovën, pas çlirimit. Për të huajt, ai është një dritare e qartë dhe artistikisht e rafinuar drejt një realiteti të panjohur ose shpesh të keqkuptuar apo të anashkaluar në diskursin ndërkombëtar, qoftë ai medial, politik, diplomatik apo dhe kulturor. Romani arrin të pasqyroj përvojat e dhimbshme të një populli përmes një gjuhe universale emocionale, të kuptueshme për këdo.

Një vizitë e papritur e protagonistes në Kosovë, aq e papritur sa as Shpresa nuk e di, fillon me një çast të heshtur,

ndërsa e vështron atë nga dritarja e kafenesë, që drejtohet nga një çift bashkëshortor amerikan, ku ajo punon dhe vërehet se në ndërkohë përgatit kafetë pas banakut dhe bën shaka me kolegët. Pastaj, përgjatë autostradës, shfaqet një poster gjigant në një kodër, poshtë të cilit shkruan: **Liria ka emër: UÇK.** Prishtina, e çuditshme në zbrazëtinë e saj, e shpie drejt skulpturës **Newborn**, ndërsa flamuri i Kosovës dhe i BE-së tundën së bashku në erë para ndërtesës qeveritare. Një mbyllje e lehtë, plot art dhe tinguj të brendshëm, që autorja i dhuron romanit.

Përkthimi dhe botimi i tij në shqip është shumë i rëndësishëm. Ai jo vetëm që sjell te lexuesit shqiptarë një vepër që flet për të kaluarën e tyre jo të largët, por gjithashtu e vendos romanin në qarkullim kulturor në mënyrën siç e meriton. Përmes shqipes, libri lidhet më fort me rrënjët e tij tematike: gjuha, identiteti, mërgimi, mungesa, lufta, vuajtja, sakrifica dhe kujtesa. Botimi në shqip shërben, po ashtu, si një akt i rëndësishëm rikthimi-një kthim simbolik i zërit në vendin nga ku ai u detyrua të ikte.



DAVID LODGE

MOTI

Mbrëmja e kësaj dite, në Hartfield, ishte shumë e gjatë dhe melankolike. Moti shtoi çfarë mendi nga ngrysjat. Filloi një shi i ftohtë e i stuhishëm dhe asgjë s'ngjante me korrikun përveç pemëve dhe shkurreve që po i përllante era dhe gjatësisë së ditëve që pamjet mizore i bënin më të dukshme.

JANE AUSTEN, *Emma* (1816)

Londër. Semestri vjeshtor mbaroi dhe Lordi Kancelar rrinte ulur në Sallën e Lincoln Innit. Mot i paqëndrueshëm nëntori. Ka aq shumë baltë në rrugë, sikur ujërat sapo janë tërhequr nga faqja e dheut dhe nuk do të ishte e jashtëzakonshme nëse takojmë një Megalosaurus, dyzet këmbë të gjatë, që ecën si hardhucë elefantike në Kodrën e Holbornit. Tymi që del nga kapakët e oxhakut krijon një shi të zi të imtë me fjolla bloze aq të mëdha sa një fjollë bore e rritur - dikush mund të imagjinojë se mbante zi për vdekjen e diellit. Qentë nuk dallohen nga lluca. Kuajt, pak më mirë; spërkatën deri te maskat e syve. Këmbësorët përplasnin çadrat e njëri-tjetrit në ndotjen e përgjithshme të disponimit të keq dhe humbin pikëmbështetjen në cepat e rrugëve, ku dhjetëra mijëra këmbësorë të tjerë kanë rëshqitur dhe shkarë që nga

agimi (nëse ka gdhirë ndonjëherë), shtojnë depozita të reja koreje mbi koren e baltës, qepen ngulshëm atyre skajeve në trotuar dhe grumbullohen në interes të përbërë.

CHARLES DICKENS, *Shtëpia e zymtë* (1853)

PËRVEÇ STUHIVE të çuditshme në det, motit iu kushtua pak vëmendje në prozë deri në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë. Ndërsa në shekullin nëntëmbëdhjetë, romancierët thuan se shkruajnë gjithmonë për të. Kjo pjesërisht si pasojë e rritjes së vlerësimit të Natyrës të sjellë nga poezia dhe piktura romantike, e pjesërisht për shkak të rritjes së interesit letrar për individualen, shprehet për gjendjen e ndjenjave që ndikojnë dhe ndikohen nga perceptimet tona të botës së jashtme. Siç e vuri Coleridge në odën e tij mbi "Dëshpërimin":

Oj Zonjë! Ne marrim vetëm atë që japim Dhe vetëm në jetën tonë Natyra jeton.

Të gjithë e dimë se moti ndikon në disponimin tonë. Romancieri është në pozitë të volitshme të shpikë çfarëdolloj moti që i duhet për gjendjen shpirtërore që ai ose ajo dëshiron ta evokojë.

Prandaj, moti shpesh është

shkas i efektit që John Ruskin e quajti mashtrim patetik, projektim i emocioneve njerëzore mbi fenomenet në botën natyrore. "Të gjitha ndjenjat e dhunshme... përshtypjet tona për gjërat e jashtme prodhojnë falsitet, që në përgjithësi do t'i karakterizojnë si mashtrim patetik", shkroi ai. Siç nënkupton edhe emërtimi, Ruskin mendoi se kjo ishte diçka e keqe, simptomë e dekadencës së artit dhe letërsisë moderne (në krahasim me klasiken) dhe vërtet shpesh është arsye e të shkruarit të fryrë, vetëkënaqës. Por, nëse përdoret me inteligjencë dhe maturi, është mjet retorik i përshtatshëm për efekte prekëse dhe të fuqishme, pa të cilat fikcioni do të qe shumë më i varfër.

Jane Austen mbante dyshim Augustinian¹ lidhur me imagjinatën romantike dhe e satirizoi në karakterizimin e Mariannesë te *Ndjenjë dhe ndjeshmëri*. "Jo të gjithë si ti pasionohen në gjethet e fushkura", vëren ftohtë motra e saj Elinor pas rapsodisë së vjeshtës së Mariannesë, "Sa më ka ënda, ndërsa ec, t'i shoh kur më bien rrebesh nga fryma. Çfarë ndiejnë, stina, ajri të frymëzuara bashkërisht!" Moti në romanet e Jane Austen është

zakonisht diçka që ka ndikim të rëndësishëm praktik në jetën shoqërore të personazheve të saj e nuk është tregues metaforik i jetës së tyre të brendshme. Bora në kapitujt 15 dhe 16 të *Emës* është shembull tipik në këtë kuptim. Herën e parë përmendet në mes të darkës të zotit Weston para Krishtlindjeve, ku zoti John Knightley, i cili, në radhë të parë, s'kishte dashur të vinte, hyn në dhomë dhe njofton me *Schadenfreude*² të fshehur se "po binte shumë borë me një erë të fortë përmybtëse", duke shkaktuar terror në zemrën e babait hipokondriak të Emës, zotit Woodhouse. Pason një diskutim ku të gjithë kanë diçka për të thënë, më shumë diskutim vetëzbulues sesa për çështjen në fjalë, derisa z. George Knightley kthehet nga ekzaminimi i motit dhe jep një përshkrim më të arsyeshëm dhe ngushëllues. Ai dhe Ema vijnë në përfundim se meqë zoti Woodhouse, sido që të bëhej, do të shqetësohej gjithë mbrëmjen, vendosin t'i thërrasin karrocat. Z. Elton përfiton nga ky largim i papritur për t'u futur i pashoqëruar në karrocën e Emës ku edhe i shpall dashuri. Kjo po që ishte edhe e papritur edhe thellësisht e turpshme për Emën,

pasi ajo mendon se ai i vardisej ndihmës së saj, Harrietës. Për fat të mirë, moti i ditëve të ardhshme është alibi e mirëseardhur për shmangien e takimit me të dyja palët:

Moti qe më se i favorshëm për të... Toka ishte mbuluar me borë dhe atmosfera ishte në atë gjendje të luhatshme mes ngricës dhe shkrirjes, që nga të gjitha, është më e pafavorshme për lëvizje. Me mëngjeset që fillonin me shi ose borë dhe mbrëmjet e ngrira, ajo për ditë të tëra mbeti e burgosura më e nderuar.

Moti përshkruhet sepse është i rëndësishëm për storjen, por përshkrimi është mjaft i drejtpërdrejtë.

Megjithatë, me raste, edhe Jane Austen e përdor me maturi mashtrimin patetik. Kur lumturia e Emës është në rënie e sipër, kur ajo zbulon të vërtetën, me të gjitha implikimet e turpshme të sjelljes lidhur me Jane Fairfaxin, kur vonë e kupton se e dashuron zotin Knightley, por ka arsye të besojë se ai do të martohet me Harrietën, në ditën më të keqe të jetës së saj, "moti shtoi çfarë mendi nga ngrysjat". Ruskin do të thoshte se moti është i paaftë për qëllime të tilla. Por, stuhia e verës është analogji e saktë për ndjenjat e heroinës lidhur me të ardhmen, sepse pozita e saj e caktuar dhe e



HANNAH EWENS

BURRAT NUK PO ZHDUKEN NGA LETËRSIA, E VËRTETA ËSHTË MË E NDËRLIKUAR

Marrë nga *The Independent*


Tobi Coventry është i padukshëm, por ai është këtu. Një romancier debutues që shkruan për seksualitetin, dëshirën dhe, pa dashje, për maskulinitetin: lloji i burrit për të cilin prej pesë vjetësh na është thënë se nuk ekziston më. Ose të paktën nuk mund të fitojë Çmimin “Booker” pa shkaktuar një dridhje të habitshme kulturore. Ditët i kalon duke lexuar, për të jetuar - duke gjurmuar libra para se të dalin në pah, duke gërmuar në titujt e vjetër për të gjetur histori që mund të përshtaten për ekranizim. Kështu që, kur ky kërkues librash i kthyer në autor lexoi qëndrimin e

[ditores] *The Guardian* për Çmimin “Booker” - letërsia “e mbyllur për burrat”, librat për meshkuj të rinj “vështirë për t’u gjetur,” fitorja [Çmimi “Booker” më 2025] e David Szalayit që solli “maskulinitetin sërish në qendër të letërsisë artistike” - ai thjesht e pyeti veten: çfarë? “Disa prej librave më të mirë të rinj vijnë prej burrave e disa prej grave, dhe nuk më ka ndodhur ndonjëherë të mendoj: ‘O, Zot, mezi pres një libër që vjen nga një burrë,’” thotë Coventry nga zyra e tij në shtëpi, në Raj. Prapa tij, raftet janë të mbushura me libra nga autorë të të gjitha gjinive. Pastaj ai fillon të rendisë

këta burra që supozohet se nuk ekzistojnë: Ben Myersi i frytshëm me përmbledhjen e tij të tregimeve, *Male Tears* [Lotët e burrave]; Douglas Stuart; Michael McGee; Paul Mendez; Tony Tulathimutte; Djamel White. Ai vëren se edhe gratë shkruajnë për djem të rinj dhe për maskulinitetin - dhe unë do të shtoja shkrimtarët si Sally Rooney dhe Ottessa Moshfegh, të cilat *The Guardian* i ka përmendur - edhe pse pretendon se një lloj i tillë shkrimi mungon, duke ia atribuuar këtë mungesë dominimit të supozuar të “interioritetit femëror.” Romani debutues i

Coventryt, *He’s the Devil* [Ai është djalli], një komedi e errët me ndikime nga Stephen Kingu, Moshfeghu dhe Eliza Clarku, pritet të dalë vitin e ardhshëm. Protagonisti i tij është një burrë i vetmuar rreth të njëzetave të vona, që joshet nga prania e frikshme e një cimeri të ri. Coventry flet lirshëm për letërsinë e zhanrit, se si ajo fut brenda saj analiza të maskulinitetit përmes stereotipave dhe gjurmëve [tropes and shadows], dhe se si çdo “krizë” e supozuar në letërsinë mashkullore injoron burrat që po lulëzojnë - madje ndonjëherë dominojnë - në këto hapësira të zhanrit. Librat

po ndryshojnë, thotë ai, madje edhe ata letrarë. “Çështja këtu ka të bëjë pjesërisht me të folurit për një lloj specifik libri që mund të fitojë çmime të caktuara. Dhe, unë mendoj se kjo është disi e rrezikshme, sepse pastaj njerëzit kërkojnë një krahasim të drejtpërdrejtë,” thotë ai për këtë burrë arketip që mungon. Shkrimtarja Eliza Clark është dakord. “Në thelb, të gjithë romancierët tanë të rinj meshkuj, më të kthjellët dhe më të suksesshëm - dhe ka një ndarje të fortë midis tyre dhe ‘gardës së vjetër’ të romancierëve meshkuj - janë ose të komunitetit LGBTQ+ →



AGIM VINCA

PORTRETI LETRAR I SKËNDER DRINIT

Rrënjët e familjes dhe heshtja e shkrimtarit

Skënder (Riza) Drini (Voskopojë, 09.08.1935 - Shkodër, 16.12.2014), siç tregon edhe mbiemri i tij, ishte me origjinë nga Struga. Voskopoja është rastësisht vendlindja e tij, sepse babai i tij, Riza Drini, kishte shërbyer aty në kohën kur lindi i biri (1935), mirëpo rrënjët e tij në të vërtetë ishin nga Struga. Aty, në qytezën buzë Drinit të Zi, kishte lindur dhe ishte rritur babai i Skënderit, Rizai dhe kishte jetuar e kishte vdekur (i vrarë nga komiteti bullgarë) gjyshi i tij, Dehari, Dehar Drini (Struga). Nëna e Skënderit ishte nga Dibra e Madhe, nga një familje e njohur dibrane. Rizai dhe Naxhija, si quhej bashkëshortja e tij, lindën tre fëmijë, që të tre djem: Skënderin, Gencin dhe Bardhylin. Dy të parët, Skënderi dhe Genci, erdhën në jetë në Voskopojë, në kohën kur babai i tyre ishte kryetar komune, në vitet 1932-1938, kurse i treti, Bardhyli, në Shkodër, ku kaloi me shërbim më vonë Rizai dhe ku familja Drini u vendos përgjithmonë.

Emrin e babait të Skënderit, Riza Drini, e kam dëgjuar që në fëmijëri (përmendej si patriot dhe nacionalist shqiptar), por Skënderi s'para fliste për të atin, e as për familjarët e tjerë. Madje

edhe kur unë e hapja këtë temë, ai i shmangej. Persekutimi i babait të tij, Rizait, nga regjimi komunist (dënimi me burg pas luftës), nuk ishte temë e pëlqyer e Skënderit, madje as pas vitit 1990 kur kjo temë u bë refren në Shqipëri. As vendlindja e të parëve nuk ishte pjesë e interesimit të tij. Skënderi e ndiente veten shkodran dhe shqiptar në përgjithësi.

Dhe, mbi të gjitha, shkrimtar. E kam njohur Skënder Drinin dhe kam pasur miqësi me të. Gjatë vizitave të mia në Shqipëri në vitet shtatëdhjetë e kam takuar vetëm një herë, rastësisht, në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë (nëntor 1979), por më patën folur për të disa miq të tij dhe të mitë. Nuk mbaj mend kur dhe ku ka ndodhur takimi ynë i radhës, por kontaktet tona pak më të rregullta janë relativisht të vona: nga koha kur Skënderi e kreu misionin diplomatik në

Turqi dhe u kthye në Shqipëri.¹ Kemi pasur një lloj korrespondence, tek-tuk ndonjë bisedë telefonike, por edhe takime të drejtpërdrejta në Prishtinë dhe në Shkodër. Kemi shkëmbyer libra dhe kemi bërë edhe ndonjë shkrim për njëri-tjetrin, natyrisht unë më shumë se ai, jo vetëm pse isha më i ri, por edhe pse më takonte si studiues i letërsisë. Në një rast, në verë të vitit 2007, e kam vizituar në shtëpinë e tij në Shkodër, ku ai jetonte vetëm me bashkëshorten, në një

apartament pranë sheshit Isa Boletini. (Nga banesa e Skënderit shihej shtatorja e Heroit në mes të sheshit). Po kthehesha nga Ulqini, ku kisha marrë pjesë në Panairin e Librit dhe nuk mund të kaloja nëpër Shkodër pa e vizituar mikun tim, me të cilin na lidhte, pos të tjerash, edhe origjina e përbashkët.

Skënderi ishte njeri i çuditshëm. As në takimin në shtëpinë e tij, ku ishim vetëm unë e ai dhe gratë tona, nuk foli për familjen, për prindërit, e as për vendin nga vinte babai i tij, që kishte mbajtur si peng gjatë gjithë jetës emrin e lumit të vendlindjes, Drini, të cilin do ta trashëgonte edhe i biri i tij shkrimtar. Ndryshe nga ç'ndodhte, fjala vjen, me Remzi Përnaskën, me të cilin në çdo takim e bisedë Struga, vendlindja e nënës së tij (bijë e familjes Sojli), ishte e pashmangshme, me Skënderin nuk di të kemi folur ndonjëherë në këtë temë, me gjithë dëshirën dhe insistimin tim.

Në këtë plan, në raport me vendlindjen e të parëve, gjuhëtari tregohej shumë më emocional se shkrimtari.

Kur flitet për Skënder Drinin si njeri dhe shkrimtar nuk mund të mos përmendet edhe një fakt. Bashkëshortja e tij, Karolina (shkodrane, katolike), ishte invalide, e paralizuar pas një sëmundjeje që në vitin e parë të martesës dhe e ngujuar në

shtëpi. Skënderi kujdesej për të dhe për veten. "Çuditë - thoshte - se si njerëzit thonë: 'Nuk kam kohë!' Unë i bëj punët e shtëpisë, laj, pastroj, gatua dhe gjej kohë edhe për të shkruar. Ulem dhe shkruaj!"

Mos vallë edhe kjo rrethanë kishte ndikuar që Skënderi të tregohej shpërfillës ndaj "mitit" të familjes dhe origjinës? Nuk përjashtohet kjo mundësi, ndonëse ai nuk ishte aspak indiferent ndaj problemeve të shoqërisë shqiptare dhe fatit të kombit shqiptar në përgjithësi. Përkundrazi.

Kosova ishte në fokus të interesimit të Skënder Drinit, madje rrallë kam parë te kolegët e tij shkrimtarë dhe intelektualë në Shqipërinë shtetërore një interesim aq të gjallë, por Struga dhe shqiptarët në Maqedoni shumë më pak. Vetëm në një rast, në një letër që kishte si shkas një shkrim timin për Arbën Xhaferin me rastin e vdekjes së tij, më shkruante: "... nuk di pse nuk ta kam thënë që duhet të spostohesh paksa më shumë nga Maqedonia. Mirë apo keq, në Kosovë ka ca njerëz që mund të bëjnë njëfarë pune, kurse në Maqedoni mungojnë shqiptarët e ditur dhe patriotë". (Letër e vitit 2012, 13 shtator).

Një miku im i vjetër nga Tirana, shkrimtar dhe ai, nuk qe pajtuar me qëndrimin që kisha mbajtur unë ndaj Arbën Xhaferit si politikan (i qe dukur sikur e

kisha "denigruar" pak) dhe ma shfaqti mendimin e tij me shkrim si një qortim miqësor, kurse Skënderi bëri të kundërtën, më përgëzoi pikërisht për këtë qëndrim.

I tillë ishte Skënderi, i cili, edhe pse një kohë punoi diplomat (atashe kulturor në Stamboll), ishte jokonformist.

As për karrierën e vet diplomatike nuk fliste. Madje sikur qe penduar që kishte pranuar t'i shërbente një nomenklature politike që e kishte sjellë Shqipërinë në prag të gremisë në vitin 1997. Nëse për këtë heshtje, vendimin për të hequr dorë përkohësisht nga letërsia dhe për t'u marrë me publicistikë, e theksonte fort. "Kur filloi lufta në Kosovë, në vitet 1998-'99, unë i thashë vetes: 'Skënder, tani boll më me letërsi! Koha kërkon të kontribuosh në tjetër mënyrë: me analiza politike për situatën në Kosovë e në Shqipëri, por edhe në Ballkan dhe në botë!'".

Kështu fliste Skënder Drini, njeriu që luftoi në mënyrën e vet për lirinë e Kosovës, duke vazhduar t'i shfaqte pikëpamjet edhe për punët që duheshin bërë pas çlirimit të saj deri në krijimin e Kosovës shtet. Të vihet re mënyra se si e evokonte atë çast të jetës, duke iu drejtuar vetes me emër: "Skënder!", çka tregon se ai qe dhe mbeti në thelb shkrimtar.

Kritik ndaj vetes, Skënder Drini nuk mund të mos ishte kri-



ALBANA MEHMETAJ

TEATRI MODERN I IDEVE

(Dramat e Ernest Koliqit)

1. Pse teatër i ideve?

Në këtë pjesë studimi do të merremi me dy tekstet dramatike të Koliqit, të titulluara *Rrëjë të lëvizin* dhe *Takimi i orës 9 të mbramjes* të cilat i shkroi në fund të jetës. Meqë në titull i kemi shpallur si vepra të një teatri modern, duhet të theksojmë se fjalën e kemi në radhë të parë për tekste të shkruara për inskenim, ndërsa moderniteti i tyre ka të bëjë me konceptimin strukturor të teksteve dhe me idetë kryesore.

Ernest Koliqi është ndër autorët më të njohur të letërsisë moderne shqipe dhe një nga themeluesit e kësaj letërsie. Drama e tij trashëgon idetë e hershme dhe të ruajtura gjatë gjithë jetës së tij krijuese, të cilat struktura dramatike i

bënë shumë më të veçuara. Si një numër veprash moderne, këto drama i determinon vetëdija politike e autorit, por moderniteti i tyre nuk lejon që pozicionimet politike të bëhen haptazi.

Dramat e Ernest Koliqit janë vepra të ideve, në të cilat, si në teatrin modern në përgjithësi, idetë nuk thuhën haptazi, as nuk jepen si qëndrime politike, por vetëm sugjerohen. Teatri i tillë ka pak didaskali, ka pak veprim dhe gjithë ajo që ngjan jepet përmes gjuhës, ndërsa gjuha e ka trajtën e dialogut apo të monologut skenik. Skena, po ashtu, është shumë e shkurtuar dhe është lidhur me pamje statike, kurse personazhet bëhen zëdhënës të autorit.

Struktura dramatike e veprave të Koliqit, ashtu si në modernitet në përgjithësi, është mjaft e reduktuar, pa veprim të

fortë, me më shumë shqiptim të ideve sesa me veprim të personazheve. Dialogu mbizotëron në gjithë strukturën e dramës dhe duket se një autori si Koliqi i mjafton loja e fjalëve dhe kjo lojë nënkupton edhe veprimin.

Loja me fjalën, struktura dramaturgjike gjuhësore dialog-monolog, situatat e reduktuara kërkojnë që lexuesit, po ashtu, edhe audienca në teatër të bëhen bashkautorë të teksteve dhe t'i nderojnë ato përmes interpretimit personal. Këtë e konsiderojmë si veçori kryesore të teatrit të Koliqit, i cilësuar teatër modern.

2. Dramat e Koliqit

Ernest Koliqi, autor i njohur i veprimtarisë letrare moderne

dhe i artikullimit të ideve autoriale si konceptcion kryesor, dramat i shkroi atëherë kur ideja për shkrimin e tyre ishte pjekur estetikisht. Idetë dhe temat e tij të krijuara si variacione në forma të ndryshme letrare, duke filluar nga poezia, tregimet dhe romani, vijnë dhe konkretizohen në dramë si gjini e zgjedhur për të shprehur dramacitetin, pasionin poetik dhe lidhje më të drejtpërdrejtë me jetën reale. Shenjat shqiptare dhe shqiptarizmi në përgjithësi, kërkimi i identitetit, ruajtja e "palcit etnik", përvojat reale dhe shenjat autobiografike janë temat e përhershme të Ernest Koliqit të cilat në drama shpalosen si prodhim kulturor i ideve dhe jetësohen artistikisht në "veprimin dramatik".

Dramat *Rrëjë të lëvizin* dhe *Takimi i orës 9 të mbramjes* përmes një vije narrative dhe një idiomatike të veçantë arrijnë të konkretizojnë objektin letrar: *atdheu e ruajtja e identitetit nacional*, me personazhe ide, situata autentike dhe dialogë shënjes që shtrihen në një rrafsh të gjerë kuptimor. Kështu theksohen idetë politike dhe nacionale, duke u dramtaizuar edhe si veprim, edhe si gjendje shpirtërore.

Dramat e Koliqit kanë pothuajse mënyrë të ngjashme të strukturimit të tekstit, duke i ikur formës tradicionale dhe ndërtimit në pamje të gjera, për t'u fokusuar tek artikullimi i ideve. Këtij mendimi i kontribuon shumë forma e shkurtër e shkrimit dhe gjuha e autorit, si dhe didaskalitë, duke e bërë



MUSA RAMADANI

NJE TREGIM MBI NEVOJEN E NEVOJAT TJERA

Ai dhe Ajo janë bashkëshortë. Pothuaj përditë zihen për të njëjtat gjëra. Kështu ndodhi edhe kësaj pasditeje të vonë.

- Pse s’e thirre mjeshttrin e televizorëve? pyeti Ajo.

- Pse? - me pyetje iu përgjigj Ai.

- Si: pse, mirëfilli e di se televizori nuk po punon.

- Po, njëmend nuk punon.

- Ani?

- Çfarë: ani?

- Ja çfarë: duhet rregulluar.

- Nuk njoh asnjë mjeshtër të mirë në këtë qytet.

- Pyet, dhe dalëngadalë do t’i njohësh.

- Duhet.

- Atëherë pse s’i bie pas kësaj pune?

- Ngadalë de, edhe ai ka shpirt.

- Ka, ndaj edhe duhet t’ia përtërijmë.

- Jo. Mendova - edhe ai duhet të pushojë ndonjëherë.

- Të pushojë? Mbase nisesh nga vetvetja!

- Mbase!

- Po, po, madje pa asnjë fije “mbase”.

- Si duket, ti mendon se nuk punoj sa duhet? - pyeti Ai.

- Si ta marrësh - tha Ajo.

- Kë, çfarë?

Paj, punën, për të më duket se ishte fjala.

- Po.

- Atëherë?

- Kujtoj se punoj shumë: paradite, pasdite, natën.

- Mrekulli, e ku gjen kohë për pushim atëherë?

- Fare pak, por unë mendoj se pushoj.

- Mos është e kundërta?

- Thjesht: vetëm mendon të pushosh.

- Statistika do të fliste më së miri. Mëkat që s’merrem me të.

- Mëkat. Se do të shihej kush do të kishte të drejtë më shumë.

- Padyshim.

(Pauzë e gjatë.)

- Edhe shporetin s’e kemi në rregull.

- Njëmend!

- Më se seriozisht. Ka ditë që e pret mjeshttrin e vet.

- Piiih, djalli e martë!

- Edhe unë them ashtu: sot e kam përgatitur drekën te fqinja përballë banesës sonë. Edhe dje, edhe pardje...

- Kemi fqinjë të mirë duket!

- Po, por duhet t’i ruajmë. E jo t’i mërzisim çdo ditë.

- Pajtohem.

- Edhe unë pajtohem, a mjafton vetëm kjo se?

- E si u prish shporeti?

- U prish, vetvetiu. Do t’i jetë djegur diçka.

- A-ha, do të jetë djegur diçka, thua?

- E çfarë mund të ndodhë tjetër?

- Është vështirë të dimë.

- E di mjeshtri, servisi.

- Po unë s’e di se ku gjendet.

- Do ta mësosh.

- Mund të ndodh edhe mos ta di.

- Unë them: s’mundet.

- Unë them: mundet!

- S’mundet!

- Mundet!

- S’mundet!

- Mundet!

- Shih, shih. Tekembramja, ndodh gjithçka, por...

- Si mendon - gjithçka?

- Ashtu de: ndodh, fjala vjen, edhe njeriu të vdesë... dhe?!?

- Ndodh, edhe shpesh madje.

- Ç’nuk ndodh në jetë se?

- Dhe a ka mjeshtër për vdekje?

- S’ka, s’ka.

- S’ka! Edhe më mirë.

- Pse?





- Pse, do t’i pengonte jetëve të tjera, kujtoj.
- Padyshim, padyshim.
- Nejse, të mos filozofojmë, se s’do t’i shkonim në fund.
- Me siguri. E çfarë të bëjmë?
- Ka mjaft ç’të bëhet.
- (Pauzë e shkurtër).
- Çfarë?
- Paj, ja, fjala vjen, edhe makina e larjes nuk është në rregull - tha Ajo.
- Kush? - pyeti Ai.
- Makina e larjes.
- Ani çka: s’është e domosdoshme!
- Paske harruar disa gjëra.
- Cilat?
- Shikoji fëmijët dhe - numëroji.
- S’kam ç’t’i numëroj: i kemi tre, ndoshta s’janë shtuar?
- Jo, vetëm se edhe këta janë shumë.
- Ç’nënkupton ti me - shumë?
- Thjeshtë: çdo ditë makina s’pushon.
- Është e mundur?!
- Plotësisht: lahen një palë ndërresa, hyjnë të tjerat.
- Dhe: vetëm konstatova.
- Për më tepër: më i vogli orë e çast i mbush pelenat.
- I mbush-a?
- Plot e përplot. Vetëm makina i vjen hakut.
- Besoj. Po a s’i duhet edhe makinës pushim?
- Jo, vetëm kur s’ka punë.
- Vetëm kur s’ka punë?
- Po pra.
- E mirë, si kana jetuar nënat tona pa makinë larjeje?
- Atëherë s’kanë ditur ç’është kjo.
- Mendova: ndërresat s’kanë mbetur pa u larë ndoshta?
- Jo, sepse i kanë larë me dorë në govatë.
- Edhe ti: ke duar apo jo?
- Po, pse t’i fus duart në ujë kur është makina!
- Po ja se ndodh që makina të prishet.
- Ajo edhe mund të rregullohet.
- E derisa të rregullohet?!
- Ndërresat mblidhen, mblidhen, grumbullohen.
- Çudi!
- Përse çudi?! Tani është kohë tjetër.
- Kohë për t’i ruajtur duart prej punës!
- Vetëm për të lehtësuar e thjeshtuar punën.
- (Pauzë e gjatë).
- Mire, mirë, a mos edhe ndonjë send tjetër s’është në rregull? - tha ai.
- Po - tha Ajo.
- E çfarë?
- Bojleri i kuzhinës.
- Bojleri i vogël?
- Po de, po, ai me ujë të ftohtë e të ngrohtë.
- Ç’të mirën ka ai se?
- S’i kallet syri.
- Punë e madhe, ku e ka tjetrin?
- Ç’flet, bojleri vetëm një sy ka.
- Mirë de: punë e madhe!
- Punë e madhe, pra: s’e ngroh ujin.
- E kemi bojlerin e madh.
- Të banjës mendon?
- Natyrisht.
- Dhe?
- Pse s’shfrytëzohet uji prej tij?
- Shfrytëzohet, vetëm se kryesisht për t’u larë.
- Sepse atje është banja, e këtu kuzhina.
- Ç’pengon kjo?
- S’pengon, po enët zakonisht lahen në kuzhinë.
- Prej kur?
- Sot e gjithmonë.
- E deri kur?
- Paj... derisa të blejmë makinën për larjen e enëve!
- Prapë makinë!?
- Sigurisht!
- Për të gjitha punët shtëpiake - makinë?
- Pothuaj për të gjitha.
- Pih, ç’është puna e makinave! tha Ai.
- Shpikje e njerëzve të mençur, të dijshëm tha Ajo.
- Teknika!
- Teknika, teknika, shekulli njëzet.
- Edhe teknika çalon.
- Çalon se prore vjen duke u përsosur.
- Kam menduar se automatizimi lehtëson çdo gjë.
- Dhe dyshon?
- Nganjëherë të munduaka më tepër sesa mendohet.

- Sidomos njerëzit përtacë.
- Përtacë?
- Dhe ata që përtojnë për çdo gjë.
- Që përtojnë?
- Dhe ata që prore presin nga të tjerët.
- Presin nga të tjerët.
- Dhe ata që nuk janë pavarësuar.
- Nuk janë pavarësuar.
- Dhe ata që mendojnë se gjërat rregullohen vetvetiu.
- Mendojnë se gjërat rregullohen vetvetiu.
- Dhe ata që janë mësuar t’ua mbajnë brengën.
- T’ua mbajnë brengën.
- Dhe ata që janë inertë.
- Janë inertë.
- Dhe ata që s’lëkunden as nga tërmeti.
- S’lëkunden as nga tërmeti?
- Dhe, më në fund, të gjithë ata...
- Cilët, cilët?
- ... Si ti, si ti, që ngjajnë ty.
- Që më ngjajnë mua, që më ngjajnë mua, që më ngjajnë mua.
- (Pauzë e shkurtër).
- Hë, hë... u ndal edhe drita! tha Ajo.
- Qe besa u ndal - tha Ai.
- Terr si burg
- Ferr, ferr i vërtetë.
- Thuajse u fik bota.
- Thuajse erdhi kiameti.
- Ndoshta vetëm lagjja jonë s’ka dritë?
- S’e besoj, shiko për dritare.
- Nuk shihet dritë gjëkundi.
- Po këto që presin kryq e tërthor herë pas here?
- Janë faret e veturave.
- Nuk besoj të zgjasë shumë, kemi mjaft energji elek-trike.
- Për të tjerët, e për vete jo.
- S’merr vesh ti nga këto gjëra, ndaj ta ndërrojmë bisedën.
- E për çfarë të flasim në këtë errësirë?
- Për çfarë të duash. Errësira të bën të mendosh më shumë.
- Ashtu kam lexuar diku... Ja,- për shembull, a të të pyes diçka? - tha Ajo.
- Pyet ç’të duash.
- A e di tregimin mbi nevojën?
- Fillove me përralla. Duket se ende i ke në qejf.
- Të duket përrallë, në të vërtetë i vjen era jetë.
- Si, si?
- Përrallë jete.
- Ma rrëfe, pra, se nuk e di.
- Gjyshi ma rrëfente shpesh dhe të vetmen s’e kam harruar kurrë.
- Fillo, pra, i tëri jam bërë vesh.
- Kishin qenë njëherë në një fshat babë e bir, nisi Ajo.
- Po.
- Babai e kishte porositur të të birin që të shkonte në mal për dru.
- Po.
- Biri kishte pritur shumë duke thënë: s’di të ngarkoj.
- Po, po.
- Babai i kishte thënë: të mëson nevoja, bir.
- Po.
- Biri s’e kundërshton dhe shkon në mal.
- Po.
- Kur kthehet, babai kishte pyetur: si kalove?
- Po.
- Biri i kishte thënë: mirë, por krejt punën e bëra vetë.
- Po.
- Babai i kishte thënë: tregoma fill e për pe.
- Po.
- Biri i tregon: shkova në mal, preva dru, i tubova në një vend, dhe u ula pranë qeve pushoj. Prita mos po kalon kush atypari - par s’luajti askush...
- Po.
- Babai i kishte thënë: e si ia bëre?
- Po.
- Biri i kishte thënë: thirra disa herë: oj nevojë, oj nevojë! - mali ushtoi, por akush s’u përgjigj.
- Po.
- Babai i kishte thënë: dhe ç’bëre?
- Po.
- Biri i kishte thënë: pas një copë here pritjeje, thashë: po çohem e po ngarkoj vetë qerren me dru, se s’e paska mendjen të vijë nevoja, dhe u nisa me qerre plot për në shtëpi.
- Po... e pastaj ç’ndodh? - pyeti Ai.

- Pastaj babai i kishte thënë: paj, të kam thënë, more bir, se të mëson nevoja... Dhe ky është mbarimi.
- Ha, ha, ha, na qenka përrallë se jo mahi! tha Ai.
- Kurrë s’e harroj këtë përrallë të gjyshit tim - tha Ajo.
- Interessant, ende s’erdhi drita!
- Qe besa, te fqinjët paska ardhur.
- Ma jep baterinë ta heq siguresën në orën e rrymës.
- Ja, do të përpiqemi së bashku.
- Nuk jetohet në terr.
- Terri sjell gjithçka.
- Kërkojmë dritë! - tha Ai.
- Dhe gjithmonë e kemi kërkuar! tha Ajo.

LARTËSITË E ULTËSITË

- Dimër.
- Acar. Acar.
- Ngrica. Ngrica. Ngrica.
- Treni i shpejtë çan hapësirën dhe natën.
- Në kupeun numër 3 të vagonit 7 dy pasagjerë.
- Pranë dritares, ose më drejt: pranë radiatorit. Të kthyer me fytyrë nga njëri-tjetri.
- Rrallë vështrojnë peizazhet që tretin si dele të bardha.
- Më shpesh fërkojnë duart.
- I hukasin.
- Mërdhijnë.
- Për ku? - pyeti njeriu i moshuar me kapelë.
- Larg, larg - u përgjigj njeriu mesatar në çdo pikëpamje.
- Sigurisht për në kryeqendër?
- Po, nëpër kryeqendër. Dhe pakëz më larg.
- Sigurisht me ndonjë punë?
- Sigurisht.
- Urgjente?
- Urdhëroni?
- A është urgjente?
- Më falni s’po kuptoj.
- Mendoja: a është e ngutshme? A, e mora vesh: jo hiç.
- ?
- !
- Domethënë do të qëndrosh ndonjë ditë?
- Më duket se po.
- Ke ndonjë pushim mjekësor apo jo?
- Jo.
- Por...
- ... Pushim vjetor.
- Njeriu i moshuar me kapelë ia plasi gazit.
- Kur e veneroi se bashkudhëtari mbeti i pandryshuar, foli:
- Më falni: vetvetiu më doli gazi. Më bëre të qesh, mik i panjohur në këtë të ftohtë.
- Vështirë ndikoj tek të tjerët... ndoshta.
- Ja, radiatori zë të lëshojë nxehtësinë.
- Mendoj se është koha më.
- Si e di ti këtë?
- S’e di, vetëm se ka gjysmë ore që kur është nisur treni.
- Ani?
- Ani asgjë - është koha të na ngrohin pakëz.
- Ashtu është. Dhe ta dish: radiatori premtan se do të ngrohemi.
- Duhet besuar.
- (Kryhen disa veprime të vogla, të domosdoshme, të parëndësishme, më në fund).
- Duke mos ia vënë veshin njëri-tjetrit).
- Të nderim nga një cigare duhan? propozoi njeriu i moshuar me kapelë.
- Mundemi, pse jo - pranoi njeriu mesatar në çdo pikëpamje.
- Tani që po ngrohemi, edhe duhani shkon më mirë.
- Me siguri. Më parë as më kishte rënë ndër mend për të.
- Ashtu është.
- Ashtu, ashtu.
- (Fjollat e tymit përhapen nëpër kupe. Mësyjnë kën-deve, në trajta tërheqëse. Pastaj zhdavariten dhe hum-bin çdo trajtë.)
- Mjegull e madhe, - tha njeriu li moshuar me kapelë.
- Shumë e madhe, pohoi njeriu mesatar në çdo pikë-pamje.
- Kah qielli, po mendoj.
- Mbi tokë, mendova unë.
- E dendur si qilimi.
- E rrastë si cerga.
- Tym.






- Tym.
- Thuaje e tërë toka është kallur dhe tymon si oxhak i madh.
- Thuaje krejt nën tokë është kallur e tani mbi tokë i del tymi.
- A sheh: nuk duket fare qielli.
- Qe besa, vende-vende s'duket as toka.
- Hëm, interesant është qielli...
- Interesant?...
- ... vetëm për ta shikuar.
- Ashtu....
- ... E jo më për të gjurmuar më shumë.
- Mundet, mundet.
(Bashkëbiseduesit shtypën duqat e cigareve. Shikuan orën pothuaj përnjëherësh sikurse të bënin ushtrime. Papritmas secili për vete ndezën edhe nga një cigare duhan. Ja, lëshuan edhe tymin e parë, të trashë e të bërë lëmsh.)
- Ç'di ti për qiellin...?
- Pak...
... Dhe ç't'intereson.
... Nga pak.
- A di, fjala vjen, për fshehtësirat e kësaj bote?
- Di dhe mësoj çdo ditë.
- Më shkurt: a di për fshehtësirat e qiellit e të trupave të tjerë qiellorë?
- Më falni, ju jeni...?
- Unë, jam, unë. Më falni... unë jam njëfarë shken-cëtari.
- E përse s'jeni shkencëtar?
- Sepse s'kam kushte e mjete për të bërë hulumtime.
- Pa vegla nuk punohet gjëkundi.
- Nejse a e di që një qiell do të duhej të ketë gjallesa?
- Kam dëgjuar.
- A ke dëgjuar që nëse kjo vërtetohet qind për qind, një ditë, njeriu mund të shkojë në Hënë, Mars e në planetë të tjerë?
- Kam lexuar diçka në shtypin e përditshëm.
- Dhe merre me mend: do të vinim lidhje me një botë tjetër, të panjohur deri tani, të imagjinuar?
- Po, dhe çfarë?
- Do të shkonim në vizitë, sikurse vizitojmë qytetet e shtetet e tjera në tokë.
- Me çfarë se?
- Paj, me, fluturake, me anije, me aeroplanë.
- Ti shpreson shumë në këtë gjë?
- Fort e fort madje. Pse a thoshin pleqtë përpara se s'është e mundur të fluturojë aeroplani. - Dhe - ja se ajo ëndërr u bë zhgjëndërr.
- U bë, por kjo...
- Më fal, a ke udhëtuar ndonjëherë me aeroplan?
- Jo.
- Asnjëherë?
- Fare. As këmbën s'e kam vënë në të.
- Pseee?
- Thonë se është shumë shtrenjtë dhe...
- Është, po jo edhe aq.
- t'ju them (të drejtën: më të sigurt e ndiej veten kur ec përtokë, ndaj edhe në tren dhe në autobus.
- Varet prej vetë njeriut. Ndonjëherë edhe kur pushon në kokërr të shpinës mund të mos e ndiej veten të sigurt.
- Çka s'ka në këtë botë!
- Nejse... ku e pata fjalën më parë... Hë, m'u kujtua. Me fluturake do të mundeshim të kalojmë edhe pushimin e vjetër në ndonjë trup qiellor.
- Pushimin vjetor, thoni!
- Pse jo. Si në det, në liqe a gjetkë. Njësoj do të ishte.
- Njësoj?!
- Po, vetëm varet prej kushteve të atjeshme klimatike.
- Ndoshta, ndoshta.
- A s'do ishte kjo një gjë e mrekullueshme?
- Ndoshta.
- Teknika ka përparuar shumë.
- Ka përparuar.
- Edhe shkencat përgjithësisht.
- Ashtu po thonë.
- Ashtu është. Kush ka ëndërruar më parë radion, telefonin apo televizorin.
- Pothuaj askush.
- Ashtu, pra.
- Ashtu qoftë!
- Jo ashtu qoftë, po duhet besuar.
- Po, një plak më ka pasë thënë një fjalë: në kohën e sotshme çdo gjë që të ndodhë, mos u çudit, vetëm se përgëzoje! S'i harroj këto fjalë, ai ka qenë plak shumë

i urtë.
- Ndoshta ai e ka pasur me tallje po, sidoqoftë, mirë e paska pasur dhe mirë e paska thënë.
(Treni zuri të shkërryhet nëpër binarë. Përmes qelqit dallohej mbishkrimi i ri i një stacioni të madh. Ata u ngrehën në këmbë. Dolën në korridor t'i shpinin gjymtyrët. Mjegulla tregonte sendet si në ëndërr.).
- Përnjëmend qielli është një fshehtësi e madhe.
- Është, është, ju e dini më mirë.
- Duket se jeni i dhënë pas hulumtimeve?
- Kjo më preokupon natë e ditë.
- Shumë kohë harxhoni duke menduar?
- Shumë. I tëri jam kthyer me fytyrë kah qielli.
- Çudi.
- Si çuditeni, a s'ju thashë se qielli është fshehtësi e madhe.
- Dhe toka.
- Toka, thoni?
- Toka, madje ndoshta edhe shumë më e madhe.
- Po në qiell vlen të gjurmohet. Rezultatet e tanishme jo vetëm se inkurajojnë, po edhe obligojnë njeriun.
- Njësoj mund të thuhet edhe për tokën.
- Më falni, ju jeni...?
- Unë jam, unë. Më falni... unë jam xehetar.
- Xehetar thoni?
- Xehetar.
- Xehetar i vërtetë.
- Më duket se po.
- Sigurisht s'keni shumë përvojë?
- Nja njëzet vjet, jo më shumë.
- O, ju po ia njohkeni shpirtin tokës.
- Mundohemi, ditë për ditë më tepër.
- Më vjen mirë, besomë, kam pasur qejf të takohem më një xehetar.
- Ja, keni rastin, pra.
- Si është jeta atje poshtë, pashë nderin?
- Në galeri, mendon?
- Ashtu de, poshtë, nën tokë?
- Jetë, çdo tjetër, ku punohet e derdhet djersa.
- Ju futeni shumë thellë?
- Deri në paralelen e pesëmbëdhjetë.
- Ashtu a-po? Dhe - gërmoni tokën.
- Gërmojmë, gërmojmë.
- Në zemër të tokës?
- Ndoshta edhe në zemër.
- Prekni nëpër damarët e saj.
- Prekim dhe i presim.
- S'keni dhembshuri par të?
- S'kemi, e as mendojmë për dhembshuri.
- S'ndieni gjë të keqe që e lëndoni?
- Si, pse, ç'mendonit me këtë?
- Paj, ashtu, pyes.
- Ke dhembshuri për tokën?
- Paj... si t'ju them.
- Dhembshuri?
- Dhembshuri de!
- Për tokën?
- Për tokën, për çfarë - vallë!
- Ndoshta në një mënyrë e ndiejmë.
- Ja, re në fjalën time.
- Por, kur është në të mirë të njeriut?
- Për njeriun?
- Për njeriun, pra!
(Në çast dera e kupeut u hap. Një udhëtar pyeti nëse kishte vend të lirë. Dhe ende pa marrë përgjigjen e saktë, u zmbraps papritmas. Dera kërciti më fort sesa pak më parë kur u mbyll.)
- Është interesante - foli njeriu mesatar në çdo pikë-pamje.
- Çfarë, çfarë? - thuajse mezi priti njeriu i moshuar me kapelë.
- Fakti, mendova.
- Fakti, e cili fakt?
- Ai i qëndrimit të vetë njeriut.
- Ndaj?
- Ndaj punës që kryen e bën.
- Me siguri se nuk duhet të jetë edhe jointerese.
- Më ka lënë dikush një fjalë...
-... Ashtu...?
-... e cila më kujtohet gjithmonë.
- Kush është ai?
- Nuk di: plak apo i ri, i pashkollë apo i shkolluar.
- Nejse, me rëndësi është se çfarë ka thënë.
- Më pat thënë kështu: i lumtur është ai njeri që gjen kënaqësi në punën e vet!
Dhe?

- Dhe asgjë më tepër.
- Jo, mendova: i beson ti kësaj fjale?
- E përse të dyshoj në të!
- ?
- Eh, si është puna e xehetarit.
- !
- Futesh çdo mëngjes herët nën tokë dhe del mbas mesdite.
- Po.
- Çdo ditë thuajse kërkon diçka të re.
- Po.
- Dhe çdo ditë ke nga një fitore të re.
- Fitore?
- Po, xehetarët prorre duhet të fitojnë.
- Është kjo luftë?
- Mund të merret edhe luftë. Lufta juaj, pra është interesante.
- Shumë. Gërmojmë e gërmojmë.
- Dhe e dimë se fund s'ka.
- Sepse toka ka qindra, mijëra, miliona shtresa.
- Sa më thellë futesh, fitorja është më e ëmbël.
- A do ta kishte ndërruar këtë punë me ndonjë tjetër?
- Jo kurrë.
- Ashtu?
- Tamam ashtu. Jam mësuar të gërmoj. Edhe në gjumë, në ëndërr, gërmoj e gërmoj.
- Si e ndieni veten atje në thellësi?
- Si në fund të botës.
- Frikoheni?
- Në fillim po, po tani as mendoj në të.
- Asnjëherë?
- Asnjëherë! Fundi i fundit, s'mund bëhet secili xehetar!
- Xehetari duhet të jetë trim!
- Çfarë trimi?
- Trim i nëntokës, që e do po s'i frikohet.
- A mendon se aty do ta presësh pensionin?
- Po, dhe jam krenar!
- Krenar!
- Krenar, se jam mësuar me tokën!
- E di se si merr frymë, ia njoh erën, ngjyrat, fsheh-tësitë dhe çdo gjë më duket.
- Edhe toka ka fshehtësitë e veta.
- Të shumta, të panumërta, të pashpaluara.
- Cilat çaste janë më interesante?
- Refrenet e përditshme: me fat!
- Me siguri edhe ato e kanë bukurinë e vet.
- Paj, a ka gjë më të bukur se kur xehetari lëshohet në galeri dhe kur del prej saj pas punës.
- Njëmend flitni?
- Më se përnjëmend. Po këto gjëra s'mund përshkru-hen.
- Vetëm mund të ndihen e të përjetohen.
- Ju qenkeni njeri tokës.
- Kam qenë dhe do të jem.
- Ia njihni edhe palcën.
- Përditë e më shumë.
- Qenkeni lidhur ngushtë me të.
- Që nga fëmijëria.
- Do t'i qëndroni besnik deri...
- Deri në vdekje.
(Fishkëllimat paralajmëruan se treni po hynte në kryeqendër. Bashkudhëtarët shikuan përmes dritares së djersitur. Në tren u ndie një lëvizje njerëzish. U ngrehën në këmbë, u shtrënguan dhe morën sendet në dorë.)
Dimër.
Acar. Acar.
Ngrica.
Jeta është e gjatë, po pas përshëndetjes reciproke ndoshta kurrë s'do të takohen më në jetë!



ADEM GASHI

NATA

Pas luftërave të pareshtura e të përvitshme, Dukata e Gjinit, një mëngjes u ndeh e qetë. Dhe kjo ndodhi pikërisht në vitin një mijë e katërqind e... Fili pas kësaj qetësie të shkurtër filloi mëkëmbja. Burrat i varën shpatat që ende s'u ishte tharë gjaku i luftës dhe iu kthyen grave të tyre dhe tokës. Ishte një dhëndri e paparë ndonjëherë. Shi binte tërë natën, dielli rrezonte gjithë ditën varur si një medaljon i artë në pezulin e kaltër të qiellit. Livadhi i legjendës u shtrua e shpërtheu gjelbërimi i njohjes, i rinjohjes:

Ti je biri im! - shfrynte mallin e moshës plaka e verbër.

Të kam nënë, - i thoshte i biri.

Pikërisht këta sy të zezë janë dritat e zemrës sime! - fliste Vasha.

Pikërisht kjo kaltërsi e syve të tu është qielli im i kërthëndezur! - përgjigjej Trim.

O, ky qenka krahu im i djathtë! - kujtohej Vëllai i vogël.

O, ti krahu im i majtë! - përmashej Vëllai i madh dhe, aty ku hidhej përqaqimi i rinjohjes, vihej guri i muranës e mbillej plepi. Djersa pikonte, s'pikonte

çatia.

Dukata e Gjinit ngadalë po hynte në parajsën e legjendës. Themelet e saj tashmë qenë hedhur. Koha llogaritej sipas kalendarit të nëntëvjetshave deri te të nëntëdhjetenëntët, hapësira kufizohej me nëntë kodra, ngaqë banorët e Dukatës nuk i pranonin shtresat e nëntokës e të mbiqiellit. Në rrafsh ende ishin të freskëta gjurmët e të ikurve herë me gishtërinj nga lindja, herë me thembra nga jugu. Kujtimi për bajlozët e gjergjelezët thurej si rrëfim dhe lëshonte shtat tok me muret e legjendës. Një gjysmëhënë buzë kodrave projektonte vegullinë e verdhemë të kuromave netëve të errëta, ndërsa Syri i Keq dukej kthesave e leqeve. Banorët e Dukatës u denën nën prajshmërinë e harmonisë, sepse shpërthimi i bëfshëm i lëngut të jetës ua kishte shëruar dhembjet e plagëve. Vjeshta ua mbushi hambarët grurë e misër. Lirin e konopin s'e arrinte dora e njeriut. Lehonia u shtri anekënd bashkë me vjeshtën. Ishte një shtim i paparë ndonjëherë në Dukatën

e Gjinit. S'mbeti grua pa lindur, me përjashtim të vejushës Sebë, që ishte një beronjë e vjetër dhe mitra e saj ishte vyshkur si një bimë gjembaçe në shkretëtirë.

Foshnjat e lindura qenë të gjitha të shëndetshme. Megjithëse dy herë më shumë u lindën çuna sesa çupa, kësaj askush nuk i jepte rëndësi në Dukatë dhe nuk brengoseshin për martesat e ardhshme. *Le të na rrojnë djemtë - thoshin, - pa kemi princeshat e Parisit.*

Me llafe për princeshat e buta me lëkurë të hollë i zuri thëllimi i vjeshtës së tretë që erdhi e u shtri për t'i bërë vendin dimrit. Njerëzit nga .parajsa e legjendës po rrëshqitnin në mbretërinë e përrallës. Për plot tre muaj parakaluan të gjithë heronjtë e mundshëm e të pamundshëm të fantastikës njerëzore. Mjegulla e dendur e fantazisë së gjysheve i endte shpirtrat e nipërve njomakë nëpër konstelacione të papara e të padëguara “larg qoftë prej këtej”.

Me rrezet e para të diellit pranveror ra edhe një tis ëndërimi mbi kokat e njerëzve,

ra edhe një fjollë kotjeje si në orët paramëngjesore. Çdo gjë do të kalonte pa u vënë re, po të mos binte ky ëndërrim pikërisht në sezonin e zgjimit, të ripërtërtjes.

Plaku Mjekërbardhë, që ishte më i moshuari në Dukatë, e zuri të nipin për dore dhe i tha që t'i printe drejt Kodrës së Kumtit. Nipi u habit me vendimin e gjyshit, po nuk ia bëri fjalën. Diku nga mesi i rrugës u kujtua se ende nuk ishin dukur kojrrillat dhe as lulepjeshkat. Mos u nxitua këtë herë gjyshi? - dyshoi për një çast.

Përvoja me tri këmbë ngjitej monopatlit me mundim të madh. Djerseje e ofshante. Dikur nga mesdita ia dhanë mu në majën e kodrës. Rrafshi i përgjumur shtrihej rreth e qark në një pritje të ngeshme.

- Jepe, nipçe, Kumtin e Zgjimit, jepe mos prit! E sheh se jemi vonuar për njëqind vjet? foli Plaku Mjekërbardhë, - Jepe, nipçe, kumtin se po pikojnë çatitë, po shtinë berret, po rrënohen muret, nuk po tymojnë oxhaqet. Jepi, nipçe, zërit se ka rënë shurdhimi, po

heshtin këngët, po shuhen vallet. Shpirtin e ka zënë lëngata e vonesës. Çdo gjë duhet filluar nga e para, jepi nipçe! Plaku Mjekërbardhë e nguli kërrylen në majën e kodrës, u shtri në kurriz dhe e drejtoi fytyrën nga dielli. Më vonë një re e bardhë u shtri gjerë e gjatë mbi trupin e tij.

Nipi kishte vënë njërën dorë pas veshit, tjetrën në mjekër dhe për të tretën herë po e mbushte hapësirën me O-të dhe E-të e zgjimit. Kur e mbaroi kumtin, pa një re të bardhë që po largohej drejt perëndimit. Deshi ta pyeste gjyshin, po në vend të tij pa vetëm kërrylen. U afrua ngadalë dhe e kapi me dorën e djathtë. Vetëm atëherë hetoi se mjekra i ishte rritur gjer te këmbët. U përpoq ta kujtojë nisjen, rrugën drejt Kodrës së Kumtit, po ajo ishte tashmë një pikë e ngatërruar qëkur në lëmshin e madh të harresës. *Jemi vonuar për një shekull - e përsëriti mendimin e gjyshit, që tashti iu duk si i veti, - na duhet bërë shumë rrugë për ta gjetur vetveten, për të hyrë në zemër, për ta zgjuar shpirtin. Jemi vonuar e na janë shpifur*



ADIL OLLURI

PLAKU DHE TRI FOTOGRAFITE

Prajshëm rridhte uji i lumit. Lumi ishte ai që ishte, as i madh e as i vogël. Gjarpëronte mes për mes fshatit L. Shtëpia e plakut A. ishte fare pranë lumit dhe kishte fatin ta përshëndeste e para rrjedhën e tij. Brenda shtëpisë njëkatëshe, njeriu mund të shihte orendi të vjetra e të thjeshta, me të cilat nuk ke si të mos habitesh. Një sofa më se e zakonshme, një tryezë e çarë në mes. Pranë saj një karrige gati e thyer. Përpos e thyer, ulësja e saj qe edhe e shqyer. Një kuzhinë e vjetër dhe një pjatë e stërvjetër në të. Një mur i pluhurosur, ku rrinin të varura tri fotografi. Plaku jetonte i vetëm. Plaka i kishte ikur te të shumtët. Ai nuk pastronte gjë tjetër në shtëpi, pos tri fotografive të vëna në kornizë që binin në sy me të hyrë brenda. I pastronte çdo mëngjes. Nuk i lyente

asnjëherë këpucët e tij, por kujdesej gjithnjë për tri palë këpucë të tjera që rrinin gjithnjë pranë derës. I lyente çdo mëngjes. E përshëndeste lumin me rrjedhën e tij të ngadalshme dhe e kryente ritualin e tij të përçdoditshëm. Tre djemtë flokëverdhtë brenda kornizave e shikonin plakun që rrudhej e kërrusej çdo ditë e më shumë. Ia ndjenin vetminë. Ia shihnin rrobat e palara në trup. Këmishën e bardhë që dita-ditës po merrte tjetër ngjyrë. Mjekrën e bardhë që nuk e kishte pasur. Pantallonat e grisura që nuk kishte kush t'ia qepte. Flokët e zbardhura që i iknin nga koka e tij imcake. Sytë që i lotonin herë pas here. Sytë ia shihnin më së shpeshti. Po, po, sytë ia shihnin më së shpeshti. Ata sy që ktheheshin orë e çast kah fotografitë e që gjallonin

vetëm falë tyre. Plaku e vriste kohën duke e pastruar buzëlumin. Nuk kishte ç'të bënte tjetër. I mblidhte guralecët që lumi i degdiste jashtë tij dhe ia kthente sërish atij. Ia kthente edhe qeset e gjërat e tjera që lumi i hidhte matanë. Asgjë të lumit nuk e donte afër shtëpisë së tij. Tmerrshëm frikësohej kur ai rrëmbehej. I mbyllte dyer e dritare dhe nuk dilte jashtë derisa ai të qetësohej sërish. I gëzohej ditëve me diell, i gëzohej motit pa borë e pa shi. Ishin të vetmet që nuk e ngacmonin lumin. Nuk e shfrynte mllefin ditëve të tilla. Qetësisht e shëtiste fshatin, pa zhurmë, pa bujë. Edhe atij i pëlqenin ditët e qeta, sikurse plakut tonë. Të rralla e të pakta ishin ditët kur lumi e shfaqte mllefin, por ato, natyrshëm, i kujtonte më shumë e më shpesh se të zakonshmet.

Lumi kishte parë gjëra që nuk donte t'i shihte. E kishte parë vuajtjen, pikëllimin, djersën dhe gjakun e fshatarëve që ishte derdhur mbi trupin e tij. Lumi nuk kishte ç'të bënte, pos ta lëshonte vajin e tij të pazakonshëm. Sa herë që vinte dita e fundit e marsit, plaku dilte në qytet. Të vetmen herë brenda vitit. I blinte tri korniza të reja dhe i vendoste fotografitë e djemve në to. Të vjetrat i hidhte në lumë. Gjatë rrugës së kthimit nga fshati në qyteti, për çdo vjet frikësohej llahtarshëm se mos lumi e tregonte ashpërsinë e vet dhe ia rrëmbente kornizat e reja. Por, lumi ecte qetësisht në rrugën e tij. Ashpërsinë e tij e kishte treguar vetëm njëherë dhe kishte qenë e mjaftueshme. Plaku, megjithatë, sërish frikësohej e frikësohej. Sikur donte t'i thoshte lumit “duro edhe pak dhe do të t'i sjell

kornizat e vjetshme”. Plaku sërish i ndërronte kornizat. Rudhat e ballit i thekso-heshin gjithnjë e më shumë. Shtëpia sa vinte e vjetrohej dhe humbte shkëlqimin e dikurshëm. Këmisha e plakut ngadalshëm, por sigurt, po e humbiste ngjyrën e mëparshme. Tryeza e çarë në mes nuk rregullohej se nuk rregullohej dot. Sytë e plakut kishin filluar të mos shihnin më qartë. Mjekra vetëm rritej e rritej. Flokë më nuk kishte. Të vetmet pamje që nuk ndryshonin dot në shtëpinë e vogël të plakut ishin pamjet e tre flokëverdhtëve në fotografi. Nuk luanin qerpikë. Nuk bëzanin. Nuk hidhëroheshin e as nuk gëzoheshin më! Plaku dhe lumi lundronin ngadalshëm nga dita në ditë. Ndryshonin pamje nga stina në stinë. Ata jo! Prajshëm rridhte uji i lumit.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT Enveri
PILKINGTON
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Montim
Servisim
Përmirësim



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

TOP NGJARJET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE TË SPORTIT NË VITIN 2025



PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Sporti vendor dhe ai ndërkombëtar kanë qenë të stërmbushur me aktivitete, suksese dhe sfida të shumta. Kombëtarja e Kosovës në futboll ka arritur sukses historik, duke siguruar për herë të parë “play-off-in” e Kupës së Botës. Ndërsa në arenën ndërkombëtare, PSG-ja dhe Chelsea kanë qenë skuadrat më të trofeshme, duke fituar Ligën e Kampioneve dhe Kupën e Botës për klube. Krahas sukseseve, bota e futbollit është tronditur nga vdekja tragjike e futbollistit të Portugalisë dhe Liverpoolit, Tiago Jota.

2025-a, vit historik për futbollin e Kosovës

Viti 2025 ishte pa dyshim më i suksesshmi për futbollin e Kosovës që nga anëtarësimi në UEFA dhe FIFA. Vetëm nëntë vjet pas bashkimit në familjen evropiane dhe botërore të futbollit, vendi ynë jo vetëm që

po mban hapin, por është duke korrur rezultate që shpesh i lakmojnë edhe federata me dekada të tëra traditë ndërkombëtare. Ky vit ka dëshmuar fuqinë e futbollit të Kosovës si përmes suksesit të Kombëtares së Kosovës, po ashtu edhe përmes arritjeve historike të FC Drita në Ligën e Konferencës dhe FC Prishtina 01 në Ligën e Kampioneve të Futsallit. Puna e palodhshme e kreut të Federatës, Agim Ademi, dhe vizioni i përzgjedhësit Franco Foda në afrimin e lojtarëve cilësorë e të rinj, sollën rezultate të prekshme. Në mars, dardanët shkruan faqen e parë të këtij viti të artë: Kosova u ngjiti në Ligën B të Ligës së Kombeve, pas dy fitoreve të merituar ndaj Islandës, 2:1 në “Fadil Vokrri” dhe 3:1 në Murcia të Spanjës. Një kapitull i ri u hap për futbollin tonë, por rrugëtimi nuk u ndal këtu. Në kualifikimet për Botërorin 2026, Kosova arriti një tjetër moment historik:

përfundoi e dyta në Grupin B me 11 pikë, duke siguruar për herë të parë “play-off-in” e Kupës së Botës. Humbja ndaj Zvicrës në Bazel vetëm sa e forcoi kampin e dardanëve. Dy fitore të mëdha ndaj Suedisë, një fitore dhe një barazim ndaj Sllovenisë dhe një barazim ndaj Zvicrës mbyllën një cikël madhështor.

Tani para nesh qëndrojnë dy sfida vendimtare: në mars gjysmëfinalja me Sllovakinë në Bratisllavë dhe, në rast fitoreje, finalja e madhe në “Fadil Vokrri” ndaj Turqisë ose Rumanisë. Realizimi i këtij objekti do ta dërgonte Kosovën në Grupin D të Botërorit 2026, së bashku me ShBA-në, Paraguain dhe Australinë - një ëndërr e shumë gjeneratave. Seria brilante prej 8 fitoreve, 2 barazimeve dhe vetëm 1 humbjeje gjatë vitit 2025 e ngriti dukshëm Kosovën edhe në renditjen botërore. Dardanët po e mbyllin vitin në vendin e 80 të FIFA-s. Viti ishte i suksesshëm

edhe për Kombëtaren U21, e cila nisi rrugëtimin drejt Euro 2027 me bilanc pozitiv -2 fitore, 2 barazime dhe vetëm një humbje. Ndërkaq, Kombëtarja U17 e vajzave siguroi kalimin e merituar në Ligën A për kualifikimet e Euro 2026. Në arenën e klubeve, suksesi ishte po aq mbresëlënës: FC Drita u bë klubi i parë kosovar që arriti ta kalojë fazën e ligës së Conference League, duke siguruar “play-off”-in për 1/8 e finales dhe duke na bërë krenarë me paraqitjet e saj. Ndërsa FC Prishtina 01 shkroi histori në futsall, duke arritur deri në 1/16 e finales së Championsit. Të gjitha këto suksese nuk janë rastësi. Ato janë fryt i punës, angazhimit dhe vizionit të qartë me të cilin po ecën futbollit kosovar. Viti 2025 po e mbyllim me krenari. Dardanët kanë dëshmuar se mund të shkojnë edhe përtej pritshmërive. Kosova po jep shembull dhe faqet e reja në histori po shkruhen. Tani të

gjithë sytë i kemi nga muaji mars, aty ku ëndrra e madhe mund të bëhet realitet.

Shqipëria siguron “play-off”-in për Botërorin 2026

Shqipëria ka shkruar një faqe të re në historinë e futbollit shqiptar, duke siguruar kualifikimin në “play-off” të Botërorit 2026 pas fitores 0-1 në transfertë ndaj Andorrës. Një ndeshje që duhej fituar me çdo kusht dhe ku kuqezinjtë e bënë detyrën me personalitet, qetësi dhe vendosmëri.

Heroi i sfidës ishte bërë Kristjan Asllani, i cili në minutën e 67 kishte zhbllokuar takimin me një goditje të saktë brenda zonës, pas një asistimi perfekt nga Myrto Uzuni. Një aksion i ndërtuar me qetësi, presion dhe inteligjencë, që shpërtheu në festë të madhe për skuadrën dhe tifozët shqiptarë. Kuqezinjtë dominuan në



ndeshje, kontrolluan ritmin dhe nuk lejuan asnjë surprizë nga vendasit. Sylvinho ka kërkuar maksimumin deri në minutën e fundit dhe ekipi iu përgjigj me disiplinë të hekurit dhe grintë në çdo duel. Me këtë rezultat, Shqipëria ka siguruar matematikisht vendin që e çon në “play-off”, duke hyrë mes skuadrave që do të luftojnë deri në fund për një biletë historike drejt Kampionatit Botëror 2026. Një arritje e madhe, e merituar dhe e fituar me shumë mund, që ndez krenarinë e çdo shqiptari. Shqipëria në “play-off” do të ndeshet me Poloninë.



Distria Krasniqi mbyll vitin në krye të botës

Unioni Evropian i Xhudos (EJU) i ka kushtuar një shkrim të veçantë Distria Krasniqit, e

cila ka përfunduar vitin e para në ranglistën botërore në kategorinë deri në 52 kilogramë dhe e dyta në ranglistën e përgjithshme botërore. Krasniqi e ka vlerësuar vitin 2025 shumë të suksesshëm, duke theksuar se ka fituar medalje në çdo garë. Ajo veçoi titullin e tretë kampione e Evropës dhe finalen e parë në Kampionatin Botëror për të rritur. Edhe pse pranon se jo gjithmonë ishte në formën më të mirë, Distria thekson se në garat kryesore ishte në nivel maksimal, gjë që e ka karakterizuar gjatë gjithë karrierës. Ajo njihet për vazhdimësinë e sukseseve dhe përkushtimin në punë. Garat Grand Prix dhe Grand Slam i sheh si teste, ndërsa prioritet mbeten Lojërat Olimpike dhe kampionatet botërore dhe evropiane. Së bashku me trajnerin Driton Kuka, ajo analizon vazhdimisht paraqitjet për përmirësime të mëtejshme. Distria ka kaluar me sukses ndërmjet kategorive të peshës dhe thotë se nuk ndikohet nga presioni, përkundrazi, e shijon garën. Meritat e mëdha për suksese ia atribuon trajnerit Kuka. Ajo thekson se Kosova është shndërruar në superfuqi të xhudos falë punës dhe përkushtimit, ndërsa gjeneratës së re i këshillon punë dhe qëndrueshmëri.

Edhe pse nuk mendon për përfundimin e karrierës, Distria shprehet se do të mbetet pjesë e xhudos.



Drita shpallet kampione e Kosovës

Skuadra e Dritës është shpallur kampione në sezonin 2024/25 në Superligën e Kosovës në futboll. Ekipi i Zekrija Ramadani ka grumbulluar 69 pikë pas 32 xhirove, duke siguruar titullin kampion. Titulli i kampionit është kthyer në Gjilan pas 5 vitesh mungese dhe për këtë merita të mëdha ka pasur trajneri Zekrija Ramadani. Drita gjatë vitit që lamë pas ka treguar rezultate pozitive edhe në arenën ndërkombëtare duke siguruar “play-off”-in në Ligën e Konferencës.



Prishtina fiton Kupën e Kosovës dhe siguron daljen në Evropë

Prishtina është fituese e edicionit 2024/25 të Kupës së Kosovës në futboll. Në finalen e zhvilluar në stadiumin “Fadil Vokrri” në kryeqytet, në prani të rreth 10 mijë tifozëve, skuadra e kryeqytetit e kishte mposhtur Llapin me rezultat minimal 1:0, duke e siguruar kështu trofeun për herë të nëntë në histori dhe për herë të dytë në tri edicionet e fundit.

Drenica privatizohet, bëhet me pronar të ri

KF Drenica ka nisur një etapë të re, pasi klubi është privatizuar dhe tani do të ketë një pronar të

ri. Nga tani e tutje pronarë të Drenicës do të jenë Thomas Wustenfeld dhe Faton Seferi. Aktualisht, Drenica është pjesë e Superligës së Kosovës në futboll.



Arb Manaj “Futbollist i vitit 2025”, Amir Rrahmani fitues i çmimit “Fadil Vokrri”

Federata e Futbollit e Kosovës ka organizuar ngjarjen tradicionale “Laureatët 2025”, ku janë nderuar dhe vlerësuar individët,



Chelsea fiton Kupën e Botës për klube

Chelsea ka fituar Kupën e Botës për Klube, teksa ka triumfuar 3-0 ndaj PSG, në finalen e luajtur në MetLife Stadium. Në një finale ku taktika dhe efikasiteti bënë diferencën,

Chelsea kishte kontrolluar zhvillimin e lojës që nga minuta e parë. Cole Palmer ishte ylli i takimit, duke shënuar dy herë në minutat e 22' dhe 30', duke çuar ekipin në avantazh, më pas

kishte asistuar për golin e tretë. Joao Pedro e pati vulosur fitoren para pushimit me një finish artistik ndaj portierit Gianluigi Donnarumma.



klubet dhe institucionet që kanë kontribuar në zhvillimin dhe avancimin e futbollit të Kosovës gjatë vitit 2025. Çmimi më i rëndësishëm, ai i "Futbollisti të Vitit 2025", i ka takuar sulmuesit të FC Drita, Arb Manaj, të cilit trofeun ia kanë dorëzuar presidenti i FFK-së, Agim Ademi, presidenti i FShF-së, Armand Duka dhe ministri Hajrulla Çeku. Ndërsa çmimi "Fadil Vokrri", që nderon trashëgiminë e një prej figurave më të mëdha të futbollit të Kosovës, i është dhënë Amir Rrahmanit, kapitenit të Kombëtares së Kosovës dhe lojtarit të Napolit në Serinë A.

Kosova pranohet në Federatën Ndërkombëtare të Golfit

Kosova është pranuar zyrtarisht si anëtarja e 154-t e Federatës Ndërkombëtare të Golfit (IGF). Ky vendim është bërë me dije nga Federata e Golfit e Kosovës (FGK), e cila ka theksuar se ai shënon një prej momenteve më të rëndësishme në historinë e sportit të golfit në vendin tonë. "Anëtarësimi në IGF nuk është vetëm një status formal është një dëshmi e rrugëtimit tonë të gjatë. Është rezultat i më shumë se një dekade pune të palodhshme, qindra takimeve ndërkombëtare, mijëra orëve në terren, ndërtimit nga themelet të një strukture kombëtare të golfit dhe përkushtimit të çdo individi që besoi se Kosova mund të jetë pjesë e familjes globale të këtij sporti fisnik", ka njoftuar FGK-ja.

Ligës së Kampionëve. Klubi nga Franca ka mposhtur Interin me rezultat 5:0. Kjo është hera e parë që nga viti 1993 që një ekip francez fiton Ligën e Kampionëve. Po ashtu, PSG-ja ka fituar Kupën Ndërkontinentale, duke mposhtur Flamengon.

Liverpooli shpallet kampion i Premierë Ligës

Liverpooli është kurorëzuar kampion i Premierë Ligës, duke barazuar rekordin e Manchester Unitedit me 20 tituj të fituar. "Të kuqtë" e kanë fituar titullin me stil në stadiumin "Enfield", duke mposhtur me goleadë Totenhemin me rezultatin 5-1. Ekipi i drejtuar nga Arne Slot ka humbur vetëm dy takime në 34 ndeshje dhe i ka dhënë fund dominimit katërvjeçar të Manchester Cityt.

1990 dhe 2023. Fitorja e fundit ka ardhur nën drejtimin e Antonio Contes, pas një dueli të fortë me Interin, duke e çuar Napolin në Champions League si kampion i Italisë. Po ashtu, Napoli ka fituar edhe Superkupën e Italisë, duke e mposhtur Bolonjën në finale.

sezonin 2024-25, duke siguruar titullin e 28 në histori. Fitorja është konfirmuar zyrtarisht më 15 maj 2025, pas një fitoreje 2-0 kundër rivalit të qytetit, Espanyolit. Trajneri Hansi Flick ka udhëhequr ekipin drejt këtij suksesi, duke u shpallur edhe trajneri më i mirë i sezonit.



Trepça shpallet kampione e Kosovës në basketboll

Trepça është shpallur kampione e Kosovës në basketboll. "Xehetarët" kanë mposhtur Bashkimin në ndeshjen e gjashtë finale, me rezultat 82:67. Seria e finales ka përfunduar 4:2 në të mirë të skuadrës nga Mitrovica. Ky është titulli i dytë radhazi për Trepçën dhe i gjashti në historinë e këtij klubi.



PSG-ja për herë të parë në histori fiton Ligën e Kampionëve

Paris Saint-Germain (PSG) për herë të parë ka fituar finalen e



Napoli i Amir Rrahmanit fiton Scudetton në Itali

Napoli ka fituar Scudetton (Serinë A) në Itali, duke e marrë titullin e katërt në histori gjatë sezonit 2024-2025, pasi e kishte fituar edhe më parë më 1987,



Bayern Munichu, kampion i Bundesligës për herë të 34-t në histori

Bayern Munichu ka fituar Bundesligën në sezonin 2024-2025. Klubi gjerman e ka siguruar titullin e 34-t kombëtar (rekord) më 4 maj 2025, dy ndeshje para fundit të sezonit, pasi ndjekësi i tyre më i afërt, Bayer Leverkusen, kishte barazuar kundër Freiburgut. Ky titull ishte i pari trofe i madh në karrierën e Harry Kane si lojtar dhe i pari si menaxher për Vincent Kompany.

Portugalia shpallet kampione e Ligës së Kombeve

Portugalia është shpallur fituese e Ligës së Kombeve për këtë sezon, pasi ka mundur Spanjën në fund përmes "ruletës ruse", ku luzitanët janë treguar më të saktë. Koha e rregullt ka përfunduar baras (2-2), ku Cristiano Ronaldo kishte qenë vendimtar me një gol gjatë kohës së rregullt, ndërsa në penalti Alvaro Morata i Spanjës kishte dështuar duke ua mundësuar portugezëve ta ngrehin kupën.

Tottenhami fiton Ligën e Evropës

Tottenham Hotspur ka fituar finalen e Ligës së Evropës me

Barcelona fiton La Ligan

Barcelona është shpallur kampione e La Ligas për



Si lindi legjenda e Babagjyshit

Miti i Babagyshit të Krishtlindjeve vjen nga legjenda e Shën Nikollës, që jetoi në shekullin IV, dhe që tradicionalisht festohet më 6 dhjetor. Sipas traditës, Shën Nikolla i dha nga një pajë me rroba 3 vajzave të varfra, në mënyrë që ato të mund të martoheshin në vend se të prostituonin, dhe në një rast tjetër shpëtoi 3 fëmijë.

Në Mesjetë, zakoni i përkujtimit të këtij episodi me shkëmbimin e dhuratave në Ditën e Shenjtorit (6 dhjetor) u përhap në gjithë Evropën. Ky zakon është ende në modë në Holandë, Gjermani, Austri dhe Itali. Natën e 5 dhjetorit me slitën e tërhequr nga kali i tij, ai garon me Santa Klausin. Fëmijët e këqij, duhet të përballen me shërbëtorin e tij demoniak me shumë qime, ndërsa vendos dhurata, ëmbëlsira dhe fruta në këpucët e fëmijëve më të sjellshëm.

Tradita e Krishtlindjes

Në vendet protestante, Shën Nikolla e humbi aspektin e peshkopit katolik, por ruajti rolin e mirëbërësit me emrin e Samiklaus, Sinterklaus ose Santa Klaus. Festimet u zhvendosën në festën më të rëndësishme më të afërt, Krishtlindjen.

Por miti i njeriut zemërmirë me mjekër të bardhë dhe me thesin plot me dhurata, lindi në Amerikë nga pena e Klement Mur që në vitin 1822 shkroi një poezi, në të

cilën foli për atë që tashmë e njohim që të gjithë. Ky Santa Klaus i ri ishte i suksesshëm, dhe që nga vitet 1950 fama e tij pushtoi edhe Evropën.

Po kush ishte Shën Nikolla?

Megjithatë ndryshe nga Santa Klaus, Shën Nikolla kishte qenë një person real. Ai lindi në Patara në vitin 270 dhe ishte peshkop i Miras në Lisia (Turqia e sotme). Ai mbetet një figurë e mbështjellë me mister, por të dhëna arkeologjike thonë se ka ekzistuar vërtet.

Emri i tij shfaqet në disa nga listat e lashta të pjesëmarrësve në Këshillin e parë të Nikesë (viti 325), në një takim të gjithë ipeshkvijve të Kishës së Krishterë, që u përpoqën të sqarojnë ndryshimet teologjike mbi natyrën e Jezu Krishtit.

Në mungesë të informacioneve historike të sigurta, biografët e rindërtuan jetën e Nikollës, duke e stisur atë me detaje të kopjuara, që shpesh janë kopjuar nga jetët e shenjtorëve të tjerë. Fëmija i vetëm i dy prindërve të pasur, shfaqti që në moshë të hershme shfaqti shenjat e shenjtërisë së tij.

Në fakt të mërkurën dhe të premten, hante vetëm një herë në ditë, për të respektuar abstenimin e përcaktuar nga Kisha e Krishterë. Ai nuk përjetoi një vdekje spektakolare si dëshmor: vdiq pasi lëngoi për disa ditë në moshë të thyer midis viteve 345-352.

Dhe ashtu siç kishte bërë gjatë

jetës, edhe kur vdiq e mbrojti komunitetin e tij, duke u dhënë besimtarëve një vaj me erë të mirë që kishte fuqi të mrekullueshme, që rridhte nga reliket e tij në katedralen e Miras deri në shekullin XI-të (që u morën prej andej nga banorët e qytetit italian të Barit në vitin 1087).

Por deri në atë moment, fama e tij mbeti e lidhur vetëm me Lisian. Gjërat nisën të ndryshonin midis shekujve VII-VIII, kur përpara brigjeve ku ndodhej tempulli, bizantinët dhe arabët luftuan për epërsinë mbi detin. Kështu Nikolla u bë pika referuese e marinarëve bizantinë dhe mbrojtësi i tyre, duke e shndërruar veten nga një shenjti lokal, në një shenjti ndërkombëtar.

Kulti i tij u zgjerua përgjatë rrugëve detare të Mesdheut, duke arritur në Romë dhe Jeruzalem, pastaj në Konstandinopojë, Rusi dhe pjesën tjetër të Perëndimit. Në shekullin IX, ai u përhap edhe në Gjermani.

Shpëtimtari i vajzave

Paralelisht, u krijua një biografi e tij përfundimtare e tij, e “pasuruar me episode të reja”. Një nga më të famshmet është historia e tre vajzave, e përhapur në shekullin XI-XII. I prekur nga fati i 3 vajzave të varfra, të cilat babai i tyre po mendonte t’i bënte prostituta, për 3 net Nikolla u hodhi nëpër dritaren e hapur shumë qese ari (që më vonë simbolizohet në

ikonografi me topa të artë) si njëllor prike për t’i martuar. Kjo histori i dha Nikollës reputacionin e një bartësi bujar të dhuratave, një mbrojtësi të virgjërshave dhe garantit të pjellorisë.

Dhe i fëmijëve?

Marrëdhënia e tij e veçantë me ta buron nga një histori e zymtë mesjetare, e denjë për përrallat e Vëllezërve Grim. Një natë tre djem të vegjël kërkojnë strehim në një han. Hanxhiu dhe gruaja e tij i mirëpresin me kënaqësi, pasi u kishe mbaruar mishi në qilar.

Ato i vranë me sëpatë dhe trupat i vendosën në shëllirë. Pas masakrës, Shën Nikolla troket në derë dhe porositi një pjatë me mish. Kur hanxhiu refuzon, ai shkon vetenë qilar, ku nxjerr nga shëllira tre të rinjtë, të gjallë.

Historia qarkulloi kryesisht në shkollat kishtarë, ku më 28 dhjetor kremtohej Festa e të Pafajshmëve. Me rastin e këtij versionit të kristianizuar të Saturnalia-s, festivalit pagan të Romës antike, studentët zgjodhën “peshkopin”, një lloj Saturni romak që paraqitej në festë dhe bënte dhurata.

Nga fundi i shekullit XIII, 6 dhjetori u bë dita kur “peshkopët Nikolla” u ngjitën në slitat e tyre. Kjo traditë arriti kulmin e saj në shekullin e XVI. Por në disa vende ajo vazhdoi deri në shekullin XIX. Edhe kur Kisha e skandalizuar, nisi t’i ndalonte këto karnavale pagane, figura e Nikollës mbijetoi

nëpër shkolla dhe shtëpi falë fëmijëve, të cilët vazhduan ta festonin dhe të merrnin dhuratat e tij.

Përkushtimi italian

Historia dhe përkushtimi ndaj Shën Nikollës, është shumë i përhapur në dy qytete italiane: Bari dhe Venecia. Pas rënies së Miras në duart e myslimanëve në vitin 1087, qytetarët e Barit kryen një ekspeditë në atë qytet. Reliket, pra kockat e shenjtorit, ishin pjesë e plaçkës.

Rreth 10 vjet më vonë, venecianët shkuan gjithashtu në Mira dhe gjetën kocka të tjera, të harruara nga barezët në nxitim e sipër. Venecianët i çuan ato në Abacinë e Shën Nikollës së Lidos, duke pretenduar gjithashtu pronësinë e eshtrave të shenjtorit. Ata e shpallën atë mbrojtës të flotës së Serenissima (Siç quhej dikur Republika e Venedikut).

Dhe ata i kushtuan shumë vepra arkitektonike, si katedralja në “Giardino della Serenissima” (qyteti Sacile në Friuli). Por a është San Nikola i Barit i njëjtë me Nikolën e Venecias? Në vitin 1992, përmes analizës së ADN-së, u vërtetua se eshtrat i përkasin të njëjtut person. Disa vjet më parë, në Turqi, disa arkeologë zbuluan një varr që studiuesit besojnë se është ai i Shën Nikollës. Dhe misterit, në vend se të zgjidhet, duket se po shtohet akoma më shumë. / Focus – Bota.al



Si ta nisim mbarë? 6 këshilla për t'i bërë planet e Vitit të Ri të funksionojnë realisht



Rituali i vendosjes së rezolutave për Vitin e Ri ka fituar një reputacion të përzier, pasi shumë herë premtimet e mëdha zhduken që në muajin shkurt. Anëtarësimet në palestër mbeten të papërdorura, planet buxhetore shpesh harrohen, dhe synimet për vetë-përmirësim shuhen shpejt. Por problemi nuk është mungesa e ambicies, por mënyra se si janë ndërtuar këto rezoluta.

Studimet e fundit tregojnë se gjithnjë e më shumë njerëz po vendosin rezoluta, por po largohen nga qëllimet e paqarta dhe të përgjithshme, duke u fokusuar në prioritetet

më konkrete dhe më të arritshme. Stabiliteti financiar, shëndeti dhe mirëqenia emocionale mbeten ende prioritetet kryesore, por mënyra se si formulohen ato ka ndryshuar. Njerëzit nuk kërkojnë më përsosmëri, por duan progres të vazhdueshëm dhe sisteme që mund të funksionojnë edhe pas një periudhe të vështirë. Ata duan qëllime që pranojnë pasigurinë e jetës, në vend që ta injorojnë atë.

Ekspertët theksojnë se rezolutat që funksionojnë kanë disa elementë të përbashkët: ato fokusohen tek sjelljet dhe veprimet e përditshme, jo vetëm

tek rezultatet e menjëhershme; ofrojnë mundësi për rregullime pa shkaktuar ndjenja faji; dhe lidhin qëllimet afatgjata me hapat konkretë që mund të ndiqen çdo ditë. Ky qasje është thelbësore, sepse shumica e rezolutave dështojnë për shkak të një strukture që nuk është e qëndrueshme, jo për mungesë motivimi.

Rezolutat më të mira për Vitin e Ri janë ato që janë modeste por të rëndësishme. Ato njohin kufijtë personalë dhe janë të dizajnuara për t'u përshtatur me jetën reale, duke i lejuar njerëzit të vazhdojnë të ecin përpara, pavarësisht sfidave që mund të dalin gjatë vitit.

JA GJASHTË QASJE NDAJ REZOLUTAVE QË KANË MË SHUMË GJASA TË ZGJASIN GJATË GJITHË VITIT:

1. Ndërtoni zakone të vogla financiare, jo objektiva dramatike

Sondazhet financiare tregojnë se gjithnjë e më shumë njerëz po i japin përparësi qëndrueshmërisë, në vend të synimeve të mëdha për kursime. Planifikimi dhe buxheti renditen ndër rezolutat më të zakonshme. Një zakon i përsëritshëm krijon momentum pa kërkuar motivim të vazhdueshëm.

2. Trajtoni shëndetin si mirëmbajtje, jo transformim ekstrem

Rezolutat për shëndetin mbeten popullore, por po rritet skepticizmi ndaj ndryshimeve drastike. Aktiviteti fizik i rregullt dhe ushqyerja e shëndetshme vazhdojnë të jenë prioritetet. Kur shëndeti shihet si kujdes i vazhdueshëm, jo si projekt radikal, angazhimi bëhet më realist.

3. Kufizoni numrin e rezolutave dhe shkruajini ato qartë

Studimet tregojnë se rezolutat më efektive janë të pakta dhe të artikuluar mirë. Shkrimi i tyre ndihmon në qartësimin e qëllimit dhe rrit ndjenjën e përgjegjësisë. Më

pak rezoluta do të thotë më pak lodhje mendore dhe më shumë gjasa për t'i ndjekur.

4. Vendosni objektiva të përditshme për mirëqenien emocionale

Mirëqenia emocionale tashmë renditet përkrah shëndetit fizik dhe stabilitetit financiar. Praktika të përditshme si gjumi i rregullt apo vendosja e kufijve personalë janë më të arritshme sesa synime abstrakte për "lumturi". Qëndrueshmëria është më e rëndësishme se intensiteti.

5. Fokusohuni tek procesi, jo tek perfeksioni

Rezolutat që lejojnë gabime dhe rregullime janë më të qëndrueshme. Një ditë e humbur nuk e prish gjithë planin. Ideja është të rikthehesh, jo të dorëzohesh.

6. Rishikojini rezolutat rregullisht

Studimet financiare dhe të sjelljes theksojnë rëndësinë e kontroleve periodike. Një rishikim mujor ndihmon për të korrigjuar kursin pa barrë faji. Rezoluta bëhet një plan i gjallë, jo një deklaratë e një dite të vetme.

Në fund, rezolutat që funksionojnë nuk janë ato më ambiciozet, por ato më të menduarat. Ato nuk kërkojnë perfeksion – kërkojnë vazhdimësi.

Ngjarjet e 2026-ës që nuk duhet t'i humbisni

2026-a është porta që pret hapur eventet më elitare nga sporti, arti dhe moda. Me kombinimet e shpeshta të fluturimeve që do të lehtësojnë lidhjen mes destinacioneve, ju mund të jeni pjesë e publikut të gjerë që do të ndjekë këto ngjarje.

Një nga aktivitetet më ekskluzive sportive dimërore "Snow Polo World Cup, St. Moritz" pritet të zhvillohet mbi liqenin e ngrirë të St. Moritz, duke kombinuar sportin e polo-s me elitën ndërkombëtare që viziton këtë destinacion alpin.

"London Fashion Week" pika e takimit për modën, median dhe industrinë kreative, ku prezantohen koleksionet më të fundit të stilistëve të afirmuar dhe

talenteve të reja, si edhe "Festival de Cannes", festivali më i njohur ndërkombëtar i filmit, vendosin artin dhe modën në 2026-ën në një fron të artë.

"Cheltenham Festival" dhe "Dubai World Cup" janë dy nga garat më prestigjioze të kuajve në botë, njëri që zhvillohet në Mbretërinë e Bashkuar, e tjetri në Dubai, të cilat ndërthurin elementin e konkurimit me atë të atmosferës elektrizuese dhe traditave përkatëse.

"Rolex Monte-Carlo Masters" ndërkohë është turneu prestigjioz i tenisit, i cili kombinon sfondin luksoz të Rivierës Franceze me sportin elitare të tenisit. Viti që kënaq preferencat e të gjithëve, duket se do të jetë 2026-a.





SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita: Zhvillues/e i/e aplikacioneve në Sharepoint (Zyrtar i lartë)
Grada: P05
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Departamenti: Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë
Divizioni: Për Menaxhimin e Databazave dhe Aplikacioneve
I raporton: Udhëheqësit të Divizionit për Menaxhimin e Databazave dhe Aplikacioneve

Njoftim i rëndësishëm:

Afati për aplikim për këtë pozitë, i cili ka qenë i hapur deri më 26 dhjetor 2025, shtyhet edhe për pesë (5) ditë pune.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Projektimi dhe zhvillimi i aplikacioneve të personalizuar, duke përdorur Power Apps për të përmirësuar proceset e biznesit dhe përvojën e përdoruesve.
- Krijimi dhe mirëmbajtja e rrjedhave të automatizuara të punës me Power Automate për të reduktuar detyrat manuale dhe për të integruar sisteme si SharePoint dhe API-të e jashtme.
- Ndërtimi dhe menaxhimi i faqeve, librarive, listave dhe autorizimeve në SharePoint për të mbështetur bashkëpunimin dhe menaxhimin e dokumenteve.
- Integrimi i të dhënave nga burime të ndryshme, duke përfshirë Dataverse, databaza SQL dhe API-të e jashtme, duke siguruar saktësinë, sigurinë dhe pajtueshmërinë e të dhënave.
- Kryerja e testimeve, zgjidhja e problemeve dhe optimizimi i aplikacioneve, rrjedhave të punës dhe integriteteve të të dhënave për të zgjidhur çështjet dhe për të përmirësuar performancën.
- Bashkëpunimi me palët e interesit të biznesit për të mbledhur kërkesat, për të ofruar trajnime dhe për të dokumentuar zgjidhjet për mirëmbajtje të vazhdueshme.
- Qëndrimi i përditësuar me përditësimet e Microsoft Power Platform, praktikat më të mira dhe teknologjitë e reja për të rekomanduar përmirësime.
- Shkrimi i query-ve të avancuara për analizën e të dhënave dhe përpunimin e tyre sipas nevojave të biznesit.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Diplomë universitare (bachelor) në fushën e shkencave kompjuterike, elektroteknike apo matematikës, ose një nga certifikimet e mëposhtme:
 - Microsoft Certified: Power Platform Fundamentals (PL-900);
 - Microsoft Certified: Power Platform Functional Consultant Associate (PL-200);
 - Microsoft Certified: Power Platform Developer Associate (PL-400);
 - Microsoft Certified: Power Platform Solution Architect Expert (PL-600).
- Së paku 3 vite përvojë pune në zhvillimin e zgjidhjeve me SharePoint, Power Apps dhe Power Automate.
- Gjuha angleze - e preferuar;

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **09 janar 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Pozicija: Programer/ka aplikacija SharePoint (Viši službenik)
Stepen: P05
Trajanje zaposlenja: na neodređeno vreme
Odeljenje: Informacione tehnologije i bezbednosti
Odsek: Za upravljanje bazama podataka i aplikacijama
Izveštava: Rukovodiocu odseka za upravljanje bazama podataka i aplikacijama

Važno obaveštenje:

Rok za prijavu za ovu poziciju, koji je bio otvoren do 26. decembra 2025. godine, produžava se za dodatnih pet (5) radnih dana.

Dužnosti i odgovornosti:

- Dizajniranje i razvijanje personalizovanih aplikacija, koristeći Power Apps za poboljšanje poslovnih procesa i iskustava korisnika.
- Kreiranje i održavanje automatizovanih tokova rada pomoću Power Automate-a kako bi se smanjio broj manualnih zadataka i integrisanje sa sistemima kao što je SharePoint i eksterni API.
- Kreiranje i upravljanje stranicama, bibliotekama, listama i dozvolama u SharePoint-u radi podrške saradnji i upravljanju dokumentima.
- Integrisanje podataka iz različitih izvora, uključujući Dataverse, baze podataka SQL i eksterne API-je, obezbeđujući tačnost, bezbednost i usklađenost podataka.
- Sprovođenje testiranja, rešavanje problema i optimizacija aplikacija, tokova rada i integracija podataka radi rešavanja problema i poboljšanja performanse.
- Saradnja sa poslovnim zainteresovanim stranama radi prikupljanja zahteva, održavanja obuka i dokumentovanja rešenja za kontinuirano održavanje.
- Ostati ažuriran sa ažuriranjima Microsoft Power Platform, najboljim praksama i novim tehnologijama radi preporučivanja poboljšanja.
- Pisanje naprednih query-ja za analizu i obradu podataka shodno potrebama biznisa.

Kvalifikacije i potrebno iskustvo:

- Univerzitetska diploma osnovnih studija iz računarskih nauka, elektrotehnike ili matematike ili jedan od sledećih sertifikata:
 - Microsoft Certified: Power Platform Fundamentals (PL-900);
 - Microsoft Certified: Power Platform Functional Consultant Associate (PL-200);
 - Microsoft Certified: Power Platform Developer Associate (PL-400);
 - Microsoft Certified: Power Platform Solution Architect Expert (PL-600).
- Najmanje 3 godine iskustva u razvoju rešenja sa SharePoint-om, Power Apps-om i Power Automate-om.
- Poznavanje engleskog jezika - poželjno;

Svi kandidati moraju da dostave sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Motivaciono (propratno) pismo u kojem se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrda od poslodavca ili drugi relevantni dokumenti koji služe za dokazivanje držane pozicije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti ličnih podataka)
- Izveštaj Kosovskog penzionog štednog fonda (Trust)** za relevantni period, ili poreska potvrda Poreske uprave (PAK) kada izveštaj Fonda nije pravno primenljiv;
- Kopije diploma, pri čemu diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koji služi kao dokaz o državljanstvu Kosova;

Procedura apliciranja:

- Zadnji rok za apliciranje je **09. januar 2026. godine**.
- Apliciranje se može obaviti onlajn (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a. Drugi oblici apliciranja neće biti uzeti u obzir.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 31.12.2025 bënë shpallje publike për dhënien e pronës së paluajtshme me qira.

Shpallje Publike

T-25-11

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë
Data e shpalljes: 31.12.2025
Sqarimi: deri me 15.01.2026
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 15.01.2026
Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.
Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) (Originali dhe Kopja)
Afati i fundit i dorëzimit: 15.01.2026 në 11:00
Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A.

Për më shumë detaje lidhur me këtë shpallje, ju lutemi vizitoni www.trepcashash.com ose na kontaktoni në adresat e mëposhtme.

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: Trepça sh.a.		
Adresa postare: Parku industrial, Mitrovicë 40000		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Republika e Kosovës
Kontakti: sales@trepcashash.com		Telefoni: +383 (0) 28 538 050 Faksi: +383 (0) 28 539 202
www.trepcashash.com		

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Blerina Haxhidauti shpall të pavlefshme dëftesën e klasës
- Leonor Osmanaj shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Gentian Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Pjeter Bogdani" Damjan Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.
- Krenar Abrashi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit "Krenar Abrashi" B.I. me nr. Unik: 811133719.
- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fazli Greiçevci".
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, salon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- ### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

 - ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

